



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në: “Gjeografi”

ofruar nga

Universiteti i Tiranës

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Asoc. Nevila Çinaj

Prof. Asoc. Alba Osman

Nëntor/2025

Tabela Përmbledhëse me të dhënat për Programin e studimit Bachelor në: “Gjeografi”

1	IAL aplikues:	Universiteti i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Gjeografisë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Gjeografi”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr.359, Datë 12.09.1991
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër Nr.177, datë 14.06.2023
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike /6 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	N/A
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	N/A
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	N/A
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6 (gjashtë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	V.a 2022-2023:24 PAE /3 PAK V.a 2023-2024:24 PAE /2 PAK V.a 2024-2025: 22 PAE/ 2 PAK
18	Numri i studentëve:	V.a 2022-2023: 76 studentë V.a 2023-2024: 70 studentë V.a 2024-2025: 51 studentë
19	Komente / të tjera:	

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i ciklit të parë të studimeve Bachelor në: “Gjeografi” ofrohet nga Departamenti i Gjeografisë, Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë, Universiteti i Tiranës. Ai zhvillohet në gjuhën shqipe, me kohë të plotë, dhe përgatit studentë gjatë një periudhe trevjeçare (6 semestra), në përfundim të së cilës student fitojnë 180 kredite ECTS, në përputhje me nivelin 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Programi ofron formim bazë dhe të specializuar në fushën e gjeografisë, duke kombinuar njohuritë teorike me aplikimet praktike në terren dhe laborator.

Qëllimi i programit është të ofrojë një bazë të gjerë kompetencash për të kuptuar proceset natyrore dhe shoqërore, të zhvillojë aftësinë për analizë kritike, përpunim të të dhënave dhe përdorim të mjeteve bashkëkohore të gjeoinformacionit. Kurrikula përfshin lëndë të përgjithshme, karakterizuese dhe plotësuese, të cilat ndërthurrin teorinë me praktika mësimore dhe hulumtuese, duke u dhënë studentëve aftësi të nevojshme për tregun e punës dhe për vazhdimin e studimeve të mëtejshme në ciklin e dytë të studimeve.

Procesi i akreditimit të programit ka përfshirë shqyrtimin e dokumentacionit zyrtar, raportin e vlerësimit të brendshëm dhe dokumentet mbështetëse të dorëzuara në sistemin e informacionit të ASCAL. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, i përbërë nga Prof. Asoc. Dr. Nevila Cinaj dhe Prof. Asoc. Dr. Alba Osman, i asistuar nga koordinatoreja teknike e ASCAL, Znj. Alma Arapi, ka zhvilluar vizitën në Institucion më 1–2 prill 2025. Gjatë vizitës u zhvilluan takime me drejtuesit e Fakultetit dhe Departamentit, grupin e vlerësimit të brendshëm, stafin akademik, studentë dhe përfaqësues të strukturave mbështetëse, si edhe u inspektuan auditorët, laboratorët, biblioteka dhe mjediset ndihmëse.

Ky proces u shoqërua me diskutime mbi standardet e programit, përshtatjen e tij me nevojat bashkëkohore të tregut të punës dhe sfidat e mëtejshme për përmirësimin e cilësisë. Në përfundim të vizitës, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm hartoi draft-raportin për programin, duke u mbështetur në dokumentacionin dhe evidencat e mbledhura gjatë fazave të ndryshme të vlerësimit. Programi pritet të garantojë përmbushjen e standardeve akademike dhe të kontribuojë në përgatitjen e specialistëve të rinj në fushën e gjeografisë në Shqipëri.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;


ASCAL, bazuar në “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017”, ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga Institucioni, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm. Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje: Prof. Asoc. Dr. Nevila Cinaj dhe Prof. Asoc. Dr. Alba Osman. Gjatë gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga koordinarja teknike e ASCAL, Znj. Alma Arapi.

Procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit Bachelor në “Gjeografi”, i ofruar nga Departamenti i Gjeografisë, të Fakultetit Histori dhe Filologji (FHF) në UT, filloi me prezantimin, si dhe ndarjen e punës ndërmjet ekspertëve të grupit të vlerësimit të jashtëm. Më pas ky grup, bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga e-ASCAL, filloi shqyrtimin e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm, si dhe dokumentet përkatëse në mbështetje të tij. Gjatë kësaj faze u identifikuan dhe u listuan një sërë pyetjesh, që kishin lidhje me standardet dhe kriteret përkatëse, të cilat do të merrnin përgjigje gjatë takimeve që do të realizoheshin në IAL.

Vizita në Departamentin e Gjeografisë, u realizua në datën 1 dhe 2 Prill 2025, ku Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, realizoi takimet e përcaktuara sipas agjendës së vizitës. Gjatë vizitës, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) zhvilloi takimet e përcaktuara në agjendë, si dhe vizitoi mjediset e institucionit si: auditorë, laboratorë, shërbimet për studentët, etj.

Gjatë takimeve u shqyrtuan çështje të ndryshme që lidhen me vlerësimin e programit të studimit Bachelor në “Gjeografi”, duke sqaruar edhe elementë të veçantë, për të cilat ekspertët kanë drejtuar pyetjet përkatëse. Pas vizitës në IAL, GVJ hartoi draft-raportin e vlerësimit të jashtëm, bazuar në dokumentacionin në dispozicion nga dosja e vlerësimit të brendshëm, informacioni i depozituar në sistemin e informacionit të ASCAL, si dhe në informacionin e mbledhur gjatë takimeve dhe vizitës të realizuar në Institucion. Në përfundim të këtij procesi ky grup dorëzon draft-raportin pranë ASCAL.

Universiteti i Tiranës është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 27.10.2025, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 129 / 27 Prot, datë 27.10.2025. Universiteti i Tiranës, njofton në ASCAL më datë 18.11.2025, me anë të shkresës ku shprehin dakortësinë me vlerësimin e kryer nga Ekspertët e Jashtëm. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.




Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Gjeografi”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësishë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Universiteti i Tiranës, (më tutje UT) zhvillon të gjithë veprimtarinë e tij, në përputhje me Ligjin nr. 80 të vitit 2015 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”. Bazuar në misionin e Universitetit, për të krijuar, transmetuar, zhvilluar dhe mbrojtur dijet përmes mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe një sërë aktiviteteve, njësitet kryesore dhe njësitet bazë të UT ofrojnë programe studimit të ndara në tre cikle: cikli i parë Bachelor, cikli i dytë Master dhe cikli i tretë Doktoratë. Programet që ofrohen janë të ndara sipas fakulteteve dhe mund të përfshijnë si programe me karakter profesional ashtu edhe programe akademike. Programi Bachelor në: “Gjeografi” është hartuar në përputhje me interesat kombëtare dhe synon ruajtjen e vlerave akademike e kulturore kombëtare. Programi i përgatit studentët me aftësi profesionale në analiza hapësinore, planifikim territorial, menaxhim mjedisor, zhvillim të qëndrueshëm dhe administratë publike – fusha këto me përparësi për zhvillimin e vendit. Në këtë mënyrë, programi kontribuon drejtpërdrejt në realizimin e strategjive kombëtare të zhvillimit dhe procesit të integritetit evropian. Fokusi i këtij programi përputhet plotësisht me Ligjin nr. 80/2015 për Arsimin e Lartë – konkretisht, neni 1, pika b e këtij ligji që nënvizon formimin e specialistëve sipas prioriteteve të zhvillimit kombëtar. Përmes përgatitjes së profesionistëve të kualifikuar, programi synon të forcojë tregun e punës dhe sektorët strategjikë të ekonomisë, çka tregon një kuptim të qartë të nevojave kombëtare dhe rolit të universitetit për t’u përgjigjur atyre. Një aspekt tjetër cilësor është fokusi në ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. Programi e reflekton këtë mision përmes objektivave dhe synimeve të tij të përfshira në Strategjinë e Universitetit të Tiranës, duke kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm të vendit, menaxhimin e burimeve natyrore dhe

	forcimin e identitetit gjeografik e mjedisor të Shqipërisë. <i>Evidenca 1_Ligji nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",</i> <i>Evidenca 2_Statuti i Universitetit të Tiranës, Neni 4 dhe Neni 8</i> <i>Evidenca 3_Strategjia e zhvillimit të Universitetit të Tiranës</i> <i>Evidenca 4 Rregullore e Universitetit të Tiranës</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit Bachelor në "Gjeografi" është hartuar dhe ofrohet në funksion të përmbushjes së misionit dhe qëllimeve të Universitetit të Tiranës, si dhe të fushës së veprimtarisë së tij. Përmbajtja e programit është në përputhje me misionin e njësive përkatëse akademike, si Fakulteti i Histori-Filologjisë, dhe me misionin e vetë UT, duke respektuar edhe drejtimit e përgjithshme të arsimit të lartë në Shqipëri të përcaktuara nga kuadri ligjor dhe politika shtetërore. Programi fokusohet në ofrimin e një arsimi cilësor dhe në nxitjen e kërkimit shkencor në fushën e gjeografisë, që është vetë fusha e veprimtarisë së departamentit. Njëkohësisht, ai mbështet formimin akademik e profesional të studentëve në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe objektivat strategjike të zhvillimit kombëtar. Referuar Planit strategjik të zhvillimit të programit, vëmendje i kushtohet qasjes ndërdisiplinore dhe zhvillimit të mendimit kritik tek studentët. Kjo tregon se programi në praktikë synon të realizojë vizionin e institucionit për një edukim cilësor dhe gjithëpërfshirës. Po ashtu, programi synon të përgatisë specialistë dhe ekspertë gjeografie që t'i përgjigjen sa më mirë kërkesave të ndryshme të tregut të punës dhe zhvillimeve bashkëkohore. <i>Evidenca 2_Statuti i Universitetit të Tiranës, Neni 5 dhe 8</i> <i>Evidenca 3 Strategjia e zhvillimit të Universitetit të Tiranës, 2018-2023, Pjesa UI dhe IV</i> <i>Evidenca35_Plani strategjik i zhvillimit të programit bachelor_Departamenti i Gjeografisë</i>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullos së	Për realizimin e objektivave akademike dhe kërkimore, programi duhet të jetë në përputhje me strategjinë e zhvillimit të institucionit. Programi Bachelor në: "Gjeografi" është krijuar në përputhje me këtë strategji, duke siguruar që lëndët dhe veprimtaritë e tij të mbështeten në kërkime shkencore të avancuara dhe teknologji moderne, si dhe të ndihmojnë

Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.	studentët të zhvillojnë aftësi analitike dhe praktike. Strategjia për zhvillim e UT 2018-2023, shihet e reflektuar drejtpërdrejt në synimet e programit (p.sh. ndërdisiplinariteti dhe lidhja teori-praktikë janë prioritetet strategjike në shumë institucione moderne). Gjithashtu, programi respekton drejtimet dhe fushat akademike prioritare të universitetit ashtu siç janë përcaktuar në Statutin dhe Rregulloren e UT. Fusha e gjeografisë si disiplinë lidhet ngushtë me orientimet akademike të universitetit, dhe ofrimi i programit në këtë fushë mbështetet nga Statuti (p.sh. neni 8 i Statutit, i përmendur në evidencat e raportit) dhe nga rregullorja e brendshme. Këto elementë tregojnë pajtueshmëri formale të plotë me kriterin: programi është i ankoruar në strategjinë zyrtare të zhvillimit të UT, si dhe brenda kornizës ligjore e rregullative të institucionit. Referuar RVB dhe takimeve me grupet e përcaktuara, departamenti angazhohet në sigurimin e të gjitha lehtësirave për përvetësimin e njohurive dhe aftësive nga studentët dhe e konsideron rishikimin e kurrikulës si një proces të vazhdueshëm Programi i gjeografisë i jep zbatim prioritetëve institucionale dhe atyre kombëtare, duke u përpjekur të ofrojë një arsim cilësor dhe të orientuar drejt njohurive aplikative, kërkimit shkencor, inovacionit dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Një qasje e tillë përforcohet edhe nga Plani Strategjik i zhvillimit specifik për programin Bachelor në: “Gjeografi” (përmendur si Evidenca 35 në raport). <i>Të rregullohet kuadri rregullator i Departamentit të Gjeografisë, i cila rregullon veprimtarinë mësimore – shkencore dhe administrative, në përputhje me objektivat dhe misionin ligjor.</i> <i>Evidenca 3_Strategjia e zhvillimit te Universitetit te Tiranes, 2018-2023</i> <i>Evidenca 35_Plani_strategjik_i_zhvillimit_te programit_bachelor Departamenti_i Gjeografise</i> <i>Evidenca 2_Statuti i Universitetit të Tirants, Neni 8</i> <i>Evidenca 4_Rregullore e Universitetit të Tiranes</i>
Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një	Departamenti i Gjeografisë demonstroi se disponon përvojë të konsoliduar, kapacitete të mjaftueshme dhe burimet e duhura për ofrimin e programit Bachelor në “Gjeografi”. Referuar Tabelës 1 (Evidenca 50), programi mbështetet nga 22 pedagogë, nga të cilët 7 mbajnë titullin “Prof.dr”, 6 “Profesor i asociuar”, 5 “Doktorë Shkencash”, 3




programi studimi në atë fushë.	“Kandidatë për Doktoraturë” dhe 1 Master i Shkencave. Në RVB përmendet aspekti infrastrukturor, i cili është i panevojshëm në këtë kriter pasi bëhet fjalë për burimet në fushën akademike. Gjithashtu, përmendet se institucioni ka <i>“një histori të suksesshme në zhvillimin dhe implementimin e programeve të ngjashme”</i> dhe bashkëpunime me institucione vendase e të huaja në fushën e gjeografisë, e dhënë e panevojshme për këtë kriter. <i>Evidenca 24_ Infrastruktura FHF</i> <i>Evidenca 80_ Organika e Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë</i> <i>Evidenca 17 CV e stafit PAE dhe PAK</i> <i>Evidenca 50_ Tabela Përmbledhëse</i>
Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Struktura e programit është në përputhje me kërkesat ligjore dhe udhëzimet kombëtare referuar Ligjit nr. 80/2015 për Arsimin e Lartë dhe Vendimi nr. 41, datë 24.1.2018, duke klasifikuar lëndët në kategori (bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore, plotësuese, etj.) sipas këtyre udhëzimeve Programi ka implementuar plotësisht Sistemin Evropian të Krediteve (ECTS) – është i organizuar në cikël trevjeçar me 180 kredite, ashtu siç parashikojnë standardet e Kartës së Bolonjës. Programi është në përputhje të plotë me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë bazë, sipas klasifikimit/kodifikimit kombëtar dhe evropian. Kjo do të thotë që përmbajtja dhe drejtimit kryesore të programit janë në harmoni me ekspertizën dhe profilin kërkimor të departamentit. Kurrikula e programit mbulon aspektet themelore të disiplinës së gjeografisë, duke përfshirë studimin e hapësirës gjeografike, planifikimin territorial, menaxhimin e burimeve natyrore e humane, si dhe teknologjitë e informacionit gjeohapësinor, që janë pikërisht fushat ku departamenti zhvillon veprimtarinë e vet akademike. <i>Evidenca 1_ Ligji nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.</i> <i>Evidenca 29_ Vendim Nr. 41, datë 24.1.2018 — Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë</i> <i>Evidenca 69_ Cikli i parë i Studimeve Bachelor në Universitetin e Tiranës ofron një kurrikulë të perceptuar sipas</i>




	<i>standarteve të Kartës së Bolonjës.</i>			
Konkluzione	<i>GVJ, duke marrë parasysh të dhënat nga vizita në Institucion dhe Evidencat e dorëzuara vlerëson se program i studimit Bachelor në: "Gjeografi" ka arritur të përmbushë me sukses kriteret e Standardit I.1. Ai është në përputhje me interesat kombëtare, me misionin dhe qëllimet e universitetit, duke integruar kërkesat akademike dhe profesionet e kërkuara nga tregu. Programi mbështetet në një staf akademik të kualifikuar duke siguruar një mësimdhënie cilësore.</i> <i>Përpuethshmëria me strategjinë e zhvillimit të universitetit është gjithashtu e plotë, duke kontribuar në zhvillimin e kërkimit shkencor dhe të mundësive praktike për studentët.</i> <i>Të rregullohet kuadri rregullator i Departamentit të Gjeografisë, i cila rregullon veprimtarinë mësimore – shkencore dhe administrative, në përputhje me objektivat dhe misionin ligjor.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi I.2


Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësiwe përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Programi i Gjeografisë drejton të gjithë veprimtarinë e vet akademike dhe administrative në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 80/2015, VKM-të dhe udhëzimet e MAS, mbi bazën e të cilave është hartuar Statuti dhe rregullorja e Universitetit të Tiranës. Departamenti i Gjeografisë i Universitetit të Tiranës ka zhvilluar një bashkëpunim të ngushtë dhe të qëndrueshëm me dekanatin dhe njësitë e tjera të fakultetit për të siguruar një proces akademik cilësor dhe mbështetje të vazhdueshme për studentët. Ky bashkëpunim përfshin zhvillimin e programit të studimit, organizimin e aktiviteteve kërkimore, mbështetje financiare për studentët përmes bursave, mundësi për angazhimin në praktika dhe projekte shkencore. Përdorimi i teknologjisë, si platforma


Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel +355 (04) 222-46423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al





	CleanScore për vlerësimin objektiv dhe sistemet e bibliotekave online, si dhe mbështetja nga Zyra e Këshillimit të Karrierës, ofron mundësi të shumta për zhvillimin profesional të studentëve. Ky integrim i strategjive dhe mbështetjes vazhdimisht të përditësuar, në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe prioritetet akademike, garanton një arsim të qëndrueshëm dhe të orientuar nga nevojat e studentëve dhe industrisë. Nga pikëpamja procedurale dhe e rregulloreve, njësia bazë ka Planin e saj strategjik, i cili ndan detyrat dhe përgjegjësitë. Ky plan përfshin masa për mbikëqyrjen dhe vlerësimin e vazhdueshëm të përmbajtjes akademike dhe burimeve të nevojshme për zhvillim. • <i>Evidenca 1_ Ligji 80/2015 për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, nenet 18, 23, 25</i> • <i>Evidenca 4_Rregullore e Universitetit të Tiranës, Kreu II, faqe 8-9</i> • <i>Evidenca 2_Statuti i Universitetit të Tiranës 2018</i> • <i>Evidenca 22_Udhezim i Dekanit për praktikën në terren</i> • <i>Evidenca 70_Kodi i Etikës i Universitetit të Tiranës</i> • <i>Evidenca 71 Lista e miratuar e bursave 2021-2022</i> • <i>Evidenca 72_Vendim Nr:29 i Senatit Akademik të UT, datë 22/07/2021 - Për miratimin e udhëzuesit "Për procedurat e administrimit të projekteve të kërkimit shkencor që financohen nga buxheti për kërkimin shkencor në Universitetin e Tiranës"</i> • <i>Evidenca 74_Biblioteka të Universitetit të Tiranës</i> • <i>Evidenca 57_Praktika Clean Score</i> • <i>Evidenca 78_Raport për ditët e orientimit të maturantëve FHF</i> • <i>Evidenca 80_Organika e Fakultetit të Historisë dhe Filologji</i>
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë	GVJ konstaton se institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet e tjera brenda dhe jashtë vendit. Bashkëpunimet në fushën akademike dhe kërkimore në kuadër të marrëveshjeve të realizuara me institucionet e tjera, janë vendimtare për arritjen e objektivave të procesit mësimor të programeve të studimit të ofruara nga programi i Gjeografisë. Konkretisht, janë vendosur marrëveshje bashkëpunimi me universitetet e tjera të Shqipërisë, si Universiteti i Shkodrës,





vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Elbasanit, Gjirokastrës dhe Durrësit, të cilët janë partnerë të programit për shkëmbime akademike dhe mundësi bashkëpunimi ndëruniversitar; me universitetet ndërkombëtare, marrëveshjet Erasmus+ me të cilat mundësojnë shkëmbimin e studentëve dhe mundësi për pjesëmarrje në aktivitete akademike ndërkombëtare; me institucionet e kërkimit dhe agjencitë shtetërore si Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit, të cilët janë partnerë të programit, ofrues të mundësive për praktika profesionale dhe projekte kërkimore që lidhen me menaxhimin e mjedisit dhe përdorimin e teknologjive GIS; organizata dhe kompani të fushës së mjedisit dhe planifikimit territorial, Clean Score etj. <i>Evidenca 21.1 - Lista e institucioneve bashkëpunuese</i> <i>Evidenca 21 - Marrëveshjet e bashkëpunimit</i> <i>Evidenca 56 – Praktika Erasmus+</i> <i>Evidenca 35 Plani strategjik i zhvillimit të pogramit bachelor De partamenti i Gjeografisë</i>
Kriteri 3. Për realizmin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	Për arritjen e qëllimeve të procesit të mësimdhënies dhe trajnimit të studentëve, janë arritur marrëveshje bashkëpunimi kornizë institucionale si me institucionet kërkimore ashtu edhe me agjencitë kombëtare. Këto marrëveshje kanë ndihmuar edhe në avancimin e praktikës profesionale. Në Listën e institucioneve bashkëpunuese renditen mbi 18 të tilla¹, të cilat sigurojnë mundësi praktike për studentët, për të aplikuar njohuritë e fituara dhe për të zhvilluar aftësitë profesionale që kërkohen në tregun e punës. Marrëveshjet janë të fokusuar në mundësitë për praktika kërkimore, angazhime në projekte dhe zhvillime territoriale, si dhe në përdorimin e teknologjive GIS dhe fusha të tjera të gjeografisë. <i>Evidenca 21 - Marrëveshjet e Bashkëpunimit</i> <i>Evidenca 21.1 - Lista e Institucioneve Bashkëpunuese</i> <i>Evidenca 4_Rregullore e Universitetit të Tiranës, Kreu II</i>
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia	Gjatë takimit me drejtuesit e njësisë kryesore dhe bazë, pedagogët dhe GVB, diskutuam për mënyrën si merret dhe

¹ Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Agjencia e Zhvillimit të Territorit, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, Agjencia Kombëtare e Turizmit, Agjencitë Rajonale të Zonave të Mbrojtura, Drejtoritë e Parqeve Kombëtare, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Bashkia Tiranë, Bashkia Durrës, Bashkia Lezhë, Bashkia Vlorë, Bashkia Divjakë, Bashkia Shkodër, INSTAT, Institucione publike dhe jopublike me fokus mjedisin, zonat e mbrojtura, turizmin etj.




përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	analizohet feedback-u i bashkëpunimit. Në diskutimin me GVB-në, pedagogët dhe drejtuesin e njësisë kryesore u shpjegua mënyra se si merret dhe vlerësohet kontributi i bashkëpunimit me partnerët. Pas vizitës zyrtare dhe kërkesës së ekspertëve, është plotësuar Raporti vjetor i veprimtarisë kërkimore-arsimore dhe shkencore të Departamentit të Gjeografisë. Bashkëpunimet e realizuara kanë luajtur një rol të rëndësishëm në njohjen e studentëve me kërkesat e profesionit dhe në rritjen e mundësive për t'i integruar ata në tregun e punës ose për të vazhduar studimet në nivele më të avancuara. Këto marrëveshje bashkëpunimi kanë kontribuar gjithashtu në forcimin e lidhjeve institucionale përmes organizimit të konferencave dhe projekteve kërkimore. Aktivitetet si GIS DAY, Ditët e Gjeografisë dhe konferencat e fundvitit, të cilat janë organizuar nga Departamenti i Gjeografisë, kanë sjellë vazhdimisht integrimin e institucioneve dhe aktorëve të tjerë, duke pasur si qëllim përforcimin e bashkëpunimit dhe krijimin e mundësive më të gjera për studentët. <i>Evidenca 4_Rregullore e Universitetit të Tirants, Kreu II</i> <i>Evidenca 21_Marrëveshjet e bashkëpunimit</i> <i>Evidenca 21.1_Lista e Institucioneve bashkepunuese</i> <i>Evidenca 14_Raporti i tregut të punës Bachelor</i> <i>Evidenca 18.1 Aktivitetet Shkencore, Departamenti i Gjeografisë</i> <i>Evidenca 60 - Praktikë punësimi për PA</i>			
Konkluzione	<i>Nga takimet në Institucion dhe dokumentacioni i dorëzuar GVJ konkludon se njësia bazë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione të tjera të arsimit të lartë, institucione kërkimore, agjenci kombëtare dhe kompani, të cilat ofrojnë mundësi për praktika profesionale dhe angazhim në projekte kërkimore. Marrëveshjet përfshijnë mundësi për shkëmbim studentësh, stazhe dhe angazhimin në kërkime ndërkombëtare. Ky sistem bashkëpunimi dhe monitorimi siguron një përgatitje të plotë dhe të avancuar të studentëve për karrierën e tyre profesionale, duke i lidhur ngushtë me sektorët akademikë dhe industrialë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X




II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi Bachelor në: "Gjeografi" është i organizuar në përputhje me legjislacionin kombëtar, duke përfshirë Ligjin nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor" dhe Vendimin Nr. 41, datë 24.1.2018, i cili përcakton elementet e programeve të studimit. Programi është i strukturuar në 3 vite akademike, me një total prej 180 ECTS kredite, të ndara në 6 semestra. Kjo strukturë është në përputhje me Sistemin Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS), i cili synon harmonizimin e sistemit të arsimit të lartë në Evropë. Plani mësimor i programit të studimit paraqet një përputhshmëri me Statutin dhe Rregulloren e UT. Lëndët janë me 4 dhe 5 ECTS, duke patur ndryshime në numrin e orëve mësimore. <i>Evidenca1_Ligji nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Neni 73, pika 1;</i> <i>Evidenca29_Vendim Nr. 41, datë 24.1.2018 — Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë, pika 2.1.</i> <i>Evidenca2_Statuti i Universitetit të Tiranës, Neni 93</i> <i>Evidenca4 Rregullore e Univeritetit të Tiranës, Kreu 1, Neni 31, Mbi organizimin e studimeve</i> <i>Evidenca81_Sistemi Evropian i Transferimit të Krediteve (ECTS) https://education.europa.eu/en/education-levels/hisecr-education/hirher-education-initiatives/inclusive-and-connected-hi-her-education/european-credit-transfer-and-accumulation-scheme</i> <i>Evidenca5 Rregullore e Programit Bachelor Neni 3</i>
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale	Programi Bachelor në: "Gjeografi" synon të ofrojë njohuri teorike dhe praktike në fusha të ndryshme të gjeografisë, si gjeografia fizike, humane, ekonomike dhe teknologjitet e informacionit gjeohapësinor. Ai është strukturuar në përputhje


Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	me Strategjinë e Zhvillimit të UT-së dhe kërkesat e tregut të punës, duke u mbështetur gjithashtu në prioritetet e zhvillimit të vendit për periudhën 2021-2025. Ky program ofron një përgatitje akademike që lidhet ngushtësisht me zhvillimin e teknologjisë dhe dixhitalizimin, të cilat kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në transformimin ekonomik dhe zhvillimin shoqëror, kulturor dhe arsimor të vendit. Referuar analizës së kurrikulës dhe syllabuseve, që nga viti i parë i studimeve, studentët pajisen me aftësi për të përdorur shprehjet akademike, etikën e shkrimit, sistemet e citimeve dhe problemet që lidhen me plagjiaturën. Në vitet pasuese, programi thekson rëndësinë e detyrave të kursit dhe projekteve që përqendrohen në problematikat teorike dhe praktike të fushës. Programi synon të ofrojë një kurrikul që jo vetëm ofron njohuri të thelluara në fushën gjeografike, por gjithashtu përgatit studentët për të aplikuar këto njohuri në tregun e punës. <i>Në RVB nuk janë përshkruar objektivat e programit të studimit, nuk është përshkruar struktura e programit të studimit, element, të cilat janë të parashikuara në Rregulloren e Programit të studimit dhe mund të shërbenin në funksion të përmbushjes së këtij kriteri.</i> <i>Evidenca3 _Strategjia e zhvillimit te Universitetit të Tiranës</i> <i>Evidenca13 _ Plani Mësimor Bachelor Gjeografi</i> <i>Evidenca14 _ Raporti Tregu i punes Bachelor në Gjeografi</i>					
Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Programi është ndërtuar në përputhje me VKM 41/2018 përsa i përket përmbajtjes sipas kategorive: Lëndë bazë, Lëndë karakterizuese, Lëndë plotësuese, Lëndë ndërdisiplinore dhe Detyrime përmbyllesë. Secila lëndë ka një ngarkesë specifike në kredite, sipas udhëzimeve të Vendimit Nr. 41 dhe rregullores së Universitetit të Tiranës, si më poshtë: dhëna <table><tr><td>Lendet bazë (A): 15% - 20 % të totalit te krediteve;</td></tr><tr><td>Lëndët Karakterizuese (B): 50%-55% të totalit të krediteve;</td></tr><tr><td>Lëndët nderdisiplinore/integruese (C): 12%-15% të totalit të krediteve;</td></tr><tr><td>Lëndët plotësuese (D): 10% - 15 % të totalit të krediteve;</td></tr><tr><td>Detyrime përmbyllëse (E): 3% - 5% të totalit të krediteve.</td></tr></table> Në këtë kuadër, GVJ konstaton se veprimtaritë formuese nuk	Lendet bazë (A): 15% - 20 % të totalit te krediteve;	Lëndët Karakterizuese (B): 50%-55% të totalit të krediteve;	Lëndët nderdisiplinore/integruese (C): 12%-15% të totalit të krediteve;	Lëndët plotësuese (D): 10% - 15 % të totalit të krediteve;	Detyrime përmbyllëse (E): 3% - 5% të totalit të krediteve.
Lendet bazë (A): 15% - 20 % të totalit te krediteve;						
Lëndët Karakterizuese (B): 50%-55% të totalit të krediteve;						
Lëndët nderdisiplinore/integruese (C): 12%-15% të totalit të krediteve;						
Lëndët plotësuese (D): 10% - 15 % të totalit të krediteve;						
Detyrime përmbyllëse (E): 3% - 5% të totalit të krediteve.						

	janë të përcaktuara qartë. Referuar Evidencës 50, Tabela 9 veorimtaritë formuese janë të ndara në këtë mënyrë: Lëndët Bazë: 13.4%; Lëndët Karakterizuese: 57.2%; Lëndët Ndërdisciplinore/Integruese: 15.6%; Lëndët Plotësuese: 9.4% dhe detyrimet Përmbyllëse 4.4%, cka bie ndesh me Vendimin Nr. 41. <i>Evidenca5_Rregullore e Bachelor Gjeografi, Neni 3</i> <i>Evidenca 13 Plani Mesimor Bachelor Gjeografi</i> <i>Evidenca 4 Rregullore e Universitetit të Tiranës, Pjesa m, Kreu I</i> <i>Evidenca 28_ UDHËZIM Nr.31., Dt.29.12.2017, "Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe procedurave për hapjen, riorganizimin, mbylljen e programeve të studimit të institucioneve të arsimit të lartë"</i> <i>Evidenca 29_ Vendim Nr. 41, datë 24.1.2018</i> <i>Evidenca 50_ Tabela Permbledhese/ Tabela 9,10.</i>
Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Referuar dokumentacionit të ngarkuar në ASCAL (Evidenca 22.1) programi përfshin praktikën në terren, e cila në vitin e parë ka 3 ECTS, në vitin e dytë ka 4 ECTS dhe në vitin e tretë ka 5 ECTS. Ndërkohë, detyrimet përmbyllëse janë parashikuar në 8 ECTS. Pas kërkesës së ekspertëve, u plotësua dokumentacioni me një relacion për zhvillimin e praktikës në terren. Përsa i përket detyrimeve përmbyllëse, ato përfshijnë përgatitjen e punimit të diplomës, të vlerësuar me 8 kredite. Megjithatë, gjatë vizitës në institucion, u diskutua për mënyrën si organizohet praktika. Departamenti caktoi një grup pedagogësh për organizimin dhe ndjekjen e saj. Vlerësimi i studentëve gjatë praktikës në terren bazohet në rregulloren e programit të studimit, si dhe në kriteret e përcaktuara në Rregulloren e praktikës në terren. <i>Evidenca1_ Ligji nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Neni 35, Neni 70, Neni 72, Neni 76</i> <i>Evidenca2 Statuti i Universitetit të Tiranës, Neni 93</i> <i>Evidenca4_Rregullore e Universitetit të Tiranës, Pjesa e III, Kreu</i> <i>Evidenca22.1_Rregullore e praktikës në terren</i>




	<i>Evidenca5_Rregullore e Bachelor Gjeografi</i>
Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	N/A
Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtësë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Programi Bachelor në: “Gjeografi” nuk është i krahasueshëm me programe të ngjashme në institucione të tjera, sepse në shumicën e tyre ai ofrohet i integruar me disiplinën e Historisë. I vetmi Universitet që ofron një përputhshmëri deri në masën mbi 70% të programit dhe të përmbajtjes akademike të lëndëve është Universiteti i Shkodrës. Përtej tyre, institucionet e tjera ofrojnë një program të ngjashëm. • <i>Evidenca 13: Plani mësimor i programit Gjeografi</i> • <i>Evidenca 54: Programi mesimor i programit bachelor ne Gjeografi, te Universitetit te Shkodres “Luigj Gurakuqi”</i>
Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Bazuar në VKM Nr. 310, dt 11.05.2022 për specifikimet dhe kodifikimet e programeve të studimit të ofruara nga IAL-të, si dhe në udhëzimet e MAS, kodifikimi i fundit për këtë program studimi është bërë në Nëntor të vitit 2024. Procesi nuk ka ecur më tej dhe GVJ konstaton se evidencat, syllabuset dhe takimet me stafin akademik konfirmojnë mungesën e mëtejshme të kodifikimit të lëndëve të programit Kodi i programit të studimit është: 63BA0229S - <i>Evidenca 16: Silabuset</i> - <i>Evidenca 53: Kodifikimi I ofruar nga IAL (nëntor 2024)</i>
Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve	N/A

të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.				
Konkluzione	Në bazë të analizës së mësipërme, si dhe dokumentacionit të dorëzuar, Standardi II përmbushet kryesisht pasi Programi Bachelor në “Gjeografi”, në përgjithësi është i organizuar dhe i administruar në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe standardet evropiane. Departamenti i Gjeografisë ka një staf akademik të kualifikuar dhe infrastrukturë të përshtatshme për të mbështetur procesin e mësimdhënies dhe të nxënies. Përveç kësaj, programi është i përditësuar dhe i përshtatur me kërkesat e tregut të punës, duke siguruar që studentët të pajisen me njohuri dhe aftësi të nevojshme për karrierën e tyre profesionale. <i>Rekomandim: GVJ rekomandon qartësimin dhe rishikimin e strukturës së veprimtarive formuese, në mënyrë që shpërndarja e krediteve ndërmjet kategorive të lëndëve të jetë plotësisht në përputhje me kërkesat e Vendimit nr. 41, datë 24.1.2018, si dhe të sigurojë balancë të qëndrueshme ndërmjet përmbajtjes bazë, karakterizuese dhe ndërdisiplinore të programi</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Njësia kryesore (FHF) përmbush detyrimet ligjore në lidhje me numrin e njësive bazë dhe numrin e pedagogëve dhe gradat/titujt në përputhje me nenin 23 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. Departamenti i Gjeografisë, në Universitetin e Tiranës ka struktura dhe procese të organizuara në përputhje me kërkesat ligjore dhe akademike si më poshtë: Stafi akademik: Departamenti i Gjeografisë ka 22 anëtarë të stafit akademik (për vitin akademik 2024-2025), nga të cilët 7 profesorë, 6 profesorë të asociuar,

5 doktorë, 3 anëtarë janë në proces doktorature, si dhe një Master Shkencor.

- Stafi i ftuar dhe me kontratë: mbulon lëndët e karakterit bazë dhe karakterizuese.
- Sekretaria mësimore: përgjigjet për regjistrimet, dokumentacionin e studentëve dhe koordinimin e provimeve dhe transferimeve, duke siguruar një mbarëvajtje të rregullt të programit.
- Biblioteka: ofron akses të drejtpërdrejtë në materialet për studentët dhe pedagogët, duke mbështetur mësimdhënien dhe kërkimin shkencor.

Departamenti i Gjeografisë për tri vitet akademike ka në përbërjen e tij:

Tituj/Grada	2022-2023		2023-2024		2024-2025	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.dr	7	1	7	-	7	-
Prof.Asc.Dr	4		5	-	6	1
Dr/Doc	9	1	8	1	5	1
Msc	4	1	4	1	4	-
Totali	24	3	24	2	22	2

Evidencial_ Ligji nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Neni 14, Neni 35, Neni 106; Neni 6, pika 1, Neni 14, 15; Kreu III, Neni 17, pika 1; Kreu X, neni 104, pika 1, Neni 106.

Evidenca2 Statuti i Universitetit të Tiranës, neni 140

Evidenca79 Manual për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë e të studimit.

Evidenca13_ Plani Mësimor Bachelor Gjeogra
Evidenca17_ CV e stafit PAE dhe PAK
Evidenca18_Veprimtaria shkencore e PA l
Evidenca7_Rregullore e Sekretarisë mësimore
Evidenca10_Rregullore e Bibliotekës.

Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Njësia kryesore (FHF) dhe ajo bazë përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në “Gjeografi”, i përmbushin detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik dhe atë /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, duke përfshirë një laborant me kohë të plotë dhe personel administrativ për të mbështetur procedurat e regjistrimit, matrikullimin e studentëve dhe menaxhimin e informacionit. Sekretaria mësimore luan një rol të rëndësishëm në administratën e procesit mësimor, duke asistuar studentët për regjistrimin e lëndëve, përgatitjen e dokumenteve për provime dhe transferime. <i>Evidenca1_Ligji nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Nent 14, Neni 35, Neni 106; Nent 6, pika 1, Neni 14, 15; Kreu III, Nent 17, pika 1; Kreu X, neni 104, pika 1, Nent 106.</i> <i>Evidenca79_Manual për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit.</i> <i>Evidenca12_Shkresa per akreditimin e programit të studimit Bachelor Gjeografi Evidenca39 Mbi krijimin e GVB për programin Bachelor Gjeografi Evidenca38_Vendim i Dekanatit për krijimin e NJSBC në FHF Evidenca2_Statuti i Universitetit të Tirants, Neni 67, 68, 69, 74 Evidenca4_Rregullore e Universitetit të Tirants, Nent 25, 26</i> <i>Evidenca13_Plani Mesimor Bachelor Evidenca17_ CV e stafit PAE dhe PAK Evidenca7_Rregullore e Sekretarisë mësimore Evidenca10_Rregullore e Bibliotekës</i>
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në	Emërtimi i koordinatorit të programit të studimit nuk është i parashikuar në Rreguloren e programit Bachelor në: “Gjeografi” por është përcaktuar me Vendimin të datës 11.11.2024. Gjatë takimeve me grupet e përcaktuara u diskutua roli dhe rëndësia e koordinatorit të këtij program. Ai është përgjegjës për menaxhimin dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale, si dhe siguron përputhshmërinë e programit me objektivat akademike dhe kërkesat e shoqërisë.

përputhje me objektivat e tij.	<i>Evidencial Ligji 80/2015 për Arsimin e Lartë</i> <i>Evidenca 3_Strategjia e zhvillimit të Universitetit UT</i> <i>Evidenca 6 Rregullore e NJSBC Neni 7 (Nuk nevojitet)</i> <i>Evidenca 19_Koordinatori i programit Bachelor ne Gjeografi (Vendimi është marrë në kuadër të procesit të akreditimit-11.11.2024? (Arben Belba)</i> <i>Evidenca 20_Koordinatorët e Programeve të Studimit (Shkresa është e parregullt- mungon data, nr.vendimit, nrprotokollit (e emra te tjere) dhe përplasjet me Evidencen 19)</i>			
Konkluzione	GVJ, nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe takimet në Institucion vlerëson se Njësia kryesore dhe Njësia bazë, përmbushin detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, angazhimin edhe të personelit ndihmës akademik /administrativ etj. GVJ konstaton se koordinatori i programit është i ngarkuar për organizimin e ndërveprimeve të departamentit me studentët, mbikëqyrjen e realizimit të praktikës, koordinimin me drejtuesin e kursit të praktikës profesionale për organizimin e praktikës dhe kërkimin e informacionit prej tij në lidhje me zbatimin e programit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Departamenti përgjegjës për programin e studimit Bachelor në: "Gjeografi" disponon të dhënat e kërkuara për strukturën, organizimin dhe përmbajtjen e programit të studimit, përfshirë kurrikulën, shpërndarjen e lëndëve dhe rregulloret. Ky departament zotëron të gjithë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë dhe Kërkimin Shkencor dhe Statutin e Universitetit të Tiranës (UT). Referuar RVB-së, i gjithë informacioni për programin e studimit, personelin akademik dhe aktivitetet që zhvillohen janë lehtësisht të

	aksesueshme për studentët dhe publikun nëpërmjet faqes zyrtare online të fakultetit (www.fhf.edu.al), por, pas konfirmimit të marrë për aksesin në faqe, ajo përmban një informacion minimal, aspak të aksesueshëm nga studentët. Programi dokumentohet nëpërmjet planeve mësimore dhe syllabuseve të lëndëve, por mungon rregullorja e departamentit. Bazuar në dosjen e plotë të programit të studimit, në përmbajtjen e syllabuseve, në mënyrën e konceptimit të orës së mësimi, kontrollit të njohurive, të fuarit në leksion, evidentohet që pedagogët përpiqen pikërisht të bashkojnë nevojat lokale me ato globale. <i>Evidenca 1 Ligji nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",</i> <i>Evidenca 2 Statuti i Universitetit të Tiranës, Pjesa e Tretë, Organizimi, Struktura, Elementet e Studimeve;</i> <i>Evidenca 4 Rregullore e Universitetit të Tiranës</i> <i>Evidenca 5 Rregullore e programit bachelor</i> <i>Evidenca 13 Plani Mësimor Bachelor Gjeografi</i> <i>Evidenca 16 Silabuset</i> <i>Evidenca 29 VKM, Vendim Nr. 41, date 24.1.2018, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e arsimit të lartë"/ shtojca nr. 1.</i>
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Mbështetur në VKM 41/2018, Statutin dhe Rregulloren e UT, programi i studimit Bachelor në: "Gjeografi" përmban detajet e nevojshme për ndarjen e lëndëve dhe moduleve sipas semestrave, si dhe ngarkesën mësimore të lëndëve dhe aktiviteteve jashtë auditorit. Veprimtaritë formuese janë të ndara në leksione dhe seminare, duke përdorur metoda interaktive dhe raste studimore. Vlerësimi i dijeve bëhet përmes testeve të ndërmjetme dhe atyre përfundimtare, dhe përgatitja e punëve praktike dhe detyrave të kursit është thelbësore për aftësimin e studentëve. Ekspeditat dhe praktikat në terren janë një komponent i rëndësishëm i programit, me 12 kredite (ne total për 3 vite) që shndërrohen në 200 orë pune praktike. Për më tepër, strukturimi i krediteve është i ndarë në kategori të qarta: Lëndë bazë: 24 kredite (13.4% e totalit),

	Lëndë karakterizuese: 103 kredite (57.2% e totalit), Lëndë ndërdisiplinore/integruese: 28 kredite (15.6% e totalit), Lëndë plotësuese: 17 kredite (9.4% e totalit), Detyrime përmbyllëse (tema e diplomës): 8 kredite (4.4% e totalit). Orët e punëve të pavarura të studentit në çdo vit të programit të studimit zënë jo më pak se gjysmën e fondit të përgjithshëm të 1500 orëve mësimore vjetore. Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion, GVJ vlerëson se është e nevojshme një rishikim i shpërndarjes së krediteve midis kategorive të lëndëve, në mënyrë që të sigurohet përputhshmëria e plotë me kërkesat e Vendimit nr. 41, datë 24.1.2018 dhe të mos tejkalohet % e veprimtarive formuese A dhe C. Për çdo lëndë të përfshirë në programin e studimit janë të përcaktuara kreditet, ngarkesa mësimore në orë mësimore, orët javore në auditor dhe orët jashtë auditorit, forma e shlyerjes së tij. Syllabuset e lëndëve, përcaktojnë mënyrën e vlerësimit ku përgjithësisht është zgjedhur një sistem vlerësimi që i jep provimit përfundimtar peshë të konsiderueshme (me një mesatare prej 60%). Jo në të gjitha syllabuset ndiqet i njejtë format i formave të vlerësimit, por pavarësisht kësaj respektohet VKM nr.41. <i>Evidenca 13 Plani mësimor Bachelor Gjeografi</i> <i>Evidenca 50_Tabelat përmbledhese Tabela 9, Tabela 9/1.</i> <i>Evidenca 2 _Statuti i Universitetit të Tiranës</i> <i>Evidenca 4 _Rregullore e Universitetit të Tiranës</i> <i>Evidenca 5 _Rregullore e Bachelor Gjeografi</i> <i>Evidenca 16 Silabuset</i> <i>Evidenca 22.1 Rregullore e praktikës në terren</i>
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Kriteret e pranimit të studentëve në Programin e studimit Bachelor në “Gjeografi” janë kriteret ligjore të përcaktuara nga MAS dhe udhëzimet që dalin për regjistrimet në universitete çdo vit akademik. Sipas RVB, në çdo vit akademik, Departamenti ofron propozime mbi kriteret dhe numrin e kuotave të studentëve që mund të pranohen, duke u bazuar në kapacitetet akademike dhe infrastrukturore të departamentit. Ky proces është në përputhje me udhëzimet e Statutit të Universitetit të Tiranës dhe vendimet e Senatit të UT. Kjo siguron transparencë dhe përshtatshmëri me kërkesat ligjore për pranimin e studentëve. Gjatë takimeve me grupet e punës vërtetohet një informacion i tillë. Transferimi i studentëve është




	i rregulluar në bashkëveprim me sekretarinë mësimore, e cila lehtëson mbarëvajtjen e këtij procesi, bazuar në dokumentacionin ligjor dhe administrativ të nevojshëm për menaxhimin e procesit të pranimi dhe transferimit të studentëve. Ky dokumentacion përfshin planet mësimore, programet e lëndëve, veprimtarinë shkencore, dhe listat e studentëve sipas viteve. Ky informacion është i aksesueshëm dhe i administruar në laboratorin e departamentit dhe përmes sekretarisë mësimore për të siguruar një menaxhim të qartë dhe të strukturuar të procesit mësimor dhe administrativ. Dokumentacioni shtetëror dhe rregulloret që lidhen me të drejtën e pranimi dhe transferimit të studimeve janë të administruara nga përgjegjësi i departamentit dhe janë pjesë e bazës ligjore të drejtimit të punës në departament, duke siguruar që çdo student të ketë mundësinë të transferojë dhe ekuivalentojë studimet në përputhje me aktet dhe rregulloret përkatëse. <i>Gjatë takimeve me përgjegjësin e departamentit, grupin hartues të RVB-së, Stafin Akademik dhe sekretarinë mësimore mësuam se pavarësisht se parashikohet transferimi i studentëve mungon një praktikë e tillë, me pretendimin se nuk ka patur transferim të studentëve për vitet e marra në akreditim.</i> <i>Evidenca 1 Ligji nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë...”</i> <i>Evidenca 2 _Statuti i Universitetit të Tiranës, Neni 89/Neni 14</i> <i>Evidenca 4 Rregullore e Universitetit të Tiranës, Neni 78,</i> <i>Evidenca 62 _Kriteret e pranimi per vitin 2024-2025</i> <i>Evidenca 61 _Kuotat e pranimi te studenteve per vitin akademik</i> <i>Evidenca 7 _Rregullore e Sekretarisë Mësimore të FHF</i> <i>Evidenca 68 Lista e numrit të studentëve të regjistruar</i>
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikant, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët	Programi i studimit Bachelor në: “Gjeografi” përmban informacionet e nevojshme, të përcaktuara sipas VKM, nr. 41, për programet lëndore. Titullari i secilës lëndë ofron informacion të detajuar mbi kreditet e lëndës, listën e leximeve për çdo temë, laboratorët, aktivitetet jashtë klasës, dhe formën e kontrollit të njohurive. Praktikant dhe seminarin janë të përfshira në programin e studimit dhe mundësojnë zhvillimin e aftësive praktike dhe analitike të studentëve. Këto aktivitete janë të detajuara në syllabuset e lëndëve, që specifikojnë orët

formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	e laboratorët dhe organizimin e seminareve. Programi përfshin aktivitetet jashtë auditorit, praktikën në terren dhe eksperimentet laboratorike, të cilat janë të dokumentuara dhe të integruara në përmbajtjen e lëndëve për t'i ofruar studentëve mundësitë për të zbatuar teoritë në situata reale dhe për të zhvilluar aftësi praktike. Përdorimi i bibliotekës dhe burimeve dixhitale është një nevojë e plotësuar nga departamenti sepse studentët janë të udhëzuar për përdorimin e tyre. <i>Evidenca 2 _Statuti i Universitetit të Tiranës</i> <i>Evidenca 4 _Rregullore e Universitetit të Tiranës</i> <i>Evidenca 13 _Plani Mësimor Bachelor Gjeografi</i> <i>Evidenca 16 _Silabusët</i> <i>Evidenca 10 _Rregullore e Bibliotekës</i> <i>Evidenca 25.2 _Biblioteka digjitale JSTOR</i> <i>Evidenca 28 _Udhëzim Nr.31., Dt.29 12.2017, Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit.....”</i> <i>Evidenca 29 _Vendim Nr. 41, datë 24.1.2018, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”</i>
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Për të plotësuar kërkesat e tregut, përmbajtja e programit Bachelor në “Gjeografi” duhet të përditësohet dhe përmirësohet vazhdimisht. Referuar RVB, departamenti ka një praktikë të përditësimit të syllabuseve dhe leksioneve të lëndëve në mënyrë periodike, si një proces i strukturuar që realizohet në fillim të çdo viti akademik, siç kërkohet nga rregulloret e Universitetit të Tiranës (UT). Programi i studimit reflekton ndryshime profilizuese deri në masën 20%, (referuar shkresës së MAS) për të siguruar që ai të jetë i përshtatshëm me zhvillimet më të fundit në fushën e gjeografisë dhe kërkesave të industrisë, dhe të mundësojë që studentët të kenë njohuri dhe aftësi që i përgjigjen nevojave të tregut të punës. Pas kërkesës së ekspertëve për plotësim dokumentacioni, u vu në dispozicion praktika e ndryshimeve në kurrikul si më poshtë: - Kalime lëndësh nga një vit në një vit tjetër dhe ndryshim kreditesh (Bazat e SIG, Gjeografi Politike)

	- Kalime lëndësh nga një semestër në një semestër tjetër (Projekt në SIG, Pedogjeografi) - Propozim për të shtuar/hequr lëndë me zgjedhje (Hyrje në metodat e krijimit të bazës së të dhënave të bazës Gjeohapësinore; Bazat Gjeografike të zhvillimit të Turizmit) <i>Evidenca 2 _Statuti i Universitetit të Tiranës, Neni 19</i> <i>Evidenca 4 _Rregullore e Universitetit të Tiranës/Neni 5, pika 3</i> <i>Evidenca 50 _Tabelat permbledhese, Tabela 11</i> <i>Evidenca 16 Silabuset.</i> <i>Evidenca 6 _Praktika e ndryshimeve ne kurrikul</i>			
Konkluzione	<i>Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ), bazuar në analizën e kriterëve 1–5 të Standardit II.3, si dhe në gjetjet e evidentuara nga dokumentacioni i dorëzuar/përditësuar dhe takimet e zhvilluara gjatë vizitës në Institucionin e Arsimit të Lartë (IAL), vlerëson se Programi i Studimit Bachelor në: "Gjeografi" është hartuar dhe zbatohet në përputhje me kriteret dhe dispozitat ligjore në fuqi. Programi ka pësuar përmirësime në përbërjen e programeve të lëndëve, gjë që dëshmon një qasje dinamike dhe të orientuar drejt cilësisë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të	Nga vizita në institucion dhe konsultimi me planet mësimore dhe rregulloret përkatëse, programi Bachelor në "Gjeografi" dhe syllabuset e tij plotësojnë njëra-tjetrën, duke i lejuar studentët të zgjerojnë arsimin e tyre dhe të zhvillojnë aftësi që do të jenë të dobishme si për punë ashtu edhe për studime në të ardhmen. GVJ konstaton se ka një shpërndarje të duhur të orëve të mësimi ndërmjet leksioneve dhe seminareve, ngarkesa mësimore e lëndës në kredite ECTS, dhe integrimi i njohurive


Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al


mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	teorike me studimet e rasteve, detyrat e lëndëve dhe përvojën praktike i lejojnë studentët të zhvillojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre. Kjo është e mbështetur nga Strategjia e Zhvillimit të Universitetit të Tiranës, që synon rritjen e mundësive për punësim dhe zhvillimin e aftësive që lidhen drejtpërdrejt me kërkesat e tregut të punës. Praktikrat në terren dhe aplikimet praktike ofrojnë mundësi për studentët të zbatojnë njohuritë teorike në kontekste reale, gjë që rrit mundësitë për punësim dhe angazhim në sektorë profesionalë të gjeografisë dhe menaxhimit të mjedisit. Megjithëse programi është i orientuar drejt zhvillimit të aftësive për punësim, ka mundësi për të përfshirë më shumë mundësi për studentët që të angazhohen në projekte ndërkombëtare dhe shkëmbime akademike që mund të ndihmojnë në rritjen e eksponencës ndërkombëtare në një kontekst global. <i>Evidenca 1_ Ligji nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"</i> <i>Evidenca 2 Statuti i Universitetit të Tiranës</i> <i>Evidenca 4_Rregullore e Universitetit të Tiranës</i> <i>Evidenca 16 Silabuset</i> <i>Evidenca 13_Plani Mësimor Bachelor Gjeografi</i>
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënërit.	Programi i studimit përmban lëndë të kategorizuara si bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore/integruese dhe plotësuese, që janë të shpërndara në vitet e programit dhe semestrat përkatës. Kjo ndarje mundëson një formim të balancuar dhe të plotë në fushën e gjeografisë dhe siguron që studentët të kenë një kuptim të gjerë të disiplinës dhe aftësive profesionale. Metodrat e mësimdhënies janë të orientuara drejt zhvillimit të aftësive analitike, kërkimore dhe praktike, duke përfshirë detyrat individuale dhe projektet në grup, që janë pjesë integrale e të gjitha moduleve. Kjo përfshirje e metodave të ndryshme mësimore kontribuon në rezultatet e pritshme të të nxënërit, duke siguruar një aftësim të qëndrueshëm dhe të thellë të studentëve. Shpërndarja e lëndëve dhe strukturimi i krediteve është i qartë dhe ndihmon në realizimin e objektivave të programit. <i>Evidenca 2 Statuti i Universitetit të Tiranës</i> <i>Evidenca 4_Rregullore e Universitetit të Tiranës</i>

	<i>Evidenca 13_ Plani Mësimor Bachelor Gjeografi</i> <i>Evidenca 16_ Silabuset</i> <i>Evidenca 28 Udhëzim Nr.31., Dt.29.12.2017, "Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe procedurave për hapjen, riorganizimin, mbylljen e programeve të studimit të institucioneve të arsimit të lartë"</i> <i>Evidenca 29_ Vendim Nr. 41, datë 24.1.2018, "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë"</i>
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	Struktura e programit, lëndët dhe titujt e tyre, si dhe ngarkesa e krediteve janë të gjitha në përputhje me Sistemin Evropian të Transferimit të Kredive (ECTS), i cili është përshtatur me sistemin e Bolonjës, si dhe me akte dhe rregulla të tjera nënligjore që rregullojnë arsimin e lartë dhe aktet e brendshme të institucionit. Programi është i strukturuar në përputhje me kërkesat akademike dhe ligjore, që i përngjan edhe programeve të ngjashme ndërkombëtare. Ai siguron një përgatitje të plotë për studentët, duke përmbushur profilin dhe objektivat e programit. <i>Evidenca 2_ Statuti i Universitetit të Tiranës</i> <i>Evidenca 4_ Rregullore e Universitetit të Tiranës</i> <i>Evidenca 13_ Plani Mësimor Bachelor Gjeografi</i> <i>Evidenca 16_ Silabuset</i> <i>Evidenca 28 Udhëzim Nr.31., Dt.29.12.2017, "Për dokumentacionit dhe procedurave për hapjen, riorganizimin mbylljen e programeve të studimit të institucioneve të arsimit të lartë"</i> <i>Evidenca 29_ Vendim Nr. 41, datë 24.1.2018, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë"</i>
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave	Nga analiza e syllabuseve dhe takimi me studentët, GVJ konstaton se studentët mund të përforcojnë njohuritë e tyre teorike dhe t'i zbatojnë ato në praktikë falë raportit leksion/seminar/praktikë. Programi garanton një balancim të mirë mes formimit teorik dhe praktik, duke mundësuar arritjen e objektivave formuese, transferimin e studimeve, mobilitetin




formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	akademik, dhe punësimin e studentëve pas përfundimit të studimeve. Raporti teori/ praktikë u siguron studentëve të zhvillojnë aftësi praktike përmes praktikave në terren. Fakulteti ofron mundësi për transferim studimesh nga programe të ngjashme dhe mundësi mobiliteti akademik, në përputhje me aktet normative të universitetit dhe fakultetit, por kjo praktikë nuk mbështetet me dokumentacion nga departamenti. Ndërkohë, në suplementin e diplomës ka mjaft informacione për të lejuar transferimin e krediteve dhe njohjen e krediteve. <i>Evidenca 1 Ligji nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"</i> <i>Evidenca 2 Statuti i Universitetit të Tiranës, Neni 89</i> <i>Evidenca 4 Rregullore e Universitetit të Tiranës, Neni 78, 79, 80, 81, 82,83 Evidenca13_ Plani Mesimor Bachelor</i> <i>Evidenca 16_Silabuset</i> <i>Evidenca 28_Udhëzim Nr.31., Dt.29.12.2017, "Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe procedurave për hapjen, riorganizimin, mbylljen e programeve të studimit të institucioneve të arsimit të lartë"</i> <i>Evidenca 29_Vendim Nr. 41, datë 24.1.2018, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë"</i>
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Në takimin në institucion me personelin akademik të Departamentit të Gjeografisë, na u theksua që: Programet e lëndëve të programit të studimit Bachelor në: "Gjeografi", përditësohen në mënyrë të vazhdueshme në koherencë me nevojat e tregut të punës duke i zhvilluar temat e leksioneve me literaturë dhe botime bashkëkohore. Personeli akademik na informoi se kjo ishte bërë e mundur edhe falë plotësimit të kërkesave të tyre, me literaturë të përditësuar, Gjithashtu ka ndihmuar në përditësimin e leksioneve dhe seminareve edhe lëvizja e pedagogve me mobilitete në universitete të ndryshe jashtë vendit. Programi i studimit pëson ndryshime profilizuese deri në masën 20%, duke siguruar përputhshmëri me kërkesat e industrisë dhe përmirësimin e vazhdueshëm të ofertës

	akademike. Një ndryshim i tillë konfirmohet pas kërkesës së ekspertëve për plotësim dokumentacioni mbi ndryshimet në kurrikul. Konkretisht: Bazat e SIG (viti III, Sem I kalon nw Vitin e II, Sem I), Gjeografi Politike (Viti II, Sem II kalon nw Vitin III, Sem I), Projekt në SIG (Viti III, Sem II kalon nw Sem I), Pedogjeografi (Viti II, Sem I kalon nw Sem II), Lwnda “Hyrje në metodat e krijimit të bazës së të dhënave të bazës Gjeohapësinore” propozohet si lwndw e re mw zgjedhje; Lwnda “Bazat Gjeografike të zhvillimit të Turizmit” propozohet tw hiqet” <i>Evidenca 28_Udhëzim Nr.31., Dt.29.12.2017, “Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe procedurave për hapjen, riorganizimin, mbylljen e programeve të studimit të institucioneve të arsimit të lartë”</i> <i>Evidenca 29_ Vendim Nr. 41, datë 24.1.2018, “Për elementët e programeve të studimit të ofiuara nga institucionet e arsimit të lartë”</i> <i>Evidenca l6 Silabuset</i> <i>Evidenca 6_Praktika e ndryshimeve nw kurrikul</i>
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Qëllimi dhe objektivat e këtij programi studimi janë në përputhje të plotë me qëllimin që Ligji i Arsimit të Lartë i atribuon programeve bachelor. Struktura dhe përmbajtja e programit, përmbajtja e syllabuseve, raporti teori-praktikë synon të garantojë formimin më të mirë të studentëve nga pikëpamja e njohurive dhe aftësimit praktik, për t’ju përgjigjur dinamikave të tregut lokal dhe global. Ky program është mbështetur në objektivat e Planit Strategjik të Departamentit të Gjeografisë dhe në Strategjinë e Zhvillimit të Universitetit të Tiranës 2018-2023, duke siguruar që studentët të zhvillojnë aftësi të thelluara profesionale në fushat e edukimit gjeografik, mjedisor, dhe gjeohapësinor. Këto aftësi janë të zhvilluara përmes një mësimdhënieje profesionale nga një staf i kualifikuar dhe në një mjedis infrastrukturor dhe teknologjik që përmbush të gjitha kërkesat dhe standardet akademike të programit. <i>Evidenca 3_Strategjia e zhvillimit te Universitetit te Tiranës</i> <i>Evidenca l3 Plani Mesimor Bachelor Gjeografi</i> <i>Evidenca l6 Silabuset</i>




	<i>Evidenca 29 Vendim Nr. 41, datë 24.1.2018</i> <i>Evidenca 35 Plani strategjik i zhvillimit të programit të Gjeografisë</i>			
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Programi ofron zhvillimin e aftësive dhe kompetencave profesionale në fushat përkatëse, të cilat janë thelbësore për karrierën profesionale të studentëve. Për më tepër, studentët që përfundojnë studimet në programin Bachelor në “Gjeografi” kanë mundësi të vazhdojnë studimet në tre programe master që ofron Departamenti i Gjeografisë, duke siguruar një mundësi të fortë për përgatitje të mëtejshme akademike dhe për të rritur mundësitë për punësim në fusha të ndryshme profesionale. Një e dhënë e tillë mbështetet fuqishëm edhe nga studimi për tregun e punës, realizuar së fundmi nga Departamenti i Gjeografisë. Programi Bachelor në “Gjeografi” përmbush Kriterin 7, pasi mundëson vijimin e studimeve të mëtejshme dhe punësimin e studentëve në përputhje me kërkesat dhe pritshmëritë e tregut të punës. <i>Evidenca 3 Strategjia e zhvillimit të Universitetit të Tiranës</i> <i>Evidenca 13 Plani Mësimor Bachelor Gjeografi</i> <i>Evidenca 16 Silabuset</i> <i>Evidenca 14 Raporti i tregut të punës Bachelor</i>			
Konkluzione	<i>Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ), bazuar në analizën e kriterëve 1–7 të Standardit II.4, si dhe në gjetjet e evidentuara nga dokumentacioni i dorëzuar dhe takimet e zhvilluara gjatë vizitës në Institucionin e Arsimit të Lartë (IAL), vlerëson se: Programi i Studimit është hartuar dhe zbatohet në përputhje me kriteret ligjore në fuqi. Struktura, organizimi dhe përmbajtja e tij janë të harmonizuara me objektivat formues të programit, me nivelin përkatës të kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, si dhe me Kornizën Shqiptare të Kurrikulës së Gjeografisë. Programi synon zhvillimin e kompetencave të nevojshme për punësimin e të diplomuarve në përputhje me kërkesat e tregut të punës, ndaj përmbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Referuar RVB, dokumentacionit të vënë në dispozicion, si dhe informacionit të grumbulluar gjatë vizitës në institucion, vërehet se ekzistojnë praktika të mira të bashkëpunimit mes departamentit dhe institucioneve përkatëse. Departamenti i Gjeografisë ka organizuar tryeza diskutimesh për të përmirësuar programin Bachelor në "Gjeografi", në kuadër të përputhjes me kërkesat e tregut të punës. Kjo është bërë duke mbështetur ndryshimet me një analizë të thelluar të rezultateve të tregut të punës dhe bashkëpunimit me institucionet partnere, siç është evidentuar në Evidencën 28, e cila mbështet angazhimin për përmirësimin e programit përmes bashkëpunimit me aktorët dhe institucione të tjera. <i>Evidenca 28: Udhëzimi Nr. 31, 29.12.2017</i> <i>Evidenca 29: Vendimi Nr. 41, datë 24.1.2018</i> <i>Evidenca 18.1 Aktivitetet shkencore, Departamenti I Gjeografisë</i> <i>Evidenca 21. Marrëveshjet e bashkëpunimit</i>
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Referuar RVB, Departamenti i Gjeografisë ka organizuar takime me studentët dhe ka integruar përfshirjen e studentëve dhe studentëve të diplomuar në përmirësimin e vazhdueshëm të programit. Kjo përfshin konsultimet me studentët dhe realizimin e aktiviteteve që mundësojnë një lidhje të fortë me komunitetin e ish-studentëve, duke ofruar mundësi për vlerësimin e kërkesave dhe sugjerimeve nga studentët. Nga takimi me studentët arritëm të shihnim përfshirjen e tyre në praktika të tilla. Përfshirja e studentëve në diskutimet e përmirësimit të programit bëhet përmes rrugëve formale dhe joformale. Drejtuesja e departamentit, pedagogët u shprehën gjatë takimeve në institucion që në mënyrë periodike takohen dhe diskutojnë me studentët për elementët e programit të studimit, përmbajtjen e lëndëve, zhvillimin e procesit mësimor etj. <i>Evidenca 26: Pyetësoret e studentëve</i> <i>Evidenca 34: Raporti i pyetësorëve të studentëve</i> <i>Evidenca 51: Linku për shpalljen e alumnëve</i>

	<i>Evidenca 47; Lista e studentëve AIUMNI</i>			
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Njësia përgjegjëse modifikon dhe riorganizon programet e studimit në kuadër të marrëveshjeve të shumta të bashkëpunimit që departamenti ka me departamente, institucione dhe aktorë të sektorit publik dhe privat. Institucioni fiton përvoja pozitive nga universitetet e huaja nëpërmjet mobilitetit të pedagogëve dhe studentëve përmes projekteve Erasmus + dhe Ceepus. Ai ka mbështetur një lidhje të fortë me rjetet profesionale dhe shoqatat profesionale, duke përfshirë mundësi për angazhim të studentëve në aktivitete të drejtuara nga këto rrethe. Kjo ka ndihmuar në zhvillimin e aftësive profesionale dhe përgatitjen për punësim. <i>Evidenca 16: Syllabuset</i> <i>Evidenca 28_Udhezim nr.31., date 29.12.2017_Per percaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe procedurave per hapje, riorganizimin, mbylljen e programeve te studimit te IAL.pdf</i> <i>Evidenca 29_VKM nr.41., date 24.01.2018_Per elementet e programeve te studimit te ofruara nga IAL.pdf</i>			
Konkluzione	<i>Në takimet e ndryshme në Institucion dhe nga dokumentacioni i dorëzuar dhe i shqyrtuar gjatë vizitës në Institucion, GVJ arriti në përfundimin se Departamenti ka në vëmendje dhe ndërmerr aktivitete për të realizuar dhe nxitur përfshirjen e studentëve, partnerëve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit për ta realizuar me sukses dhe në përputhje me objektivat e vendosura. Departamenti ka prioritet përmirësimin dhe përditësimin e kurrikulave në shërbim të njohurive të nevojshme për përgatitjen e profesionistëve të ardhshëm.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1 Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Në programin e studimit Bch në “Gjeografi”, sipas dokumentacionit në DVV, RVB, por edhe në takimet që GVJ zhvilloi në institucion, konstaton se format e mësimdhënies që përdoren në procesin mësimor janë metodat standarde si leksione, seminare, praktika në terren, detyrat e kursit dhe tema të diplomave. Format e lartpërmendura mbeten të hapura për përmirësime dhe pasurohen periodikisht me elementë të rinj. <i>Evidenca 5_Rregullore e Bachelor Gjeografi. Neni 2, pika d;</i> <i>Evidenca 13_Plani Mësimor Bachelor Gjeografi;</i> <i>Evidenca 16_Silabuset;</i>
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Personeli akademik njeh dhe respekton diversitetin e karaktereve dhe interesave individuale të studentëve dhe i përshtat metodat e mësimdhënies dhe mësimnxënies në përputhje me këto veçori. Raporti midis formave të ndryshme të mësimdhënies dhe mësimnxënies ndryshon në varësi të natyrës së moduleve të programit, duke tentuar që në vitin e tretë të studimeve të rrisë kontaktin e drejtpërdrejtë të studentëve me objektet konkrete të profesionit të tyre të ardhshëm, nëpërmjet rritjes së peshës së praktikave mësimore dhe profesionale në raport me format e tjera të mësimdhënies/mësimnxënies. Për tu ardhur në ndihmë nevojave të studentëve për më shumë informacion dhe dije DGJ në UT aplikon konsultime me studentët, nga personeli akademik në periudhën përpara provimeve. Kjo u konfirmua edhe nga studentët, gjatë takimit që GVJ të jashtëm zhvilloi gjatë vizitës në institucion. <i>Raporti Bachelor Gjeografi;</i> <i>Evidenca 77_Orari i konsultimeve;</i> <i>Evidenca 16_Silabuset;</i> <i>Vizita në institucion, takimi me studentët;</i>

Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxëniet.	UT përkatësisht FHF dhe DGJ e mbështesin personelin akademik të Programit të Studimit Bch në “Gjeografi” në përmirësimin e kompetencave të tyre didaktike nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme lidhur me aftësitë mësimdhënëse. Kështu personeli akademik i DGJ ka përfunduar me sukses ciklin e Programit të formimit Pedagogjik dhe Psikologjik për lektorët e UT me tematikë “Bazat e mësimdhënies në arsimin e lartë”, të organizuar nga UT. Krahas kësaj forme UT ofron mbështetje për rritje të aftësive mësimdhënëse edhe nëpërmjet mobiliteteve akademike për mësimdhënie, ftesës së lektorëve të huaj, vënien në dispozicion të laboratoreve me teknologji bashkëkohore të integruar si dhe trajnimeve në kuadër të evenimenteve të posaçme si leksionet e hapura, etj. Efektive në këtë drejtim ka qenë edhe njohja dhe përdorimi i metodave online të mësimdhënies si platforma Classroom, Edumeeet, Microsoft Office 365 dhe Microsoft Teams në kohën e pandemisë. <i>Evidenca 18.1 _Aktivitetet Shkencore, Departamenti i Gjeografisë;</i> <i>Evidenca 24 _Infrastruktura FHF;</i> <i>Evidenca 8 _Rregullore dhe udhëzues për mësimin online;</i> <i>Evidenca 18 _Veprimtaria shkencore 2021-2024;</i>
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Personeli i angazhuar në Programin e Studimit Bch në “Gjeografi” është i mirëkualifikuar në përzgjedhjen e tij, po ashtu dhe i përditësuar në aktivitetin mësimdhënës nëpërmjet trajnimeve brenda e jashtë vendit. Departamenti i Gjeografisë ka 22 anëtarë të stafit akademik, përfshirë 7 Prof.Dr, 6 Prof. Assoc. Dr dhe 5 Dr, ndërsa 4 anëtarë janë në proces doktorature. Njësia kryesore (FHF) dhe ajo bazë përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në “Gjeografi” në përmbushje të detyrimeve e përcaktuara në legjislacionin në fuqi dhe kompetetnt për shpjegimin e njohurive ka angazhuar personel ndihmës akademik për realizimin e praktikave mësimore me nivel kualifikimi Phd në proces. Në këtë kontekst personeli akademik i DGJ në FHF, UT është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve si dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit. Këtë e konfirmuan edhe studentët e këtij programi gjatë vizitës që GVJ realizoi. Studentët vunë theksin në nivelin e lartë të

	njohurive që kanë mundur të përfitojnë si rrjedhojë e nivelit të lartë shkencor dhe pedagogjik të personelit të DGJ. <i>Evidenca 17_ CV e stafit PAE dhe PAK;</i> <i>Raporti Bachelor Gjeografi;</i> <i>Evidenca 15_Te dhenat e personelit akademik;</i> <i>Vizita në institucion, takimi me studentët;</i>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se DGJ është struktura përgjegjëse për programin e studimit. Ajo përdor dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike. Vlerësimin e vazhduar dhe ndikimin që ai ka në mësimdhënie e kryen duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sygjërimet e tyre. Vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies DGJ e kryen nëpërmjet NJSBC-së së FHF e cila realizon me studentët pyetësorë lidhur me qëndrimet dhe sugjerimet e studentëve për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, trajtimit të lëndës, përdorimit të metodave dhe teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies, vlerësimin etj. Kontrole të vazhdueshme kryhen edhe nga ana e autoriteteve drejtuese të institucionit si dhe strukturave që merren me sigurimin e cilësisë dhe performancës në nivel universiteti dhe fakulteti. Gjatë takimit me personelin akademik të DGJ në FHF, GVJ u informua se vetë personeli akademik në përfundim të moduleve apo kurseve që lektorojnë zhvillojnë anketime me studentët në të cilat vjelin mendimet dhe sygjërimet lidhur me elementet që ata do të dëshironin të përmirësoheshin në të ardhmen si cilësia e mësimdhënies, format e përcjelljes së njohurive, mënyra e lektorimit etj, me qëllim përmirësimin e punës së tyre. <i>Raporti Bachelor Gjeografi;</i> <i>Evidenca 34_Raporti i pyetësorit të studentëve;</i> <i>Vizita në institucion, takimi me personelin akademik të DGJ në FHF;</i>
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies,	Nga shqyrtimi i DVV dhe dokumeteve shoqëruese konstatohet se UT dhe FHF organizon struktura në nivel institucional për promovimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ato janë: 1. KPSSC, komisioni i përhershëm për sigurimin e standarteve të cilësisë në nivel universiteti.

koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	Veprimtaria e tij është e përcaktuar me një rregullore të posaçme. 2. Njësinë e Sigurimit të Brendëshëm të Cilësisë është ngritur dhe funksionon pranë FHF e cila në koordinim me drejtuesit e njësisë kryesore dhe njërive bazë organizojnë pyetësor semestral dhe vjetor me studentët dhe personelin akademik për të përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme mësimdhënien. Mbështetur në rezultatet e pyetësorëve strukturat përgjegjëse në UT, FHF dhe DGJ hartojnë trajnime për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies, veçanërisht për personelin akademik që kanë më pak përvojë ose janë në hapat e para të mësimdhënies dhe karrierës profesionale. Gjatë vizitës në institucion, takimi me drejtuesen e zyrës së NJSBC së FHF, GVJ u njoh konkretisht me mënyrën dhe përmbajtjen e pyetësorëve. Ishte shumë mbresëlënëse përdorimi i teknologjisë për realizimin e procesit dhe ruajtjen e anonimatit lidhur me perceptimet e studentëve. Kjo tregon për një nivel të lartë profesional të punës, përgjegjësisë dhe përkushtimit e cila padyshim që reflektohej dhe në hartim e raportit perfundimtar. <i>Për të siguruar dhe për të ruajtur standartet e të nxënit e për t'i përmirësuar ato me sfidat e kohës instiucioni ka ngitur struktura të posaçme si KPSSC dhe NJSBC të cilat demostrojnë nivel të lartë profesionalizmi në përfomimin e punës së tyre</i> <i>Evidenca 38_Vendim i Dekanatit per krinjimine NJSBC ne FHF.</i> <i>Evidenca 37_KPSSC Rregullorja e Sigurimit te Cilesise; Raporti Bachelor Gjeografi;</i> <i>Shënimet nga vizita në institucion;</i> <i>Evidenca 26_Pyetesoret e studenteve;</i> <i>Evidenca 34_Raporti i pyetesorit te studenteve;</i> <i>Evidenca 36_Paketa e Instrumentave te Cilesise;</i>
Konkluzione	<i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat në IAL, GVJ konkludon se UT, FHF, DGJ garanton procesin e të nxënit duke përdorur metoda të larmishme, profesionale të gërshetuara me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve. Për të siguruar që ky proces të ruajë standartet dhe ti përmirësojë ato në të ardhmen instiucioni ka ngitur struktura të posaçme si KPSSC dhe NJSBC të cilat</i>

	<i>demonstrojnë nivel të lartë profesionalizmi në përfomimin e punës së tyre.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2 Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Nga shqyrtimi i rregullores së UT, përkatësisht nenit 57 “Kontrolli i dijeve dhe instrumentet e vlerësimit” rezulton se vlerësimi i progresit dhe përvetësimi rezultateve të të nxënit realizohen nëpërmjet Kontrollit të dijeve dhe instrumentave të vlerësimit. Instrumentet mbi të cilat bazohet vlerësimi janë: A. “Ndjekja e veprimtarive mësimore që është e përcaktuar në nenin 74 të rregullores së UT”; B. Vlerësimi i vazhduar që përfitohet nga kontrolli i vazhduar i në leksione, seminare, ushtrime, laboratorë, praktika; b/1 Mjetet që përdoren për kontrollin e vazhduar janë testimet me shkrim, testimet me gojë, bashkëbisedime, kontrole ndërmjetëse, detyra kursi, punë në grup, projekteve, prezantimeve, eseve, raporteve, performancave të ndryshme, tezave të diplomës, etj. C. Vlerësimi përfundimtar i cili është shumatrore e vlerësimit të vazhduar gjatë gjithë vitit dhe vlerësimi në provimin përfundimtar. Në këtë rregullore parashikohen raste përjashtuese dhe specifikime në varësi të karakterit dhe statusit të lëndës. Në pikën 4 të kësaj rregullore përcaktohet se në “Në rregulloret e brendëshme të secilës njësi përcaktohen elelmetë të tjerë specifike, të cilët ndihmojnë në rritjen e cilësisë së kontrollit të dijeve”. <i>Për të dhënë një panoramë më të qartë se si ky sistem vlerësimi parashikohet në mënyrë specifike në Fakultetin Histori-Filologji dhe Departamentin e Gjeografisë GVJ duhej të shfrytëzonte edhe rregulloret e njësisë kryesore dhe asaj bazë, por në mungesë të tyre GVJ iu referua për konkludim Rregullores së Programit të studimit Bch në “Gjeogarfi”.</i>

Në Nenin 8, pika a dhe b, shprehet se "kontrolli i dijeve realizohet përgjatë semestrit nëpërmjet një provimi final gjithëpërfshirës si dhe formave të tjera të vlerësimit detyrë kursi, vlerësim në seminare, nëse ato janë të parashikuara në syllabusin e lëndës. Provimi është forma kryesore përfundimtare në vlerësimin e një lënde, por në rregullore thuhet që kontrolli i dijes me provim të një lënde përcaktohet nga titullari i lëndës dhe bëhet me shkrim ose i kombinuar me gojë, duke u mbështetur në programin mësimor". Ndërsa në pikën e shprehet se, "rregulla apo specifika të provimeve pesha (përqindja e provimeve), detytrave të laboratorëve në vlerësimin përfundimtar, literature, referencat e konvertimit në notë etj përcaktohen në syllabusin e lëndëve të hartuara nga pedagogu dhe u bëhen të ditura studentëve që e ndjekin atë kurs".


Duke qenë se mënyra e vlerësimit përcaktohet konkretisht në syllabuset e çdo lënde në bazë të specifikave të saj, GVJ nga shqyrtimi i tyre konstaton se forma e vlerësimit është një miksim i mjeteve të kontrollit të njohurive që është i ndryshëm në syllabuse të ndryshme.

Gjithashtu GVJ konstaton se, nuk ka një model vlerësimi të unifikuar për çdo program mësimor. Formula e vlerësimit është e ndryshme në syllabuse të ndryshme si nga lloji i formave të kontrollit që aplikohen ashtu edhe nga shpërndarja e përqindjeve për secilën formë, në varësi të personelit akademik që e zhvillon këtë lëndë, (shqyrtimi është bërë për ato syllabuse që janë vënë në dispozicion nga institucioni).

Lidhur me frekuentimin në syllabuset si Bazat e Gjeologjisë, Hyrje në Hartografi, Klimatologjia, Hyrje në Gjeografinë Humane, Hyrje në Gjeografinë Fizike, Gjeografia e Bujqësië, Gjeografia e Bashkimit Europian, project në SIG (Sistemet e Informacionit Gjeografik), norma e frekuentimit të seminareve është 70% duke mos u respektuar rregullorja e UT ku frekuentimi i seminareve është i detyrueshëm në masën 75%. Ndërsa në syllabuset e lëndëve Gjeografia e Europës Juglindore, Gjeografia Sociale Urbane, norma e frekuentimit 75% gjendet i zbatueshëm.

GVJ konstaton se kjo përqindje e pjesëmarrjes së vlerësimeve për studentët është gjithëkontrolluese dhe kontribuon në përvetësimin e përmbajtjes së lëndëve përkatësisht moduleve. Edhe pse formulat e vlerësimit janë të larmishme në kushtet e lirisë akademike nga ana e personelit akademik, GVJ

	<i>konkludon se mjetet e vlerësimit të vazhduar duhet të kenë një masë të mirëpërcaktuar vlerësimi, në formën e një shkalle dhe të shprehura konkretisht në rregulloret e Fakultetit dhe Departamentit të Gjeografisë e për rrjedhojë edhe në rregulloren e Programit të studimit duke mos lënë hapsira për krijimin e premisave për keqinterpretime.</i> <i>Evidenca 4 _Rregullore e Universitetit të Tiranës</i> <i>Evidenca 5 _Rregullore e Bachelor Gjeografi, Kreu III, Neni 7.</i> <i>Evidenca 16 _Silabuset</i>
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion si dhe takimeve me personelin akademik dhe studentët, GVJ mësoi që studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve. <i>Raporti Bachelor Gjeografi;</i> <i>Shënimet nga vizita në institucion;</i> <i>Evidenca 16 _Silabuset</i>
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Për PS Bsc në “Gjeografi” testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në format e mëposhtme: (Neni 40: Format e kontrollit të dijeve, Rregullore e Studimeve UGJ) • Frekuentimi i detyrueshëm i seminareve dhe ushtrimeve në masën 75 %; • Testim me shkrim, me gojë; • Ese, detyra kursi, punë në grup, projekte, prezantime; • Pjesmarrja në provimet e ndërmjetme (2) dhe provimi përfundimtar; • Praktika; • Dorëzimi dhe mbrojtja e mikrotezës; Informimi dhe sqarimi i studentëve për mënyrat dhe masën e vlerësimit bëhet edhe nga tutorët përkatës, që caktohen për çdo program studimi. <i>Evidenca 4 _Rregullore e Universitetit të Tiranës</i> <i>Evidenca 5 _Rregullore e Bachelor Gjeografi, Kreu III, Neni 7.</i> <i>Evidenca 16 _Silabuset</i>




Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Nga shqyrtimi DVV rezulton se, personeli akademik i DGJ-së në FHF, kryen sondazhe vlerësuese me qëllim përmirësimin e formave e metodat të mësimdhënies në mënyrë të vazhduar. Edhe gjatë takimeve që GVJ pati me studentët e këtij program studimi u konfirmua pjesmarrja e tyre në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre. Jo vetëm personeli akademik por edhe NJSBC realizon me studentët pyetësorë për vlerësim. Koordinatorja institucionale gjatë takimit në institucion konfirmoi se institucioni iu refrohet vlerësimeve dhe sugjerimeve të studentëve dhe i merr ato në konsideratë për të rritur cilësinë e mësimdhënies, trajtimit të lëndës, përdorimit të metodave, etj. <i>Evidenca 5_Rregullore e Bachelor Gjeografi;</i> <i>Evidenca 16_Silabuset;</i> <i>Evidenca 34_Raporti i pyetesorit te studenteve;</i> <i>Vizita në institucion, takimi me personelin akademik të DGJ në FHF;</i>
Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Nga shqyrtimi i DVV dhe RVB GVJ konstaton se, format me të cilat UT kontribon në mundësimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike janë: ▪ Investimi në infrastrukturën e mësimdhënies, ku auditorët janë të pajisur me teknologji bashkëkohore të mësimdhënies; ▪ Ngritja e laboratorëve të arkeologjisë dhe gjeografisë të cilët mundësojnë demonstrimin e materialeve të vizualizuar në funksion të mësimdhënies, realizimin e projekteve, praktikave mësimore etj; ▪ Ngritja e Labororit të SIG-ut nga aplikimin për projekte të infrastrukturës në kuadër të ERASMUS +; ▪ Hartimit të udhëzuesve për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme inovative të mësimdhënies; ▪ Përfshirjen e personelit akademik në mobilitete në kuadër të programeve ERASMUS +, të BE; GVJ konstaton që në Programin e studimit Bch në “Gjeogarfi” format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë tek studentët. Për këtë kontribuojnë posaçërisht detyrat dhe projektet individuale në të cilat kërkohet drejtimi i orientuar nga mësimdhënësit si dhe projektet dhe detyrat në grup ku, përpos mësimdhënësit, kontribuojnë edhe studentët pjestarë të grupit. Po ashtu dhe zgjedhja e temave të diplomave dhe realizimi i tyre forcon

	punën e pavarur të studentit dhe konfirmon vlerën e rolit udhëheqës të personelit akademik. Në realizimin e këtyre detyrave/projekteve ndërtohen edhe marrëdhënie të respektit reciprok midis tyre. <i>Raporti Bachelor Gjeografi;</i> <i>Shënimet nga vizita në institucion;</i> <i>Evidenca 34_Raporti i pyetesorit te studenteve;</i> <i>Evidenca 18.1_Aktivitetet Shkencore, Departamenti i Gjeografisë;</i>			
Konkluzione	<i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat në IAL, GVJ konkludon se UT, harton rregullore në të cilën përcakton format e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre, ndërsa FHF dhe DGJ nuk paraqesin rregullore. GVJ në rregulloren e programit të studimit Bch në "Gjeografi" konstaton se vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale është i larmishëm dhe në varësi të programit të lëndës të përcaktuara nga titullari i lëndës. Larmia e formave të vlerësimit i jep mundësi pjesëmarrjes së vlerësimeve për studentët, është gjithëkontrolluese dhe kontribuon në përvetësimin e përmbajtjes së lëndëve përkatësisht moduleve. Edhe pse formulat e vlerësimit janë të larmishme në kushtet e lirisë akademike nga ana e personelit akademik.</i> <i>GVJ rekomandon që mjetet e vlerësimit të vazhduar duhet të kenë një masë të mirëpërcaktuar vlerësimi, në formën e një shkalle dhe të shprehura konkretisht në rregulloret e Fakultetit të Histori-Filologji dhe Departamentit të Gjeografisë e për rrjedhojë edhe në rregulloren e Programit të studimit duke mos lënë hapsira për krijimin e premisave për keqinterpretime.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.3	
Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.-	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive	Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion si dhe takimeve me personelin akademik dhe studentët, GVJ konstaton se testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe

profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	aftësive profesionale realizohet në mënyrë të vazhduar gjatë gjithë vitit akademik. Për PS Bch në “Gjeografi” testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në format e mëposhtme: <i>(Neni 57: Kontrolli i dijeve dhe Instrumentet e vlerësimit, Rregullore e Studimeve Bch në “Gjeografi”, DGJ)</i> • Frekuentimi i detyrueshëm i seminareve dhe ushtrimeve në masën 75 %; • Testim me shkrim, me gojë; • Ese, detyra kursi, punë në grup, projekte, punë në grup, prezantime; • Pjesëmarrja në provimet e ndërmjetme (2) dhe provimin përfundimtar; • Praktika; • Dorëzimi dhe mbrojtja e mikrotezës; Informimi dhe sqarimi i studentëve për mënyrat dhe masën e vlerësimit bëhet edhe nga titullarët e lëndëve përkatëse, që caktohen për çdo program studimi. Gjatë vizitës në institucion, në takimin me studentët, GVJ mësoi që studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve. <i>Evidenca 34_Raporti i pyetesorit te studenteve;</i> <i>Evidenca 5_Rregullore e Bachelor Gjeografi;</i> <i>Evidenca 16_Silabuset;</i> <i>Evidenca 34_Raporti i pyetesorit te studenteve;</i> <i>Shënimet nga vizita në institucion;</i> <i>Evidenca 4_Rregullore e Universitetit të Tiranës;</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	GVJ konstatoi që, UT, FHF, DGJ vë në zbatim projektin CLEANSORE të financuar nga AADF për testimin dhe vlerësimin elektronik. Kjo u confirmua edhe nga personeli akademik që ka aplikuar sistemin CLEANSORE gjatë vizitës në institucion. <i>Raporti Bachelor Gjeografi;</i> <i>Evidenca 57_Praktika Clean Score;</i> <i>Vizita në institucion</i>
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me	Për plotësimin e këtij kriteri zbatohet detyrimi i përcaktuar në rregulloren e UT dhe të programit të studimit Bch në “Gjeografi”. Vlerësimi përfundimtar bëhet nga mesatarja

syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	aritmetike e vlerësimit të vazhduar. Nga shqyrtimi i syllabuseve GVJ konsaton se, bazuar në rregulloren e programit të studimit sipas së cilës titullari i lëndës, mbështetur në lirinë akademike përcakton jo vetëm llojin e elementëve të vlerësimit të vazhduar por edhe masën në përqindje të tyre. Skeda e vlerësimit është e ndryshme në syllabuse të ndryshme dhe në lëndë të ndryshme. Vlerësimi është bërë duke u mbështetur vetëm në syllabuset e vëna në dispozicion, pasi nuk janë paraqitur të gjithë syllabuset e lëndëve të programit të studimit. <i>GVJ sygjeron që, pa cënuar lirinë akademike dhe pa dëmtuar shumëllojshmërinë e formave të vlerësimit në shërbim të objektivave të programeve mësimore, vlerësimet të kenë masa të mirëpërcaktuara në përqindje, si kufirin maximal ashtu edhe minimal për çdo element të vlerësimit të vazhduar dhe të mirëpërcaktuara në rregulloret e FHF dhe DGJ, me qëllim rritjen e transparencës përkundrejt aktorëve të përfshirë në proces.</i> <i>Evidenca 4_Rregullore e Universitetit të Tiranës;</i> <i>Evidenca 5_Rregullore e Bachelor Gjeografi;</i> <i>Evidenca 16_Syllabuset;</i>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënës për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Në takimin që GVJ zhvilloi me sekretarinë mësimore mësoi që vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale për çdo rast i bëhet e ditur studentit duke i dhënë shpjegime për përgjigjet dhe duke e bindur atë që vlerësimi është i drejtë. Gjatë diskutimeve të tilla lektori i tregon studentit çfarë është bërë gabim dhe si duhet bërë që përgjigja të ishte e saktë. Në këtë proces studenti ndihmohet që të përmirësohet në të ardhmen. <i>Raporti Bachelor Gjeografi;</i> <i>Evidenca 4_Rregullore e Universitetit të Tiranës;</i> <i>Evidenca 5_Rregullore e Bachelor Gjeografi;</i> <i>Evidenca 16_Syllabuset;</i> <i>Shënime nga vizita në institucion</i>
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Në të gjitha testet dhe mënyrat e vlerësimit pedagogu (në rastin e detyrave të kursit, punëve laboratorike, realcioneve të praktikës profesionale) apo komisioni (në rastin e provimeve të lëndëve, mbrojtjes së mikrotezës) shqyrton përgjigjet me përgjegjësinë për të evituar plagjiaturën përkatësisht kopjimin. Në rast të konstatimit studenti vlerësohet negativisht dhe është i detyruar të përsërisë punimin përkatësisht provimin. <i>Evidenca 4_Rregullore e Universitetit të Tiranës;</i>

	<i>Evidenca 5_Rregullore e Bachelor Gjeografi;</i> <i>Evidenca 70_Kodi Etikes i UT.</i>
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Gjatë vizitës në Sekretarinë mësimore, GVJ konstatoi që vlerësimi kryhet me sistem prej 10 notash. Nota me e ulët kaluese është 5. Rezultatet e provimit ju bëhen të njohura studentëve nga platforma Pitagora, ose edhe me komunikim verbal dhe individual nga ana e pedagogut. Në raste kur provimet zhvillohen me shkrim, komisioni shpall dhe çelësin e zgjidhjes. Teza korrigjohet nga komisioni dhe brenda 5 ditëve. Studenteve ju komunikohen rezultatet paraprake nëpërmjet sistemit E-student. Pas marrjes së vlerësimit pedagogu i lëndës, me kërkesën e studentit, bën shpjegimet lidhur me vlerësimin. Gjate vitit pedagogët janë të lirë të kombinojnë metodat kontrolluese dhe vlerësuese të cilat përfshijnë kontroll të vazhdueshëm nëpërmjet provimeve, teste me pyetje alternative, prezantime ne grup ose individuale, etj. Çdo student mund të hyjë dhe të informohet më parë me statusin për notat, detyra kursi, pagesat, data provimesh etj në hapësirën <i>on-line</i> për studentët në E-student. <i>Evidenca 5_Rregullore e Bachelor Gjeografi;</i> <i>Evidenca 7_Rregullore e Sekretarisë mësimore;</i> <i>Evidenca 67_Manuali perdorimit te sistemit E-Student;</i>
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Nga shyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se Satuti i UT, neni 50 dhe Rrregullorja e programit te studimit, neni 8 "Rregullat e zhvillimit të provimeve dhe Vlerësimi i lëndës", pika l, neni 11 dhe neni 13 "Ankimimi për rezultatin përfundimtar" dhe "Rishikimi i notës" garantojnë të drejta e studentëve për tu njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit. Gjatë vizitës në institucion, në takimin me studentet, GVJ konfirmoi që ata e njohin te drejtën e tyre për ankimim. Pas shpalljes se rezultateve paraprake nga pedagogu në sistem, studenti ka të drejtën e kontestimit të mundshëm brenda afateve të përcaktuara në rregullore. Pas kontestimit të notës nga studenti, kërkesa e tij për rivlerësim shqyrtohet nga komisioni i provimeve dhe pedagogu i lëndës të cilët më pas vendosin për notën përfundimtare. Mbas kësaj faze, sërish studenti ka të drejtën e kontestimit të notës në instanca më të larta, ku kërkesa shqyrtohet me një komision të veçantë ad-hoc të ngritur nga përgjegjësi i departamentit. <i>Evidenca 2_Statuti i Universitetit të Tiranës. Neni 50;</i>

	<i>Evidenca 4_Rregullore e Universitetit të Tiranës;</i> <i>Evidenca 5_Rregullore e Bachelor Gjeografi; neni 13</i> <i>Evidenca 7_Rregullore e Sekretarisë mësimore;</i> <i>Evidenca 67_Manuali perdorimit te sistemit E-Student;</i>			
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Mbështetur në nenin 50 dhe 51 të Statutit të UT, rregullorja e PS BCh në Gjeografi rregullon procesin e ankimimit për rezultatin përfundimtar në nenin 11, pika a dhe b. Studenti ka të drejtë të ankohet për rezultatin e provimit përfundimtar brenda 48 orëve, nga data e zhvillimit të provimit. Ai paraqet me shkrim pranë Përgjegjësit të Departamentit fletë ankimit. Në rastet kur PD e gjen të pamundur zgjidhjen e ankesës vë menjëherë në dijeni dekanin. Brenda 48 orëve nga marrja e ankesës nga PD, Dekani ngre një komision Ad-hoc i cili verifikon pretendimet e studentit. Me miratim të dekanit komisioni bënë vlerësimin përfundimtar të studentit. Në dokumentacionin që shoqëron RVB GVJ nuk konstatohen dokumente shoqëruese lidhur me një praktikë të tillë. Por, gjatë vizitës në institucion GVJ në takimin me PD pohoi se nuk kanë patur një praktikë të tillë dhe personeli akademik pohoi se raste të tilla ata kanë mundur ti zgjidhin pa qenë e nevojshme që të shkohet deri tek PD apo ngritja e një komisioni Ad-hoc. <i>Evidenca 2_Statuti i Universitetit të Tiranës.</i> <i>Evidenca 4_Rregullore e Universitetit të Tiranës;</i> <i>Evidenca 5_Rregullore e Bachelor Gjeografi;</i>			
Konkluzione	<i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat në IAL, GVJ konkludon se UT, DGJ siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit. GVJ sygjeron që, pa cënuar lirinë akademike dhe pa dëmtuar shumëllojshmërinë e formave të vlerësimit në shërbim të objektivave të programeve mësimore, vlerësimet të kenë masa të mirëpërcaktuara në përqindje, si kufirin maximal ashtu edhe minimal për çdo element të vlerësimit të vazhduar dhe të mirëpërcaktuara në rregulloret e FHF dhe DGJ, me qëllim rritjen e transparencës përkundrejt aktorëve të përfshirë në process.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Struktura e programit është në përputhje me kërkesat ligjore dhe udhëzimet kombëtare referuar Ligjit nr. 80/2015 për Arsimin e Lartë dhe Vendimi nr. 41, datë 24.1.2018, duke klasifikuar lëndët në kategori (bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore, plotësuese, etj.) sipas këtyre udhëzimeve Programi ka implementuar plotësisht Sistemin Evropian të Krediteve (ECTS) – është i organizuar në cikël trevjeçar me 180 kredite, ashtu siç parashikojnë standardet e Kartës së Bolonjës. Nga kontrolli i shpërndarjes së krediteve sipas kategorive GJV konstaton se <i>Kategoria e lëndëve karakterizuese B ka 57.4% të totalit të krediteve duke tejkaluar kufirin e përcaktuar në Vendimi nr. 41, datë 24.1.2018, gjithashtu edhe Kategoria e lëndëve A bazë ka 13% të totalit të krediteve duke mos arritur në normën e përcaktuar në Vendimi nr. 41, datë 24.1.2018. Mbështetur në gjetjen GJV rekomandon rishikimin me ndryshim të shpërndarjes së krediteve në zbatim të Vendimi nr. 41, datë 24.1.2018, edhe pse totali i krediteve të kategorisë B dhe kategorisë A plotësojnë kriterin që së bashku duhet të arrijnë 70% të totalit të krediteve.</i> Programi është në përputhje të plotë me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë bazë, sipas klasifikimit/kodifikimit kombëtar dhe evropian. Kjo do të thotë që përmbajtja dhe drejtimet kryesore të programit janë në harmoni me ekspertizën dhe profilin kërkimor të departamentit. Kurrikula e programit mbulon aspektet themelore të disiplinës së gjeografisë, duke përfshirë studimin e hapësirës gjeografike, planifikimin territorial, menaxhimin e burimeve natyrore e humane, si dhe teknologjitë e informacionit gjeohapësinor, që janë pikërisht fushat ku departamenti zhvillon veprimtarinë e vet akademike. <i>Evidenca 1 Ligji nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.</i> <i>Evidenca 29 Vendim Nr. 41, datë 24.1.2018 — Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë</i>


	<i>Evidenca50_Tabelat permbledhese;</i> <i>Evidenca 53_Kodifikimi i programit të studimit të ofruara nga IAL në RSH;</i>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.	Në programin mësimor të PS Bch në “Gjeografi” garantohej zhvillimi i aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit pasi vetë shprehjetë lëndore të fushës së gjeografisë janë të pasura me aftësi komunikuese, ndërvepruese ku më të shprehura janë në lëndët si Baza SIG-u, praktikat në terren, hyrje në gjeografi humane, sitet arkeologjike, gjuhë e huaj, sporte etj. <i>Evidenca50_Tabelat permbledhese;</i> <i>Evidenca 13_Plani Mësimor Bachelor Gjeografi.</i>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmblylëse.	Që në fillim të zhvillimit të programit të lëndës, studenti njihet me përmbajtjen e syllabusit të hartuar nga titullari i lëndës. Në realizim të programit mësimor, për çdo lëndë të veçantë, analizohen e shqyrtohen kompetencat dhe aftësitë e fituara nga studenti në testet dhe vlerësimet përkatëse, në diskutimet për to si dhe duke tërhequr vlerësimet e të diplomuarve e të punësuarve në këtë program studimi. Gjatë vizitës në institucion, GVJ e konfirmoi këtë edhe në takimet që zhvilloi si me personelin akademik ashtu edhe me studentët e këtij programi <i>Raporti Bachelor Gjeografi;</i> <i>Evidenca 26_Pyetesoret e studenteve</i> <i>Evidenca 34_Raporti i pyetesorit te studenteve</i>
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për	Për plotësimin e këtij kriteri shërben shqyrtimi i aktivitetit që zhvillohet në laboratorët e programit. GVJ konstatoi që laboratorët e vënë në dispozicion të këtij PS ishin të pajisur me programet më të fundit që përdoren për GIS-in e aplikuar. Përdorimi i tyre u jep mundësi studentëve të zhvillojnë e konkretizojnë njohuritë e marra në të gjitha lëndët që karakterizojnë programin. Duke konsultuar planin mësimor dhe syllabuset e lëndëve, GVJ konstaton që zhvillimi i detyrave apo projekteve kërkon punën në grup, e cila mbështetet nga personeli akademik i ngarkuar me zhvillimin e këtij programi si dhe realizohet nga studentët e tij. Në takimin me studentët ata u shprehën të arrirë me funksionimin e punës në grup si dhe evidentuan kontributin e pedagogëve në realizimin me sukses të saj. <i>Raporti Bachelor Gjeografi;</i>

zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	<i>Evidenca 16_Silabuset;</i> <i>Evidenca 13_Plani Mësimor Bachelor Gjeografi.</i> <i>Evidenca 56_Praktika Erasmus+</i> <i>Evidenca 58_Praktika CEEPUS.</i> <i>Shënime nga vizita në institucion</i>			
Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Nga dosja e DVV rezulton se personeli akademik efektiv dhe me kontratë që shërben në PS BCH në “Gjeografi”, zhvillon leksione të hapura, ëorkshope, me kolegë brenda dhe ekspertë të ftuar të jashtëm ku si objekt i tyre janë të rejtat e shkencës së gjeografisë dhe historisë dhe përdorimi i teknologjisë në funksion të tyre. Këto aktivitete i gjejmë të pasqyruara të dokumentuara edhe në raportet vjetore të përgatitura nga DGJ, në planin e veprimtarive vjetore akademike dhe veprimtarive kërkimore shkencore. <i>Raporti Bachelor Gjeografi;</i> <i>Evidenca 18.1_Aktivitetet Shkencore, Departamenti i Gjeografisë;</i> <i>Evidenca 18_Veprimtaria shkencore 2021-2024</i>			
Konkluzione	<i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat në IAL, GVJ konkludon se UT, FHF, DGJ ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programin e studimit Bch në “Gjeografi”. GVJ sygjeron që edhe pse totali i krediteve të kategorisë A dhe B janë në plotësim të rregullorës që së bashku duhet të jenë në masën 70% duhet të plotësojnë kufijtë e kategorive përkatëse sipas VKM.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.5 Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit por edhe RVB konstatohet se UT harton rregullore të studimeve. Në rregulloren e programit të studimit Bch në: “Gjeografi” përcaktohet qartë pragu i notës mesatare, i cili është 6.5 dhe i që i jep të drejtën studentit për të përgatitur dhe mbrojtur një punim diplome. Provimi i përgjithshëm përfundimtar ose punimi i diplomës është i parshikuar në Nenin 67 “Përmbyllja e Detyrimeve të Programit”, Neni 68 “Punimi i Diplomës” “Diplomimi” dhe Neni 69 “Mbrojtja e Diplomës” të Rregullores së UT dhe në Rregulloren e programit të studimit Bch në “Gjeografi” në Neni 15 “Diplomimi”, Neni 16 “Procedura e Diplomimit”, Neni 17 “Procedura e Provimit të Diplomës”. Për procesin e diplomimit UT ka rregullore të detajuar për procedurat e procesit të Diplomimit. <i>Evidenca52_Rregullore per diplomimin në UT;</i> <i>Raporti Bachelor Gjeografi;</i> <i>Evidenca 4_Rregullore e Universitetit të Tiranës;</i> <i>Evidenca 5_Rregullore e Bachelor Gjeografi;</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.	Nga shqyrtimi i DVV dhe RVB-së GVJ konstaton se DGJ përgjegjës për PS dhe personeli akademik vënë në dispozicion të studentëve materiale të nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse. Këto udhëzime janë të pasqyruara në Rregulloren e sekretarisë mësimore të FHF, Rregulloren e Programit të Studimit dhe Programit të provimit të përgjithshëm përfundimtar. Në këtë të fundit pasqyrohen të gjithë konceptet bazë në të cilat studentët duhet të fokusohen në përgatitjen e tyre për provim, dhe literatura bazë. GVJ e konfirmoi këtë edhe në takimin e realizuar me studentët e këtij program studimi gjatë vizitës në institucion. <i>Raporti Bachelor Gjeografi;</i> <i>Evidenca52_Rregullore per diplomimin në UT;</i> <i>Evidenca 5_Rregullore e Bachelor Gjeografi;</i> <i>Evidenca 7_Rregullore e Sekretarisë mësimore.</i>
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e	Nga shqyrtimi i Rregullores së UT Neni 67 pika 3 dhe Rregullores së programit të studimit Bch në “Gjeografi” Neni 17 “Procedurat e provimit të diplomës” konstatohet se, Komisioni i Provimit të Diplomës përbëhet nga 5 (pesë)

njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	anëtarë, Kryetari i komisionit të provimit në bashkëpunim me stafin akademik të grup-lëndëve të programit harton listën e temave të provimit të diplomës e cila Ju vihet në dispozicion studentëve të paktën 2 muaj përpara provimit të diplomimit. Pyetjet janë nga lëndët e kurrikula e programit, ato zgjidhen nga të gjithë lektorët që zhvillojnë lëndët përkatëse që zakonisht janë dhe anëtarët e komisionit Ad-hoc. Ato i dorëzohen kryetarit të komisionit të provimit. <i>Evidenca 4_Rregullore e Universitetit të Tiranës;</i> <i>Evidenca 5_Rregullore e Bachelor Gjeografi;</i> <i>Evidenca52_Rregullore per diplomimin në UT;</i> <i>Evidenca 76_Komisionet e provimeve lendore;</i>
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Në DVV dhe RVB konstatohet se personeli akademik i DGJ, në fillim të vitit të tretë të studimeve BSC përcakton fushat e studimeve për punimin e diplomës. Udhëheqësi i temës së diplomës harton programin e punës për studentin. Në këtë program parashikohen afatet kohore për realizimin e punës sipas etapave, grafiku i konsultimeve të programuara me studentin përgjatë të cilave konsultohet dhe kontrollohet puna e bërë sipas programit të miratuar. Para mbrojtjes së tezës së diplomës, udhëheqësi rishikon dhe miraton punimin e kryer nga studenti dhe aprovon lejen për mbrojtjen e punimit duke firmosur punimin e plotë të diplomës. Punimi i diplomës bëhet duke mbajtur në konsideratë udhëzimet në Manualin e punimit të diplomës, sipas Rregullores së diplomimit në UT. GVJ e konfirmon kryerjen e këtij procesi edhe gjatë takimit me studentët e PS gjatë vizitës në institucion. <i>Evidenca52_Rregullore per diplomimin në UT;</i> <i>Raporti Bachelor Gjeografi;</i> <i>Evidenca 4_Rregullore e Universitetit të Tiranës;</i>
Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	DGJ përgjegjës për zhvillimin e PS Bch në "Gjeografi" drejton dhe administron realizimin e praktikës në terren, që është e pjesë e programit mësimor. Gjatë zhvillimit të praktikës studentët realizojnë testime, pyetësorë dhe intervista, për qëllime studimi, në mjediset e planifikuara në itinerarin e praktikës, nën mbikëqyrjen e personelit akademik dhe në përputhje me objektivin që ka fusha e studimit "Gjeografi". Drejtuesi i njësisë bazë në takimin që zhvillon me studentët në fillim të vitit akademik u komunikon studentëve informacionin mbi kohën e kryerjes, programin, mënyrën e zhvillimit dhe mbrojtjes. Gjithashtu, DGJ ofron

	infrastrukturën mësimore (laboratorët e ARTGIS) për testime edhe në kuadër të përgatitjes së studentit për realizimin e temës së diplomës. Gjatë takimit me studentët, GVJ-së iu konfirmua realizimi i anketave dhe pyetësorëve për qëllime të realizimit të detyrave, projekteve dhe temave të diplomës. <i>Evidenca 22.1_Rregullore e praktikës në terren;</i> <i>Evidenca 5_Rregullore e Bachelor Gjeografi;</i> <i>Vizita në institucion</i>
Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Nga shqyrtimi i Rregullores së studimeve në UT, Neni 49 dhe në rregulloren e programit të studimit Bch në “Gjeografi” Neni 9 konstatohet se, studenti vlerësohet me notë në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së punimit të diplomës. Pas nënshkrimit nga të gjithë anëtarët e komisionit të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose mbrojtjes së punimit të diplomës rezultati pasqyrohet në procesverbalin përkatës. Me marrjen e notës studenti pajiset me kredite të plota, sipas planit mësimor. GVJ e konfirmoi këtë edhe gjatë vizitës në sekretarinë mësimore të UT. <i>Evidenca 4_Rregullore e Universitetit të Tiranës;</i> <i>Evidenca 5_Rregullore e Bachelor Gjeografi;</i> <i>Vizita në institucion</i>
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe nga vizita në institucion GVJ konstaton se UT në përfundim të studimeve, i pajis studentët e PS Bch në “Gjeografi” me diplomë, listën e notave dhe suplementin e diplomës. Ky proces realizohet nga sekretaria mësimore e FHF, e cila pas depozitimit të procesverbaleve të vlerësimit realizon procedurat e pajisjes së studentit me dokumentacionin e diplomimit, duke vënë në dispozicion kopjen e plotë zyrtare të programit të studimit të zhvilluar. Gjithashtu konstatohet se, suplementi i Diplomës për programin e studimit Bachelor në “Gjeografi” është në përputhje me Udhëzimin Nr. 11, datë 02.04.2020 “Për përcaktimin e përmbajtjes dhe formës së Suplementit të Diplomës” të MASR. <i>Evidenca 4_Rregullore e Universitetit të Tiranës;</i> <i>Evidenca 5_Rregullore e Bachelor Gjeografi;</i> <i>Evidenca 7_Rregullore e Sekretarisë mësimore;</i> <i>Evidenca 23_Suplement diploma Bachelor;</i>




	<i>Evidenca 23.1_Diploma Bachelor; Vizita në institucion, takimi në sekretarinë mësimore</i>			
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	UT në zbatim të Nenit 101 të Ligjit të arsimit të lartë, Statutin e UT si dhe Rregulloren e Sekretarisë Mësimore ruan, administron dokumentacionin e studentit në: ▪ regjistrin themeltar të studentëve; ▪ regjistrin e arritjeve akademike; ▪ regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave. Të gjitha proceset e ruajtjes dhe përpunimit të të dhënave personale të studentëve nga institucioni kryhen bazuar në parimin e konfidencialitetit dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale. <i>Evidenca 2 _Statuti i Universitetit të Tiranës. Evidenca 7 _Rregullore e Sekretarisë mësimore; Evidenca 46 _Lista e regjistrave;</i>			
Konkluzione	<i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat ne IAL, GVJ konkludon se UGJ ndjek procedura të qarta të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës. Përmbushet Plotësisht</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit	Për të realizuar objektivat e programit të studimit Bachelor në "Gjeografi", të hartuara nga UT, angazhohet personeli Administrativ si dhe ai Akademik.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.

Rekrutimi i Personelit Akademik kryhet sipas proceduarve ligjore në përputhje me Statutin dhe rregulloret e Institucionit.

Personeli akademik dhe administrativ i programit të studimit Bachelor në “Gjeografi” është i përzgjedhur për të përmbushur objektivat e programit. Ai është i specializuar në fushat përkatëse të shkencës për të dhënë leksionet dhe seminarët e programit, që janë specifike për këtë program. Në evidencat e ofruara nga DGJ, vërtetohet se lektorët e lëndëve janë me grada shkencore, së paku Dr.

GVJ vlerëson gjetjet, edhe gjatë takimeve me lektorët, konstaton se mbulueshmëria e lëndëve në programin e studimit përgjithësisht është me mësimdhënës me grada shkencore Doktor i shkencave dhe Tituj akademikë Prof. Dr dhe Prof.Assoc.

Personeli i angazhuar në zhvillimin e programit të studimit	Viti akademik 2024-2025		Viti akademik 2023-2024		Viti akademik 2022-2023	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof Dr	7	-	7	-	7	1
Prof.Assoc	6	1	5	-	5	-
Dr/Doc	5	1	8	1	8	1
Msc	4		4	1	4	1
Në total	22	2	24	2	24	3

*Raporti Bachelor Gjeografi;
Shënimet nga vizita në institucion;
Evidenca50_Tabelat permbledhese.*

Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

Personeli akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme i cili është angazhuar në 3 vitet e fundit, në programin e studimit Bachelor në “Gjeografi” rezulton me të dhënat si më poshtë:

Bazuar në planin mësimor të miratuar në fillim të çdo viti akademik, bëhet shpërndarja e ngarkesës. Nga verifikimi i të dhënave statistikore, ngarkesa mësimore është mbajtur nga personeli akademik efektiv, sipas të dhënave më poshtë:

Viti akademik	% e ngarkesës mësimore e realizuar nga PAE
2024-2025	91 %

	<table border="1" data-bbox="735 161 1222 248"> <tr> <td>2023-2024</td><td>92 %</td></tr> <tr> <td>2022-2023</td><td>88 %</td></tr> </table> Nga tabela rezulton që për 3 vitet akademike, ngarkesa mësimore për këtë program studimi, përballohet në masën 91% nga personeli akademik efektiv, në përputhje me fushën e kualifikimit dhe fushën kërkimore të anëtarëve të stafit. Ndërsa, rreth 8.3% është zhvilluar nga PAK. <i>Referuar rezultateve të mësipërme GVJ konstaton se, personeli akademik jo vetëm plotëson statndartin e kërkuar të realizmit në masën 70% nga PAE, por e tejkalon ndjeshëm duke treguar qëndrueshmëri të zhvillimit të programit.</i> <i>Raporti Bachelor Gjeografi; Shënimet nga vizita në institucion; Evidenca 50 _Tabelat permbledhese.</i>	2023-2024	92 %	2022-2023	88 %
2023-2024	92 %				
2022-2023	88 %				
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	Institucioni garanton dhe dëshmon qëndrueshmëri të personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit Bachelor në “Gjeografi”. Dega e Burimeve Njerëzore është struktura përgjegjëse dhe ka detyrën për mbajtjen, plotësimin, sistemimin dhe administrimin e dokumentacionit për çdo personel akademik. Referuar pikës 9 të rregullores së Degës së Burimeve Njerëzore ajo është përgjegjëse për hartimin e miratimin procedurave për punonjësit mësimorë dhe jomësimorë dhe harton kontratat përkatëse të punës. Në dokumentacionin shoqërues kontratat e punësimit për çdo personel nuk paraqiten. Gjatë vizitës në institucion, në Degën e Burimeve njerëzore të FHF, GVJ u njoh konkretisht me dokumentacionin për çdo personel akademik që angazhohet në programin e studimit dhe konkretisht me kontratat e punës, të cilat konfirmonin qëndrueshmërin. <i>Raporti Bachelor Gjeografi; Shënimet nga vizita në institucion; Evidenca 9 _Rregulla te deges se Burimeve Njerezore.</i>				
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë	DGJ në FHF, të UT kryen procedurë për rekrutimin e personelit akademik të përcaktuar sipas përcaktimeve të Statutit të UT, neni 67 “Punësimi i personelit akademik me kohë të plotë” dhe Rregullores së UT, neni 25 “Përzgjedhja dhe emërimi i personelit me kohë të plotë. Punësimi në UT bëhet bazuar në legjislacionin e punës në Republikën e				

përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Shqipërisë, aktet ligjore dhe nënligjore të Arsimit të Lartë në RSH dhe statutin e UT. Ai realizohet me procedurë të konkurimit të hapur duke garantuar proces transparent, të paanshëm dhe objektiv. Kriteret që duhet të plotësojë kandidati për personel akademik propozohen nga departamenti përkatës. Nëse, pas verifikimit dekani i njësisë kryesore shpreh dakordësinë kryen shpalljen e vendeve të lira të punës dhe drejtuesi i FHF ia përcjell për miratim Rektorit. Kriteret për rekrutim të personelit akademik janë të klasifikuara në: 1. Kriteret të përgjithshme; 2. Kriteret Specifike të prpozuara nga departamenti Satuti Fazat e procedures së rekrutimit referuar Statutit të UT janë: A. Njësia kryesore kryen shpalljen në faqen zyrtare në internet. B. Drejtuesi i njësisë kryesore ngre një komision ad hoc për përzgjedhjen e knadidatëve fitues. C. Komisioni përbëhet nga pesë anëtar të personelit akademik të kategorisë Profesor (dy përfaqësues të zgjedhur nga Për/dep, dy përfaqësues të zgjedhur nga Dekani dhe një nga rektori). D. Komisioni bën verifikimin e kandidatëve që përmbushin kriteret e përgjithshme dhe specifike E. Vlerësimi i kandidaturave përfshin dy faza: a. Vlerësimi i dosjes b. Intervista F. Kandidatët që kalojnë vlerësimin e dosjes i nënshtohen procesit të intervistimit. G. Brenda tri ditëve komisioni shpall listën e kandidatëve fitues sipas vlerësimit të marrë. - Gj. Lista kalon më pas për miratim nga Rektori brenda dhjetë ditëve Gjatë vizitës në institucion, në takim me Drejtoreshën e Zyrës së Burimeve njerëzore të FHF u shpjeguan prej saj kriteret që përdoren për rekrutimim e personelit akademik të propozuar nga DGJ në funksion të programit të studimit Bachelor në “Gjeografi” dhe hapat e procesit të rekrutimit të stafit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshëm. Konkretisht u njohëm me dosjet e aplikantëve dhe procedurat e kryera nga komisionet ad hoc, të ngritura për këtë qëllim. <i>GVJ kreu kontrollin e një praktike të rastësishme dhe konkludoi që praktika ishte korrekte në përputhje me</i>
---	---

deklarimet e dokumentacionit dhe deklarimit të drejtuesit të BNJ në FHF.

Institucioni realizon vlerësim dhe përzgjedhje të personelit mbështetur në procedurën me tri faza.

1. Në fazën e parë, kryhet shpallja e pozicionit të lirë të punës,
2. Në fazën e dytë vlerësimi me dosje duke krijuar një databazë të aplikantëve
3. Në fazën e tretë kryhet vlerësimi paraprak i aplikantëve nga një komision i përbërë nga Komisioni ad hoc.

Kriteret që duhet të plotësojë kandidati janë:

Kritere të përgjithëshme;

- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojnë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin e punës për të cilin konkurojnë;
- Të ketë përfunduar studimet Master Shkencor dhe/ose të doktoratës në të njëjtën fushë;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata për kryerjen e një vepre penale me dashje nga gjykata;
- Të mos jenë marrë ndaj tyre masa disiplinore

Kriteret specifike janë të përcaktuara në rregulloren e programit të studimit Bch në "Gjeografi" si: Personeli akademik që jep mësim në këtë program duhet të zotërojë titullin Profesor, profesor i asociuar, gradën doktor ose doktoraturë në proces;

GVj konstatoi në kontrollin e dosjeve të aplikantëve që këto kritere zbatoheshin me korrektësi.

Evidenca 2 _Statuti i Universitetit të Tiranës; Evidenca 9 _Rregulla te deges se Burimeve Njerezore.

Evidenca 4 _Rregullore e Universitetit të Tiranës./neni 25; Evidenca 60 _Praktike punesimi per PA.

Minutat e takimeve Bch "Gjeografi"

Evidenca 2, Takimi me Drejtuesen e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të FHF; Evidenca 60 _Praktike punesimi per PA.

Takimi me koordinatoren e Programit te Studimit

Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Mbështetur në të dhënat e paraqitura nga DGJ në evidencën “Tabela Përmbledhëse” dëshmon se garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike, mirëmbajtjes së laboratorit dhe mjediseve të tjera mësimore, në përputhje me natyrën e programit të studimit. Gjatë vizitës në institucion GVJ u takua me punonjësen ndihmëse akademike dhe gjatë takimit u njoh që krahas detyrave të përshkruara më sipër punonjësja ishte e përfshirë dhe kontribuonte gjithashtu edhe në procesin e kërkimit shkencor. <i>Për të siguruar dhe për të ruajtur standartet e të nxëniet e për t’i përmirësuar ato me sfidat e kohës institucioni ka ngitur struktura të posaçme si KPSSC dhe NJSBC të cilat demostrojnë nivel të lartë profesionalizmi në përfomimin e punës së tyre</i> <i>Evidenca 1 _Ligji nr. 802015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin., /neni 66-67, Raporti Bachelor Gjeografi;, Evidenca 4 _Rregullore e Universitetit të Tiranës., Evidenca50 _Tabelat permbledhese.</i> <i>Vizita në institucion.</i>																																									
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e	Të dhënat e institucionit për angazhimin e personelit akademik janë dhënë për një periudhë kohore 3-vjeçare, respektivisht për vitet akademike: 1. VA.2024-2025 2. VA.2023-2024 3. VA.2022-2023 dhënat si më poshtë: <table><tr><th rowspan="2">Personeli i angazhuar në zhvillimin e programit të studimit</th><th colspan="2">Viti akademik 2024-2025</th><th colspan="2">Viti akademik 2023-2024</th><th colspan="2">Viti akademik 2022-2023</th></tr><tr><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>Prof Dr</td><td>7</td><td>-</td><td>7</td><td>-</td><td>7</td><td>1</td></tr><tr><td>Prof.Assoc</td><td>6</td><td>1</td><td>5</td><td>-</td><td>5</td><td>-</td></tr><tr><td>Dr/Doc</td><td>5</td><td>1</td><td>8</td><td>1</td><td>8</td><td>1</td></tr><tr><td>Msc</td><td>4</td><td></td><td>4</td><td>1</td><td>4</td><td>1</td></tr></table>	Personeli i angazhuar në zhvillimin e programit të studimit	Viti akademik 2024-2025		Viti akademik 2023-2024		Viti akademik 2022-2023		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	Prof Dr	7	-	7	-	7	1	Prof.Assoc	6	1	5	-	5	-	Dr/Doc	5	1	8	1	8	1	Msc	4		4	1	4	1
Personeli i angazhuar në zhvillimin e programit të studimit	Viti akademik 2024-2025		Viti akademik 2023-2024		Viti akademik 2022-2023																																					
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK																																				
Prof Dr	7	-	7	-	7	1																																				
Prof.Assoc	6	1	5	-	5	-																																				
Dr/Doc	5	1	8	1	8	1																																				
Msc	4		4	1	4	1																																				

çdo anëtar në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	Në total	22	2	24	2	24	3
	Nga të dhënat GVJ konstaton se, numri i personelit akademik efektiv dhe me kontratë të angazhuar në këtë program studimi është i njëjtë për periudhën tri vjeçare 2022-2025 dhe nëpërputhje me profilin e programit të studimit në të cilin kontribuojnë. Gjithashtu në të dhënat e vëna në dispozicion nga institucioni jepet informacion edhe për angazhimin në procesin e mësimdhënies së çdo anëtri të DGJ sipas semestrave dhe vitit akademik. Krahas personelit akademik efektiv, për realizimin e objektivave të programit të studimit ushtrojnë detyrën edhe koordinatori i programit edhe një personel ndihmës akademik. Gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi se në në zyrën e burimeve njerëzore dosjet e personelit akademik si me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme ishin të plota. Institucioni kishte një dokumentacion të ruajtur dhe të përditësuar me të dhënat e stafit akademik i cili ishte i angazhuar në kuadër të këtij program studimi. <i>Evidenca50_Tabelat permbledhese</i> <i>Evidenca 15_Te dhenat e personelit akademik; Evidenca 60_Praktike punesimi per PA.</i> <i>Vizita në Institucion në zyrën e burimeve njerëzore</i>						
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas	UT (FHF) dhe Departamenti i Gjeografisë nëpërmjet dokumentacionit dëshmojnë se kanë marrëveshje bashkëpunimi me 18 institucione, që nga niveli i agjensive shtetërore, pushtet lokal dhe institucione të tjera shtetërore që kanë në fokus administrimin gjeohapsinor të territorit, mjedistit, administrimin lokal, grumbullim dhe përpunim të të dhënave shtetërore, turizëm dhe zhvillimin e projekteve. Konkretisht Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapsinor, Agjencia Kombëtare e Kadastrës, Agjencia Kombëtare e Territorit, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, Bashkia Durrës, Vlorë, Shkodër, Divjakë, INSTAT etj. Gjithashtu DGJ si njësi përgjegjëse për administrimin e programit ka të angazhuar personel të kualifikuar dhe me njohuri në fushat e gjeografisë e gjeoinformacionit, i cili është përgjegjës edhe për zhvillimin e praktikës profesionale e cila realizohet në formën e ekspeditave në terren me një program						

natyrës së programit të studimit.	të mirëpërcaktuar e të shtrirë në të gjithë territorin e Shqipërisë. Gjatë vizitës në institucion, në takimin me studentët GVJ konfirmoi se studentët gjatë procesit të praktikës profesionale përfshiheshin në realizimin e anketimeve, vëzhgimeve në përputhje me temën e planifikuar në programin e ekspeditës. <i>Evidenca 21.1_Lista e institucioneve bashkepunuese. Raporti Bachelor Gjeografi; Evidenca 22.1_Rregullore e praktikës ne terren; dhe vizita në institucion me personelin akademik. Dokumentacion shtesë, 2_Relacion per zhvillimin e praktikës ne terren.</i> <i>Vizita në institucion, takimi me studentët.</i>
Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Në RVB pohohet se nuk ka personel mbikqyrës në ambientin që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale. Gjatë takimit në institucion, me përgjegjësen e Departamentit të Gjeografisë GVJ ka marrë një tjetër panoramë lidhur me këtë kriter. Ajo pohon se ka personel mbikqyrës për realizimi e praktikave dhe specifikisht në Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapsinor dhe Agjensinë Kombëtare të Kadastrës. Këta persona gjithashtu janë përgjegjës për hartimin e raporteve përfundimtare të praktikës dhe kryejnë vlerësimin e tyre. Përveç deklarimeve të Personelit akademik të Gjeografisë, të dhëna gjatë takimit, GVJ konstaton se nuk ka dokumentacion shoqërues.
Konkluzione	<i>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe takimet në Institucion GVJ vlerëson se personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik dhe mbulon ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. Gjithashtu, personelit akademik efektiv i angazhuar në programin e studimit Bachelor në "Gjeogarf" jo vetëm që e plotëson statndartin e kërkuar të realizimit në masën 70% nga</i>


	<i>PAE, por e tejkalon ndjeshëm duke treguar qëndrueshmëri të madhe për periudhën e akreditimit. Kjo përbën edhe një pikë të fortë të këtij programi. FHF, DGJ ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike, ruan, mbledh dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Ai ka marrëveshje të shumta bashkëpunimi me institucione shtetërore e private për realizimin e praktikave në terren, të cilat i shërbejnë rritjes profesionale të studentëve. Lidhur me angazhimin e personelin mbikëqyrës në kompanitë bashkëpunuese duhet që DGJ krahas dëshmisë së dhënë gjatë vizitë duhet ta argumentojë këtë edhe me dokumentacionin mbështetës, të arshivuar në institucion.</i> <i>Për të siguruar dhe për të ruajtur standartet e të nxëniet e për t'i përmirësuar ato me sfidat e kohës institucioni ka ngitur struktura të posaçme si KPSSC dhe NJSBC të cilat demostrojnë nivel të lartë profesionalizmi në përfomimin e punës së tyre.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Departamenti i Gjeografisë i cili është përgjegjës për administrimin dhe zhvillimin e programit të studimit BSC në "Gjeografi" zhvillon procesin mësimor në mjediset e FHF, në godinën kryesore. Për realizimin e programit DGJ ka vënë në dispozicion të zhvillimit të leksioneve sallat 324, 326 dhe 311, ndërsa për zhvillimin e moduleve me karakter aplikativ dy Laboratorë GIS (sallat 328 dhe 329). Të dy laboratorët janë me sipërfaqe 50 m² secili dhe akomodojnë 30 dhe 28 studentë. Gjithashtu edhe sallat në Godinën "Iliria". Në funksion të programit dhe moduleve përkatëse janë biblioteka e FHF dhe biblioteka e dedikuar për këtë program pranë DGJ. Në këtë të fundit ka tituj librash të specializuar nga autorë të huaj dhe shqiptarë në shërbim të procesit mësimor për studentët e programit.

	Nga vizita në instiucion grupi i GVJ konstaton se mjediset e përshkruara në dokumentacion ishin të mjaftueshme dhe të përshatshme për realizimin e proceseve akademike. Institucioni ka salla të kapaciteteve të ndryshme të ndara në salla leksionesh dhe seminaresh të cilat plotësojnë realizimin e objektivave mësimorë në funksion të 70 studentëve që ka ky program. Studentët e programit “Gjeogarfi” kanë në dispozicion një infrastrukturë fizike, didaktike dhe logjistike për përmbushjen dhe realizimin e programit. <i>Raporti Bachelor Gjeografi;</i> <i>Evidenca 24_ Infrastruktura FHF.</i> <i>Raporti Bachelor Gjeografi; dhe Vizita në instiucion</i> <i>Raporti Bachelor Gjeografi;</i> <i>Evidenca50_Tabelat permbledhese.pdf, Tabela 21.</i> <i>Evidenca50_Tabelat permbledhese.pdf, Tabela 16.</i>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e mpraktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Në FHF, mjediset mësimore ku zhvillonin procesin mësimor studentët e programit BSC në: “Gjeogarfi” garantonin realizimin e procesit mësimor. Ato janë të paisur me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit videoprojektorë dhe monitorë dhe auditorët 324 e 326 janë të paisur me ekrane të tipit “Smart TV”. Gjithashtu, laboratorët janë të paisur me kompjutera, priter/fotokopje/skaner, projektor. Institucioni ka një numër të mjaftueshëm laboratorësh. Gjatë vizitës në institucion GVJ i pa konkretisht mjediset, paisjet dhe laboratorët. <i>Raporti Bachelor Gjeografi; Evidenca50_Tabelat permbledhese.pdf, Tabela 16; Evidenca 24_ Infrastruktura FHF; vizita në institucion.</i>
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik	Laboratorët e dedikuar për programin e studimit BSC në “Gjeogarfi” përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të moduleve. Ata kanë akses në internet pa limit dhe në çdo moment mund të lidhen me baza të dhënash hapsinore on-line apo faqe të ndryshme që mundësojnë qasje të ndryshme të nevojshëm për realizimin e detyrave individuale apo projekte. Laboratori 329 ka 25 kompjutera dhe Laboratori 328 10 kompjutera. Në to janë instaluar programet kompjuterike ArcGIS 10.8 Desktop dhe ArcGIS Pro të licensuar dhe




e praktik dhe të objektive formues të programit të studimit në tërësi.	programin "Open Source" QGIS. Këto programe janë shumë profesionale dhe avangarde për realizimin e praktikës mësimore, detyrave në varësi të moduleve dhe projekteve lëndore. . <i>Raporti Bachelor Gjeografi; Evidenca 24 _Infrastruktura FHF, vizita në institucion.</i> <i>Raporti Bachelor Gjeografi;</i>			
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	<i>GVJ konfirmoi se mjedisi logjistik dhe në veçanti infrastruktura didaktike ishte e aksesueshme në çdo kohë, për studentët dhe stafin akademik, çdo ditë të javës nga ora 15.00-20.00. Gjatë vizitës në institucion GVJ u njoh konkretisht me këto programe dhe pa raste të detyrave të realizuara nga studentët.</i> <i>Raporti Bachelor Gjeografi; Vizita në institucion.</i>			
Konkluzione	<i>Nga shyrtimi i dokumentacionit dhe vizitës në instiucion GVJ konstatoi se UT, FHF dhe DGJ vë në dispozicion mjedise mësimore të mjaftueshme dhe të përshtatëshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit. Në funksion të programit gjenden paisje të fjalës së fundit të teknologjisë dhe dy laboratorë bashkohorë që plotësojnë realizimin e moduleve si , hyrje në Hartografi, GIS etj dhe garantojnë realizimin e objektivave formuese të programit në tërësi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe	Studentëve të këtij programi studimi literatura bazë e domosdoshme u jepet kryesisht në formën e teksteve mësimore dhe leksioneve të shkruara, të cilët listohen tek përmbajtja e syllabuseve për të gjitha lëndët, përkatësisht modulet. Po ashtu në syllabuse listohet edhe literaturë e

digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	rekomanduar kryesisht në gjuhë të huaj (anglisht). Tituj të rëndësishëm të kësaj literature gjendeshin në bibliotekën e fakultetit. <i>GVJ rekomandon pasurimin me tituj të kësaj biblioteke dhe përditësimin periodik të literaturës.</i> <i>Raporti Bachelor Gjeografi; Shënimet nga vizita në institucion. Evidenca 16_Silabuset.; Evidenca 74_Biblioteka e UT.</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet të literaturës me botime të viteve të fundit.	Në materialin e vënë në dispozicion lista e titujve që lidhen me PS Bch në “Gjeografi” dhe që ndodhen në bibliotekën e institucionit është 178 tituj dhe tërësisht në gjuhën shqipe ku dominojnë autorë vendas në raport me botime nga autorë të huaj. Koha e botimit nuk i përket viteve të fundit. Gjatë vizitës në bibliotekën e fakultetit, GVJ konstatoi që ajo ishte e sistemuar mirë, me indeksim të qartë, e aksesueshme në PC, me hapsira të bollshme e kushte të mira studimi. <i>GVJ rekomandon shtimin e titujve të orientur në këtë program studimi, pasurimin me tituj në gjuhë të huaj dhe krijimin e mundësisë për të aksesuar literaturën në biblioteka online (e-library) etj</i> <i>Raporti Bachelor Gjeografi; Shënimet nga vizita në institucion. Evidenca 25.2_Biblioteka digjitale JSTOR. Evidenca 25.1_Lista e librave te departamentit ne fushat_Gjeologji, Gjeomorfologji, Mjedis, Gis.; Evidenca 25_Lista e librave gjeografike ne biblioteken e FHF.pdf</i>
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Studentëve të këtij programi studimi literatura bazë e domosdoshme u jepet kryesisht në formën e teksteve mësimore dhe leksioneve të shkruara, të cilët listohen tek përmbajtja e syllabuseve për të gjitha lëndët, përkatësisht modulet. Po ashtu në syllabuse listohet edhe literaturë e rekomanduar kryesisht në gjuhë të huaj (anglisht). Tituj të rëndësishëm të kësaj literature gjendeshin në bibliotekën e fakultetit. <i>GVJ rekomandon pasurimin me tituj të kësaj biblioteke dhe përditësimin periodik të literaturës.</i> <i>Raporti Bachelor Gjeografi; Shënimet nga vizita në institucion. Evidenca 16_Silabuset. ; Evidenca 25_Lista e librave gjeografike ne biblioteken e FHF.</i>

Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Biblioteka që është në shërbim të programit të studimit BSC në “Gjeografi” e ka njësinë qendrore në katin e parë me sipërfaqe 143 m² ka 51, 576 tituj dhe 60 vende leximi dhe ka infrastrukturë për aksesimin e titujve të librave në bibliotekat online. Kjo njësi është e paisur me revista shkencore, punime të konferencave, periodikë të fushës së GIS, Hartografi. <i>Raporti Bachelor Gjeografi;</i> <i>Evidenca 74_Biblioteka e UT</i> <i>Gjatë vizitës GVJ u njoh konkretisht me fondin e titujve të librave në shërbim të programit të studimit. Bazuar në këtë vizitë GVJ rekomandon shtimin e titujve të librave në gjuhë të huaj të pesë viteve të fundit.</i>
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Në materialin e vënë në dispozicion lista e titujve që lidhen me PS Bch “Gjeografi” dhe që ndodhen në bibliotekën e institucionit është relativisht e pakët (18 tituj) dhe tërësisht në gjuhën shqipe. Gjatë vizitës në bibliotekën e fakultetit, GVJ konstatoi që ajo ishte e sistemuar mirë, me indeksim të qartë, e aksesueshme në PC, me hapsira të bollshme e kushte të mira studimi. <i>GVJ rekomandon shtimin e titujve të orientur në këtë program studimi, pasurimin me tituj në gjuhë të huaj dhe krijimin e mundësisë për të aksesuar literaturën në biblioteka online (e-library) etj</i> FHF krijon kushte për akses të barabartë dhe pa pagesë për studentët e programit “Gjeografi” në bibliotekat on-line. Gjatë vizitës në institucion punonjësja e bibliotekës konfirmoi duke na stimuluar një rast konkret për akses në këto biblioteka. <i>Raporti Bachelor Gjeografi; Shënimet nga vizita në institucion. Evidenca 25_Lista e librave gjeografike ne biblioteken e FHF.pdf</i> <i>Vizita në Insitucion; Takimi me punonjësën e bibliotekës</i>
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Biblioteka në FHF ku edhe zhvillohet programi i studimit BSC në “Gjeografi” ka një fond librash me karakter shkencor revista shkencore, punimet e konferencave, periodikë të fushave të ndryshme dhe 60 poste leximi dhe poste me kompjutera për ofrimin dhe aksesimin e bibliotekës digjitale të universitetit dhe të bibliotekave on-line ndërkombëtare. Të gjithë studentët e këtij programi janë anëtarë të bibliotekës.

	Menaxhimi i bibliotekës kryhet nëpërmjet platformës on-line Për shkak të pandemisë, FHF ka shfrytëzuar qasjen në biblioteka digjitale, duke u ofruar punonjësve dhe studentëve të tij falas gamën e gjerë të librave në bibliotekat elektronike. <i>Raporti Bachelor Gjeografi;</i> <i>Evidenca 24, Vizita në institucion takimi me punonjësën e bibliotekës</i>
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Biblioteka qëndron e hapur nga e hëna në të shtunë. Përgjatë javës orari i funksionimit të bibliotekës është 8.00-16.00. Oraret e bibliotekës ishin në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor. Gjithashtu studentët kishin mundësinë të tërheqin literaturë për shfrytëzim jashtë ambienteve të bibliotekës. Gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi se studentët kishin mundësi të shfrytëzonin bibliotekën gjatë hapsirave të lira kohore dhe të aksesoheshin në biblioteka on-line deri në orarin e mbylljes së saj. <i>Takimi me punonjësën e bibliotekës</i>
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe	Nga shqyrtimi u njohëm me pasqyrën e gjendjes së fondin e bibliotekës dhe të dhënat e plota mbi platformat on-line/strukturat e teknologjisë së informacionit për bibliotekat. Fondi i titujve pasurohet herëpashere nëpërmjet dy formave: nga blerjet/ abonimet dhe dhurimet. Ato i kanë shërbyer dhe personelit akademik në veprimtaritë e tyre akademike dhe kualifikimet profesionale. Këto fakte GVJ i pa konkretisht gjatë vizitës në bibliotekën e UT-së, më konkretisht vëzhgimi u përqëndrua në fondin e dedikuar për PS Bch në “Gjeografi”, kartelat e studentëve e personelit akademik të këtij programi, që shfrytëzonin fondin dhe mjediset e saj të cilat dëshmonin për tituj në funksion të programit dhe shkallë të lartë shfrytëzimi nga studentët dhe personeli akademik. <i>Evidenca50_Tabelat permbledhese.pdf, Tabela 17</i> <i>Raporti Bachelor Gjeografi;</i> <i>Takimi me punonjësën e bibliotekës; Vizita në institucion</i> <i>Evidenca 10_Rregullore e Bibliotekës.Kreu IV, Neni 14, 17</i>


për performancën e personelit akademik.				
Konkluzione	Biblioteka e FHF përmban literaturën e nevojshme dhe mbështet veprimtarinë mësimore të programit të studimit Bachelor në "Gjeografi" me infrastrukturën fizike të nevojshme, mjediset e bibliotekës, aksesimin e fondit të saj fizik dhe online. Fondi i titujve në funksion të këtij programi është më së shumti në gjuhën shqipe dhe autorë shqiptarë dhe jo të viteve të fundit. Për të rritur performancën e personelit akademik dhe mbështetjen e mësimdhënies dhe nxënies, GVJ rekomandon shtimin e titujve të botimeve që lidhen me fushën e gjeografisë me autorë të huaj dhe të viteve të fundit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Referuar RVB institucioni disponon dhe ka funksional sistemin E-Student i cili koordinon të gjitha veprimet e stafit akademik, ndihmës akademik dhe studentëve. Në këtë sistem hidhen dhe aksesohen dokumente bazë, plani mësimor, data e provimeve, rezultatet e provimeve etj. Secili pedagog dhe student duke filluar nga shtatori 2022 ka kredenciale aksesimi në E-student. <i>Gjatë vizitës në institucion, në takim me sekretarinë mësimore GVJ u informua që ky sistem është në shërbim e sipër dhe kredencialet e personelit akademik dhe studentëve janë funksionale.</i> Aktualisht depozitimin dhe administrimin e informacionit në E-student e kryhen sekretaria mësimore e cila ruan informacionin në gjendje fizike dhe elektronike. Ndërsa menaxhimi dhe administrimi i informacionit on-line në faqen e internetit dhe platformës Teams kryhej nga punonjës së zyrës së IT në FHF. <i>Evidenca 67 Manuali përdorimit të sistemit E-Student.pdf</i> <i>Evidenca 7 Rregullore e Sekretarisë mësimore.</i> <i>Raporti Bachelor Gjeografi; dhe Vizita në Institucion</i>

Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Rolin e sistemit të brendshëm i menaxhimit për administrimin e informacionit, dokumentacionit, aktivitetin e personelit akademik dhe partnerëve të angazhuar në programin e studimit BSC në “Gjeografi” e luan E-student, I cili lidh dhe koordinon hallkat student-koordinator i programit-laborant-sekretari mësimore. Në këtë system janë të dokumentuar aktiviteti I personelit akademik qe nga regjistrat elektronik, frekuentimi deri tek vleresimi i studenteve e hartimi I procesverbaleve. Gjatë vizitës në institucionon, vizita në sekretarinë mësimore GVJ u njoh me dokumentacionin elektronik dhe hard. Ai i kerkoi PD dhe skretarise per te loguar ne faqen e nje personeli akdemik per tu njohur me nga afer me funksionimin e sistemit dhe administrimin e dokumentacionit dhe të studentëve. Gjatë konstaimit e gjeti funksional systemin dhe me informacionet e pershkruara ne RVB. <i>Evidenca 67_Manuali perdorimit te sistemit E-Student.pdf</i> <i>Evidenca 7_Rregullore e Sekretarisë mësimore.</i> <i>Raporti Bachelor Gjeografi; dhe Vizita në Institucion</i>
--	--




Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Gjatë vizitës në institucion GVJ konsatoi se format e mbështetjes së sistemit për personelin akademik ishin: 1. Publikimi online i kurrikulës së programit të studimit, 2. Monitorimi i planit mësimor, 3. Regjistrimi në sistem i personelit akademik përgjegjës për lëndën/modulin dhe atë ndihmës mësimor, 4. Raportimi mbi ecurinë e plotësimit të afateve të përcaktuara në Manual; Format e mbështetjes për studentët ishin: 1. Ngarkimi i detyrave të kursit, 2. Ngarkimi i projekteve 3. Marrja e leksioneve të ngarkuara nga personeli akademik 4. Marrja e vlerësimeve Personeli ndihmës akademik që nga rregullorja e këtij programi është emërtuar Laborant ndihmon studentët duke ju vënë në dispozicion një sekretari online në kohë reale dhe nga çdo vend, për t’iu bërë të ditur: 1. Grafikun e provimeve 2. Notat e provimeve 3. Lajmërime apo informacione të dërguara nga pedagogët apo departamenti 4. Vërtetime të ndryshme <i>Të gjitha evidentimet nga dokumente shoqëruese GVJ i konfirmoi ato si në takimin me studentët ashtu edhe me personelin akademik efektiv dhe me kontratë që angazhohen në programin e studimit.</i> <i>Evidenca 67_Manuali perdorimit te sistemit E-Student. Evidenca 7_Rregullore e Sekretarisë mësimore.pdf Evidenca 46_Lista e regjistrave.pdf Evidenca 7_Rregullore e Sekretarisë mësimore. Evidenca 67_Manuali perdorimit te sistemit E-Student.pdf; Evidenca 75_Manuali i perdorimit te platformes Teams. Evidenca 7_Rregullore e Sekretarisë mësimore.pdf, Evidenca 46_Lista e regjistrave.pdf, Evidenca 67_Manuali perdorimit te sistemit E-Student.pdf</i>
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që	Nga hulumtimi i dokumentacionit, në FHF e vetmja platformë që funksionon është E-student dhe Microsoft Team. Ajo mundëson monitorimin e aktivitetit akademik nga

mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	strukturat e NJSBC-së dhe jo vetëm Njëpërmjet kësaj platforme merren të dhëna dhe realizohen raporte mbi aktivitetin e përdorimit të saj nga anëtarët e personelit akademik. Gjatë vizitës GVJ kërkoi dhe e verifikoi këtë në një prej llogarive të personeli akademik në platformën Teams. <i>Evidenca 67_Manuali perdorimit te sistemit E-Student.pdf; Evidenca 75_Manua li i perdorimit te platformes Teams.</i>			
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit shoqërues të programit të studimit BSC në “Gjeografi” GVJ konstatoi se sistemi i menaxhimit E-student është funksional. Njëpërmjet tij mund të monitorohet në kohë reale aktiviteti mësimor i personelit akademik dhe administrativ. Ai informon në kohë reale për oraret e mësimi, programet , materialet lëndore , literaturën e rekomanduar etj. Me të dhënat reale hartohen raporte monitorimi rreth performancës së procesit mësimor si nga personeli akademik, ndihmës por edhe pjesmarrjes së studentëve në frekuentimin dhe zhvillimin e procesit mësimor. <i>Raporti Bachelor Gjeografi; Vizita në Institucion</i>			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	GVJ hyri në faqen e internetit të UT https://unitir.edu.al dhe FHF http://fhf.edu.al dhe konstatoi hedhjen e informacionit të kërkuar dhe gjuha në të cilën ato publikohen është në gjuhën shqipe. <i>Raporti Bachelor Gjeografi; Evidenca 64 _Udherrefyesi FHF</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se UT, FHF disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional që është E-Student. Ky sistem është në dispozicion të studentëve e personelit akademik i cili, ndihmon në administrimin, informimitn dhe monitorimin e aktivitetit akademik e administrativ për programin e studimit BSC në “Gjeografi”.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	GVJ bazuar në RVB konstaton se raporti financiar hartohet në nivel institucioni çdo vit. Ai përgatitet nga administartori dhe i dërgohet për njohje Bordit të Administrimit të UT. Raportet përmbajnë të dhëna të hollësishme për llogaritjen e kostove të programit BSC në “Gjeografi” dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për një cikël të plotë studimi. <i>Evidenca 33_Relacion per realizimin e buxhetii 2022_2023_2024; Evidenca 31_Kosto e studimeve Bachelor ne Gjeografi 2024-2025. Evidenca50_Tabelat permbledhese, Tabela 18; Evidenca 49_Vendim mbi tarifat e studimit_2022-2025</i>
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjedisëve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	Struktura e planit financiar është bërë duke klasifikuar të ardhurat sipas burimeve të siguruara. Mbështetur në Planin e financimit të UT për vitin 2020-2021 burimet e financimit janë: A. Transferta të pakushtëzuara (Granti për mësimdhënien nga buxheti i shtetit) B. Të ardhurat e kushtëzuara C. Sponsorizmie, D. Fondi i bursave të studentëve E. Fonde të trashëguara nga vitet paraardhës F. Ndërsa, në mënyrë të specifikuar për programin e studimit burimet e janë: 1. Tarifa e regjistrimit 1,600 lekë 2. Tarifa e shkollimit për vitin e parë 30, 000 lekë/vit për mestaren 5-6 dhe 15, 000 lekë/vit për mesatren 6-9 3. Pagat e personelit akademik efektiv dhe me kontratë a. Pagat mujore nga buxheti i shtetit Pagesat e orëve suplementare, të cilat mbulohen nga FHF, nga gjenerimi i të ardhurave; <i>Raporti Bachelor Gjeografi;</i>

	<i>Evidenca 32_Tarifat e regjistrimit dhe shkollimit per vitet 2022-2025</i> <i>Evidenca 33_Relacion per realizimin e buxhetii 2022_2023_2024</i>
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Bazuar në RVB dhe dokumentet shoqëruese, institucioni kryen auditim të brendëshëm një herë në tri vjet, sipas një plani të hartuar më parë nga drejtoria e Auditimit të Brendëshëm në UT dhe të miratuar nga Bordi i Administrimit të UT. Në përfundim të procesit të auditimit Drejtoria e Auditit të Brendëshëm i dërgon njësisë kryesore një projekt raport me gjetjet dhe i kërkon drejtuesve të njësisë kryesore të shprehen brenda 10 ditëve për vrejtjet mbi gjetjet dhe rekomandimet e lëna. Raporti i 2022 ka patur për objekt në aspektin financiar: 1. Përlllogaritjen e pagave; a. Sistemin e menaxhimit buxhetor dhe kryerja e veprimeve me thesarin; Në raport ka pasqyra të detajuara për burimet e të ardhurave nga tariffat e shkollimit e contribute të tjera. Për vitin 2019 paraqiten të ardhurat e siguruar nga: b. Tarfifa regjistrimi; c. Tarifa shkollimi; d. Tarifa administrative; e. Të ardhurat nga ambiente me qera; f. Të ardhura sekondare; g. Shitje shtypshkrime; h. Sponsorizime dhe sponsorizime të jashtëme; Krahas pasqyrave financiare për të ardhurat ka edhe për shpenzimet: a. Shpenzime për udhëtime jashtë shteti; b. Shpenzime nga të ardhurat e fakultetit FHF; c. Shpenzime nga granti për fakultetin FHF; d. Shpenzime për konferenca shkencore FHF; i. Shpenzime publiciteti; <i>Evidenca 44_Raporti i Auditit..</i>
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit	Raportet janë të hollësishme lidhur me realizimin e buxhetit të miratuar të vitit pasardhës, por jo deri në nivelin e njësisë bazë.

mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	GVJ rekomandon hartimin në të ardhmen të raporte të hollësishme edhe për programin e studimit.			
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	DGJ që është përgjegjës për programin e studimit BSC në “Gjeogarfi” i siguron burimet e financimit për këtë program nga: A. Nga gjenerimi i të ardhurave nga hapja e programit, (tarifa për dhe gjatë shkollimit, B. Nga pushteti qëndror/vendor, C. Konsulenca, shërbime, D. Sponsorizime, Krahas dokumentacionit të gjerë, GVJ bazuar edhe në vizitën në institucion dhe takimin me përfaqësues të GVB dhe Stafin Akademik, u informua se politika e mbështetjes mundësohet nga qëndrueshmëria financiare dhe forma e menaxhimit të qëndërzuar duke mundësuar shpërndarjen e kostove në nivel institucioni. <i>Evidenca50_Tabelat permbledhese, Tabela 18; Takimi në Institucion</i>			
Konkluzione	GVJ konstaton se, UT garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve, nëpërmjet raporteve të hollësishme lidhur me format, diversifikimin e financimit. Ajo që GVJ sygjeron është hartimi në të ardhmen i raporteve të tilla të detajuara edhe në nivel programi studimi.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Programi Bachelor në “Gjeografi” zhvillohet në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë, statutin e UT-së dhe me rregulloren e UT. Ky program mbulon ciklin e plotë akademik nga hyrja në universitet deri në diplomim. Rregullorja e programit përfshin politikat për pranimin e studentëve, mësimdhënien, kërkimin, praktikën, vlerësimin, dhe diplomimin. Ajo përcakton të drejtat dhe detyrimet e organeve drejtuese, personelit akademik dhe administrativ, studentëve, dhe bashkëpunëtorëve të jashtëm. Kjo rregullore i bashkangjitet dokumenteve të tjera dhe i shërben edhe studentëve të këtij program studimi për t’u bërë me dije për të drejtat dhe detyrimet e tyre përgjatë gjithë kohës së studimit pranë këtij institucioni. UT ka hartuar politika zhvillimi, strategji të ndryshme që mbulojnë ciklin e parë të studimeve. Në mbështetje të tyre, edhe njësia bazë ka hartuar Planin Strategjik të zhvillimit të programit të studimit. <i>Evidenca 2: Statuti i Universitetit të Tiranës, Neni 8</i> <i>Evidenca 5: Rregullore e Bachelor Gjeografi</i>
Kriteri 2. Politikën dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Referuar dokumentave të vëna në dispozicion, si dhe vizitave të organizuara me studentët, dëshmohet se një ndër parimet e funksionimit të Departamentit të Gjeografisë lidhet me faktin se kriteret dhe procedurat në hyrje e deri në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë në programin Bachelor në Gjeografi. Rregullorja e UT-së përmban në mënyrë të detajuar procedurat dhe praktikën e trajtimit të studentëve që nga pranimi, regjistrimi dhe deri në përfundim të studimeve, gjë që garanton një proces transparent dhe trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe studentët. <i>Evidenca 2: Statuti i Universitetit të Tiranës, Neni 8</i> <i>Evidenca 5: Rregullore e Bachelor Gjeografi, Neni 4</i>
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik	Kriteret përcaktohen nga njësia bazë përgjegjëse për programin dhe i bëhet me dije QSHA nga UT-ja. Në këtë program studimi mund të transferohen të gjithë ata që

kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	plotësojnë kriteret e vendosura, Gjithashtu, GVJ konfirmoi që rregullimet për vlerësimin, transferimin, percaktohen në departament dhe janë të aksesueshme përmes faqes zyrtare të Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë (FHF) dhe Universitetit të Tiranës (UT). Nga konstatimi ynë, faqja nuk ofron informacionin e duhur për studentët. Ndërkohë, gjatë vizitës në institucion diskutuam mbi ofrimin e një praktike të transferimit të studentëve, e cila mungon në listën e dokumenteve të dorëzuara në ASCAL. Përgjigja që u dha ishte: nuk kemi patur raste të transferimit të studimeve në Bachelor Të përmirësohet aksesin në informacion nëpërmjet faqes zyrtare të FHF-së për Departamentin e Gjeografisë <i>Evidenca 5: Rregullore e Bachelor Gjeografi, Neni 4</i> <i>Evidenca 61: Kuotat e pranimit të studentëve për vitin akademik 2022-2025</i> <i>Evidenca 62: Kriteret e pranimit për vitin 2024-2025</i>
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Krahas të dhënave që jepen në RVB dhe dokumentacionin shoqërues, GVJ konfirmoi ekzistencën e kriterëve e procedurave edhe gjatë vizitës në institucion ku studentët dakortësojnë ekzistencën dhe aksesueshmërinë e të gjithë informacionit që lidhet me procedurën që nga pranimi dhe përzgjedhja e studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit, informacione këto që janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku. Ky informacion publikohet përmes faqes zyrtare të universitetit, udhëzuesve akademikë, dhe materialeve informuese. Studentët janë të informuar mbi kriteret dhe metodologjinë e vlerësimit që në fillim të çdo lënde. Nga konstatimi ynë rezulton se faqja zyrtare e FHF-së nuk përmban informacionet e nevojshme për informim. <i>Evidenca 5: Rregullore e Bachelor Gjeografi, Neni 8-9</i> <i>Evidenca 7: Rregullore e Sekretarisë Mësimore</i> <i>Evidenca 62: Kriteret e pranimit për vitin 2024-2025, faqe 29</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me	Përpara fillimit të çdo viti akademik, Universiteti i Tiranës siguron që informacioni mbi kërkesat dhe kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për programin Bachelor në Gjeografi të jetë i disponueshëm për të gjithë publikun dhe kandidatët e mundshëm. Ky informacion përcillet përmes

kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	faqeve zyrtare të universitetit dhe fakultetit, njoftimeve zyrtare, takimeve informuese, dhe aktiviteteve promovuese. Programi është promovuar gjithashtu në shkollat e mesme, ku përfaqësuesit e departamentit takojnë maturanët dhe mësuesit për t'i informuar ata mbi mundësitë e studimit. <i>Evidenca 5: Rregullore e Bachelor Gjeografi</i> <i>Evidenca 62: Kriteret e pranimit për vitin 2024-2025, faqe 29</i>
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	GVJ nga dokumentacioni bashkëshoqërues konsaton se Departamenti i Gjeografisë zbaton të gjitha aktet ligjore dhe VKM-të që lidhen me kategoritë e individëve që përjashtohen nga tarifat e shkollimit dhe kushtet e përfitimit të ndihmës/bursave për shtresat në nevojë. Pjesëmarrësit në këtë kategori kanë mundësi për lehtësira në procesin e aplikimit dhe mbështetje gjatë studimeve për të siguruar një mundësi të barabartë për të gjithë individët. Ky proces është në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe promovon një mjedis të barabartë për të gjithë studentët. <i>Evidenca 5: Rregullore e Bachelor Gjeografi</i> <i>Evidenca 62: Kriteret e pranimit për vitin 2024-2025, faqe 29</i>
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Në kuadër të ndërkombëtarizimit të arsimit, Universiteti i Tiranës ka vendosur një sistem të qartë dhe të strukturuar për pranimin e studentëve ndërkombëtarë në programin Bachelor në Gjeografi. Institucioni siguron që kriteret për pranimin e studentëve të huaj dhe studentëve nga trojet shqiptare janë të qarta dhe të aksesueshme për të gjithë kandidatët, dhe janë publikuar përpara çdo viti akademik. Ky informacion është i disponueshëm përmes faqes zyrtare të universitetit dhe kanaleve të tjera të komunikimit, duke përfshirë udhëzues dhe shpallje të ndryshme. Kriteret përfshijnë njohjen e diplomave të shkollave të mesme nga shtetet e tjera, kërkesat për njohuri gjuhësore dhe dokumentet e nevojshme për aplikim. Për të siguruar një proces të drejtë dhe të lehtë për studentët ndërkombëtarë, universiteti ofron mbështetje të vazhdueshme përmes zyrave të dedikuara, të cilat asistojnë në përgatitjen e dokumentacionit dhe përshtatjen me sistemin arsimor vendas. <i>Evidenca 61: Kuotat e pranimit të studentëve për vitin akademik 2022-2025</i> <i>Evidenca 63: Mbi përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave të studimit – VKM 903, datë 21.12.2016 dhe VKM 39, datë 23.01.2019</i>




Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Në përpjekje për të rritur aksesin në arsim për studentët nga shtresa në nevojë, Universiteti i Tiranës ka hartuar politika të qarta për ndihmën financiare dhe bursat që ofrohen për studentët që përmbushin kriteret e përcaktuara. Këto skema mbështetëse synojnë të sigurojnë mundësi arsimimi pa pengesa financiare për individët që përballen me vështirësi ekonomike. Institucioni ofron gjithashtu lehtësira në pagesën e tarifave për studentët që përmbushin kriteret e nevojshme, duke mundësuar pagesa me këste ose ulje tarifash për kategoritë e caktuara. <i>Evidenca 61: Kuotat e pranimit të studentëve për vitin akademik 2022-2025</i> <i>Evidenca 63: Mbi përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave të studimit – VKM 903, datë 21.12.2016 dhe VKM 39, datë 23.01.2019</i>			
Konkluzione	Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat ne IAL, GVJ konkludon se institucioni harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin për programin Bachelor në "Turizëm". <i>Rekomandim:</i> Të përmirësohet aksesin në informacion nëpërmjet faqes zyrtare të FHF-së për Departamentin e Gjeografisë			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Departamenti i Gjeografisë ofron një proces të qartë dhe të strukturuar për përparimin akademik të studentëve. Sekretaria Mësimore, e cila menaxhon të gjitha të dhënat e studentëve, ka krijuar një sistem të integruar dhe të aksesueshëm për administrimin e informacionit mbi përparimin e studentëve nga një vit në tjetrin. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar, dhe nga takimi me përgjegjësen e departamentit, pedagogët dhe studentët, GVJ konsatoi se që në hyrje të

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al




	studimeve e deri në diplomim, studentët informohen vazhdimisht mbi çështje të rëndësishme që lidhen me veprimtarinë e tyre të përditshme akademike. Konkretisht: planin mësimor të programit të studimit, kriteret e procedurat e përparimit akademik dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin, tarifat, transferimi i studimeve dhe mobilitetet me bursë, këshillimin e studentëve, të drejtat e përfaqësimit, procedurat e zhvillimit të praktikës profesionale, për lëndët dhe temat për provimin e mbrojtjes së diplomës, udhëzimet e për punimin e diplomës, njoftime për strukturën mësimore të vitit akademik, për organizimin e orarit të mësimit, të provimeve dhe mbrojtjes së diplomës, njoftime mbi veprimtarinë akademike, shkencore, kulturore, sportive, humanitare, sikurse dhe kriteret e procedurat e regjistrimit në ciklin e dytë të studimeve Master. <i>Evidenca 7: Rregullore e Sekretarisë Mësimore, Neni 7</i> <i>Evidenca 46: Lista e regjistrave</i>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Universiteti i Tiranës ka krijuar një proces të qartë dhe të aksesueshëm për njohjen e krediteve të fituara më parë, duke mundësuar që studentët që kanë studiuar në institucione të tjera mund të transferojnë kredite pa vështirësi të mëdha. Kriteret për njohjen e këtyre krediteve janë të përcaktuara në përputhje me rregulloret ligjore dhe aktet normative, dhe janë të publikuara dhe të qarta për studentët. Procedura e njohjes së krediteve është e standardizuar dhe e drejtë, dhe është e mundur që studentët të jenë të informuar plotësisht për këtë proces përmes platformës zyrtare dhe komunikimeve elektronike. Ky proces siguron një kalim të lehtë dhe të drejtpërdrejtë nga një program në tjetrin, duke reduktuar burokracinë dhe duke ofruar mbështetje të shpejtë për ata që kanë studiuar më parë në institucione të tjera. Pavarësisht kësaj, ne nuk u njohëm me një praktikë të ekuivalentimit të krediteve në departament. <i>Evidenca2 Statuti i Universitetit i Tiranës, neni 109</i> <i>Evidenca4_Rregullore e Universitetit të Tiranës, neni 78</i> <i>Evidenca5 Rregullore e Bachelor Gjeografi, neni 4</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të	Departamenti i Gjeografisë, në përputhje me praktikën e transparencës dhe informimit për studentët e ardhshëm, organizon takime të hapura dhe informuese për të informuar kandidatët për programin Bachelor në Gjeografi. Këto takime janë një mundësi e shkëlqyer për të prezantuar strukturën e

studentëve në programin e studimit.	programit, planin mësimor, dhe kriteret për vlerësimin dhe diplomimin. Takimet dhe udhëzuesit e përgatitur janë shumë të dobishme për të siguruar që kandidatët të jenë të informuar plotësisht mbi mundësitë dhe kërkesat e programit. Broshurat dhe udhërrëfyesit, si dhe informacioni i publikuar në faqen zyrtare të universitetit, janë të lehta për t'u kuptuar dhe ofrojnë një pasqyrë të plotë të mundësive që ky program ofron për studentët, si për studimet bachelor, ashtu edhe për mundësitë për të vazhduar në programet master. <i>Evidenca4_Rregullore e Universitetit të Tiranës</i> <i>Evidenca5_Rregullore e Bachelor Gjeografi, neni 8-9</i> <i>Evidenca13 Plani Mësimor Bachelor Gjeografi</i> <i>Evidenca16_Silabuset</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Departamenti i Gjeografisë ka siguruar një proces të qartë dhe të strukturuar për vlerësimin e studentëve. Kriteret dhe procedurat e vlerësimit janë të përcaktuara në planin mësimor dhe syllabuset e çdo lënde, ku studentët informohen qartë mbi format e vlerësimit që mund të përfshijnë provime me shkrim, me gojë, ose të kombinuara, si dhe detyra kursi, projekte, ese, dhe prezantime. Kjo qasje për vlerësim siguron që studentët të vlerësohen përmes formave të ndryshme të vlerësimit, duke mundësuar një pasqyrë të plotë të aftësive dhe njohurive të tyre. Pavarësisht evidencave bashkangjitur në këtë standard, studentët nuk e njohin koordinatorin e programit të tyre të studimit. <i>Rekomandime:</i> - <i>Hartimi i një manuali për punimin e diplomës (Udhëzuesi i paraqitur si dokument shtesë nuk i përmbush standardet e një udhëzuesi)</i> - <i>Të parashikohet një praktikë e ekuivalentimit të krediteve në departament.</i> <i>Të rritet roli i koordinators të programit dhe bashkëveprimi i tij me studentët</i> <i>Evidenca5_Rregullore e Bachelor Gjeografi, nenet 15-16</i> <i>Evidenca7_Rregullore e Sekretarisë Mësimore, neni 6</i> <i>Evidenca19_Koordinatori i programit Bachelor ne Gjeografi</i> <i>Evidenca20_Koordinatorët e Programeve të Studimit</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike,	Programi i studimit Bachelor në "Gjeografi" ka një proces të qartë dhe të përcaktuar për përgatitjen dhe mbrojtjen e punimeve të diplomës. Kriteret për mbrojtjen e diplomës janë

institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	të ndarë në mënyrë të qartë dhe të hapur, dhe studentët janë të informuar qartë për këtë proces. Referuar të dhënave të RVB-së, koordinatorët dhe pedagogët e programit ofrojnë mbështetje të vazhdueshme për studentët, duke i orientuar ata për kërkesat e punimeve të diplomës dhe duke i mbështetur në orientimin shkencor dhe metodologjik. Një aspekt tjetër i rëndësishëm është që studentët janë të informuar për procedurat e mbrojtjes së diplomës dhe ky proces është i formalizuar dhe transparent, duke siguruar që të gjitha kërkesat të jenë të kuptueshme për studentët, përfshirë procedurat e mbrojtjes dhe detyrimet e studentëve. <i>Evidenca 64 Udhërrefyesi FHF, faqe 48-49</i>			
Konkluzione	<i>Bazuar në evidencat e paraqitura dhe nga vizita në institucion konstatohet se Programi Bachelor në: "Gjeografi" harton dhe publikon çdo vit akademik kriteret e pranimit për programet mësimore që ofron, sipas legjislacionit në fuqi dhe rregulloreve që ka miratuar, duke i publikuar ato. GJV konstaton se ky program ka hartuar politika të qarta për informimin e kandidatëve për student si dhe zbaton politika mbështetëse për shtresat në nevojë të studentëve, duke ofruar bursa për të gjithë ata që plotësojnë kriteret e përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</i> <i>Rekomandime:</i> - Hartimi i një manuali për punimin e diplomës (Udhëzuesi i paraqitur si dokument shtesë nuk i përmbush standardet e një udhëzuesi) - Të parashikohet një praktikë e ekuivalentimit të krediteve në departament. - Të rritet roli i koordinatorit të programit dhe bashkëveprimi i tij me studentët			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	UT me Fakultetet e Departamentet përkatëse përdor forma të ndryshme për të informuar studentët përsa i përket strukturës dhe kohëzgjatjes së programeve të studimit. Sipas RVB dhe takimit me studentët dhe stafin akademik, Departamenti i Gjeografisë organizon një takim informues ku prezantohen elementët e programit të studimit, plani mësimor, kohëzgjatja e programit, struktura e Institucionit etj. Ky proces mundëson një orientim të qartë dhe të saktë të studentëve, duke ndihmuar në suksesin e tyre akademik. Refereuar të dhënave të RVB, koordinorët dhe pedagogët e programit janë gjithashtu të gatshëm për të ofruar informacion dhe udhëzime të nevojshme për çdo pyetje ose shqetësim që mund të kenë studentët. <i>Evidenca 5: Rregullore e Bachelor Gjeografi, neni 8</i> <i>Evidenca 7: Rregullore e Sekretarisë Mësimore</i> <i>Evidenca 16: Silabuset</i> <i>Evidenca 19: Koordinator i programit Bachelor në Gjeografi</i> <i>Evidenca 20: Koordinatorët e Programeve të Studimit</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Institucioni përdor disa mënyra për të informuar në çdo kohë studentët në lidhje me rregulloret e programit të studimit, planet mësimore, lëndët/ modulet, mënyrat e vlerësimit etj. Nga vizita në institucion u evidentua se plani mësimor i programit të studimit me kreditet, ngarkesën mësimore, forma e vlerësimit për çdo lëndë afishohej në këndin e informimit për studentët e Bachelorit në “Gjeografi”. Informacioni mbi lëndët u vihet studentëve në dispozicion në fillim të çdo viti akademik, ndërkohë, gjatë gjithë programit, studentët mund të marrin sqarime shtesë përmes konsultimeve me pedagogët e departamentit. <i>Evidenca 5: Rregullore e Bachelor Gjeografi, neni 3</i> <i>Evidenca 13: Plan Mësimor Bachelor</i> <i>Evidenca 16: Silabuset</i> <i>Evidenca 19: Koordinator i programit Bachelor në Gjeografi</i> <i>Evidenca 20: Koordinatorët e Programeve të Studimit</i>

Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Programi Bachelor në “Gjeografi” siguron një informacion të detajuar mbi mundësitë e punësimit dhe ofron mbështetje institucionale për orientimin në tregun e punës. Gjatë studimeve, studentët informohen rreth mundësive për punësim në institucione publike dhe private, kompani dhe organizata që kërkojnë ekspertizën e gjeografëve. Informacioni i përfshirë është gjithashtu i përditësuar dhe ofrohet përmes takimeve me stafin pedagogjik, si dhe Zyrën e Këshillimit të Karrierës, që mbështet orientimin dhe përgatitjen profesionale të studentëve. Në këtë mënyrë, studentët mund të identifikojnë mundësitë e punësimit që i përshtaten profileve të tyre dhe të orientohen drejt mundësive të avancuara të karrierës. Departamenti gjithashtu kryen analiza të tregut të punës, të cilat ofrojnë informacion për mundësitë e punësimit pas diplomimit dhe ndihmojnë në përmirësimin e programeve të studimit. <i>Evidenca 6: Rregullore e NJSBC</i> <i>Evidenca 14: Raporti Tregu i Punës Bachelor</i> <i>Evidenca 19: Koordinator i programit Bachelor në Gjeografi</i> <i>Evidenca 20: Koordinatorët e Programeve të Studimi</i>
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	GVJ gjatë vizitës në institucion dhe me me takimet e realizuara u informua mbi sistemin dhe strukturat përgjegjëse për informimin e studentëve mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor. Institucioni, mban komunikim dhe informon studentët për njoftimet që lidhen me procesin mësimor. Gjithashtu studentët kanë akses dhe nëpërmjet portalit E-student për t'u njohur me datat e provimeve, oraret, sallat eij. Përveç njoftimeve mbi strukturën akademike, studentët marrin informacion mbi burimet logjistike dhe infrastrukturën në dispozicion, si laboratorët, salla e hartave, biblioteka dhe shërbimet e teknologjisë së informacionit. Ky informacion mundëson që studentët të jenë gjithmonë të informuar për ndonjë ndryshim të mundshëm në orare ose në aktivitete të tjera akademike. <i>Evidenca 5: Rregullore e Bachelor Gjeografi, neni 3</i> <i>Evidenca 24: Infrastruktura FHF</i>
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të	Për të siguruar shpërndarjen e informacioneve në çdo kohë dhe vend, UT përdor sistemin e menaxhimit të informacionit të brendshëm: platforma E-student, e cila ofron mundësi për studentët që të aksesojnë informacionin akademik si oraret,

menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	provimet, rezultatet e vlerësimit dhe informacionin për të dhënat e tyre akademike. Ky sistem është një mjet i rëndësishëm që lehtëson procesin e menaxhimit të studimeve për studentët dhe e bën informacionin të aksesueshëm në çdo moment, edhe në distancë. Sistemi përdoret nga stafi akademik, jo akademik dhe studentët për menaxhimin e informacioneve të ndryshme. Ky informacion nuk mbështetet në evidencë për këtë kriter, por Manuali i përdorimit të E-sistem është i ngarkuar në platformën e ASCAL. GVJ, nuk mund të kontrollojë funksionimin e sistemit, por në takimet me studentët dhe pedagogët ata konfirmuan përdorimin gjerësisht të tij për aspekte të ndryshme të menaxhimit të ciklit akademik. <i>Evidenca 7: Rregullore e Sekretarisë Mësimore</i> <i>Evidenca 19: Koordinator i programit Bachelor në Gjeografi</i> <i>Evidenca 20: Koordinatorët e Programeve të Studimit</i>			
Konkluzione	<i>Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se Institucioni kontrollon marrjen apo jo të informacionit nga studentët për modulet, lëndët, metodën e vlerësimit dhe detyrat që do të zhvillohen gjatë kursit, nëpërmjet pyetësorëve që i realizon në fund të çdo semestri, nëpërmjet Zyrës së Këshillimit për karrierë. Gjithashtu, përdorimi i portalit E-student rezulton të jetë efektiv për informim, si dhe njoftimet vendoseshin dhe në këndin e njoftimeve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Gjatë vizitës në institucion, GVJ pa fizikisht dokumentacionin që lidhej me statistikat vjetore për numrin e studentëve që kanë aplikuar, vazhdojnë studimet dhe janë diplomuar në programin Bachelor në "Gjeografi". Ky departament ka krijuar një sistem të mirëorganizuar dhe efikas për mbledhjen dhe ruajtjen e statistikave vjetore mbi numrin e studentëve të regjistruar dhe

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	të diplomuar. Zyrat e Sekretarisë Mësimore janë përgjegjëse për menaxhimin dhe ruajtjen e të dhënave, dhe ky informacion është i aksesueshëm për autoritetet akademike dhe për studentët nëpërmjet sistemit të menaxhimit të informacionit. Sekretaria mësimore disponon statistika për studentët e diplomuar në vitin akademik 2022-2023, 2023-2024, 2024-2025. Numri i studentëve rezultoi : Viti akademik 2022-2023 - 76 studentë; Viti akademik 2023-2024 - 70 studentë; Viti akademik 2024-2025 - 51 studentë; <i>Evidenca 7: Rregullore e Sekretarisë Mësimore, Neni 7</i> <i>Evidenca 46: Lista e regjistrave</i> <i>Evidenca 68: Lista e numrit të studentëve të regjistruar</i>
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Në vizitën në Institucion dhe zyrën e Sekretarisë Mësimore, GVJ u njoh me regjistrat dhe statistikat në lidhje me studentët. Sekretaria mësimore ruan të dhënat në lidhje me regjistrimet e studentëve, tërheqjet, largimet para diplomimit etj. Të dhënat përcillen me shkresa të protokolluara në instancat e tjera. Nga kontrolli i rastësishëm i dosjeve të studentëve të dorëzuara në regjistrim në sekretarinë mësimore, GVJ konstatoi saktësi të tyre përsa i përket informacionit që kërkohet. Të dhënat për studentët përfshihen edhe në analizat vjetore të departamentit. <i>Evidenca 2: Statuti i Universitetit të Tiranës, Neni 124</i> <i>Evidenca 7: Rregullore e Sekretarisë Mësimore, Neni 6</i> <i>Evidenca 46: Lista e regjistrave</i> <i>Evidenca 68: Lista e numrit të studentëve të regjistruar</i>
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Sistemi i menaxhimit të informacionit është i sigurt dhe i verifikueshëm, duke siguruar që të dhënat që lidhen me studentët janë të mbrojtura nga hyrje të paautorizuara dhe të ruajtura në një format të sigurt. Ky sistem ofron mundësinë e monitorimit të qasjes dhe ruajtjes së informacionit, duke mundësuar që të dhënat të verifikohen në çdo kohë nga personat e autorizuar. Sistemi i informacionit ofron mundësinë që të dhënat të ruajnë një pasqyrë të plotë të ecurisë akademike, duke përfshirë regjistrimin, vlerësimet, dhe diplomimin e studentëve. Në vizitën e realizuar në institucion dhe takimin me sekretarinë mësimore, GVJ iu vu në dispozicion të dhëna

	që lidheshin me numrin e studentëve të regjistruar në program, ata që ishin çregjistruar dhe ata që ishin me status aktiv. <i>Evidenca 7: Rregullore e Sekretarisë Mësimore, Neni 6</i> <i>Evidenca 46: Lista e regjistrave</i>
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Kontrolli periodik është një element kyç për të siguruar që të dhënat dhe informacionet që lidhen me studentët janë të sakta dhe të përditësuara. Ky proces mbështetet nga një verifikim i rregullt i të dhënave për regjistrimin e studentëve, rezultatet akademike, dhe dokumentacionin përkatës. Ky kontroll është i integruar me rregulloret e brendshme të institucioneve dhe siguron që informacionet që ruhen janë të sakta dhe ndihmojnë në krijimin e mundësive për përmirësimin e procesit të studimit. Ky mjet i kontrollit siguron që procesi i menaxhimit të të dhënave është i standartizuar, i përditësuar dhe në përputhje me legjislacionin përkatës. Një kontatim i tillë mbështetet edhe nga takimi i GVJ-së me kryesekretaren e sekretarisë mësimore. <i>Evidenca2 _Statuti i Universitetit të Tiranës, neni 124</i> <i>Evidenca4 Rregullore e Universitetit të Tiranës, neni 65</i> <i>Evidenca7 _Rregullore e Sekretarisë Mësimore, neni 6</i>
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Njësia bazë e programit Bachelor në “Gjeografi” realizon çdo vit analizën vjetore, ku shqyrtohet arritja e objektivave për programet e studimit, si dhe puna me studentët dhe të dhënat për regjistrimin e tyre, numrin e të diplomuarve, të punësuarve pas diplomimit etj. GVJ konstatoi mungesën e analizës vjetore të departamentit dhe kërkoi plotësim dokumentacioni. Pas kësaj kërkesë, ky dokument u vu në dispozicion të grupit të punës dhe në të reflektohen qartë të dhënat mbi: - Mësimdhënien - Veprimtarinë kërkimore, krijuese dhe inovacionin - Infrastrukturën e kërkimit shkencor - Programet e studimit etj <i>Evidenca 7: Rregullore e Sekretarisë Mësimore, Neni 6</i> <i>Evidenca 14: Raporti Tregu i Punës Bachelor</i> <i>Evidenca 19: Koordinator i Programit Bachelor në Gjeografi</i> <i>Evidenca 20: Koordinatorët e Programeve të Studimit</i> <i>Evidenca 47: Lista e studentëve Alumni</i>

	<i>Evidenca 1_ Raporti vjetor pwr 3 vitet akademike 2021-2024</i>			
Konkluzione	GVJ konstatoi se Departamenti i Gjeografisë mban dhe disponon statistika mbi numrin e studentëve të regjistruar, diplomuar dhe punësuar sipas programeve dhe cikleve të studimit. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit, janë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar, duke siguruar respektimin e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Ky Departament, përgjegjës për këtë program studimi analizon në mënyrë periodike të dhënat mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve, punësimin e tyre, duke nxjerrë rekomandimet në funksion të rritjes së cilësisë së programit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Përfshirja e studentëve në proceset vendimmarrëse është një praktikë e njohur dhe e vlerësuar për krijimin e një mjedisi akademik të hapur dhe të përgjegjshëm. Institucioni ka siguruar që studentët të kenë mundësi përfaqësimi në struktura të ndryshme vendimmarrëse, përfshirë Senatin Akademik, Këshillin e Etikës, Komisionet përkatëse, Zyrën e NJSBC-së dhe Këshillat e Studentëve. Ky angazhim siguron që zëri i studentëve të dëgjohet dhe të merret parasysh gjatë formulimit të politikave dhe ndryshimeve në programet akademike. Takimet dhe këto struktura të përfshirjes studentore ofrojnë mundësi për studentët që të diskutojnë problematikat dhe shqetësimet që mund të ndikojnë në përmirësimin e programit dhe mundësive akademike. Përfshirja e studentëve në Këshillin e Studentëve dhe mundësia për zgjedhje përfaqësuesish nga vetë studentët, tregon një qasje demokratike dhe të hapur ndaj kontributit të tyre në zhvillimin e politikave akademike. Ky proces e bën pjesëmarrjen e

	studentëve jo vetëm të mundshme, por edhe të ndjeshme dhe relevante për përmirësimin e vazhdueshëm të programit. Nga takimet në Institucion, GVJ konstaton se institucioni është në zbatueshmëri të Ligjit 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, ku parashikohet e drejta e studentëve për tu përfaqësuar në strukturat e sipërpërmendura. <i>Evidenca 2: Statuti i Universitetit të Tiranës, neni 129</i> <i>Evidenca 6: Rregullore e NJSBC</i> <i>Evidenca 39: Mbi krijimin e GVB për programin Bachelor në Gjeografi</i>
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Angazhimi i studentëve në organet vendimmarrëse ka një ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin e politikave dhe përmirësimin e procesit akademik. Kjo është e dukshme nga vlerësimet e marra nga studentët dhe rezultatet e raportimeve që pasqyrojnë përvojën e studentëve gjatë studimeve. Nëpërmjet pyetësorëve dhe raporteve periodike, studenti ka mundësinë të ofrojë mendimet dhe sugjerimet e tij mbi programin akademik, duke u bërë kështu pjesë aktive në përmirësimin e tij. Nga shqyrtimi i dokumentit për analizimin e pyetësorëve të studentëve GVJ konstaton se studentëve u kërkohet të vlerësojnë pedagogët për zhvillimin e lëndës përsa i përket përgatitjes; metodave të përdorura në mësim; vlerësimit sipas rubrikave; efikasitetin e leksioneve dhe seminareve; literatura e përdorur dhe ajo e rekomanduar; komunikimi gjatë gjithë semestrit etj. GVJ konstaton se institucioni jo vetëm që përfshin studentët në procesin e vlerësimit por vjel mendimin e tyre në çdo aspekt të procesit mësimor dhe infrastrukturës mësimore. Informacioni i grumbulluar është i bollshëm dhe me to hartohen raportet që analizojnë rezultatet e këtyre instrumentave në nivel të strukturave drejtuese. Sipas takimeve të GVJ, rezultatet nuk ju bëhen të ditura as studentëve dhe as pedagogëve, çka vështirëson procesin e përmirësimit. <i>Evidenca 2: Statuti i Universitetit të Tiranës, neni 129</i> <i>Evidenca 6: Rregullore e NJSBC</i> <i>Evidenca26 Formularët e pyetësorëve Evidenca34_Raporti i pyetësorëve të studentëve</i>

	<i>Evidenca39_Mbi krijimin e GVB për programin bachelor ne Gjeografi</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Institucioni ka një proces të hapur dhe të qartë përfshirjeje të studentëve në hartimin, rishikimin dhe përmirësimin e programit të studimit. Ky angazhim është i bazuar në praktika të vazhdueshme dhe kanale të qarta komunikimi, të cilat mundësojnë që sugjerimet dhe mendimet e studentëve të kenë një ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin e programit. Nga takimi me stafin rezulton se koordinatorët e programit organizojnë takime diskutimi me studentët, si një burim të rëndësishëm për marrjen e sugjerimeve dhe kritikave të studentëve. Pjesëmarrja e studentëve në këto aktivitete e bën procesin e përmirësimit të programit të studimit të përfshirë, dinamik dhe të qëndrueshëm. <i>Evidenca 19: Koordinatori i programit Bachelor në Gjeografi</i> <i>Evidenca 20: Koordinatorët e Programeve të Studimit</i> <i>Evidenca 26: Formularët e pyetësorëve</i> <i>Evidenca 34: Raporti i pyetësorëve të studentëve</i>
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Gjatë vizitës në institucion dhe takimit me studentët si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit vërehet se studentëve u mundësohet transparenca dhe barazia në marrjen e proesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve. Studentëve u garantohej e drejta për të marrë informacion në lidhje me procedurën dhe kriteret e vlerësimit të dijeve në lëndë të ndryshme të programit Bachelor në “Gjeografi”. Ata informohen për format e vlerësimit dhe të kontrollit të dijeve, të drejtën për të zhvilluar provimin, sezonin, data dhe komisionet e provimit, të drejtën për ankimim ose përmirësim të notës etj. Zbatimi i këtyre elementëve përfshihet edhe në pyetësorin e dërguar studentëve. <i>Evidenca 4: Rregullore e Universitetit të Tiranës, nenet 50-51</i> <i>Evidenca 5: Rregullore e Bachelor Gjeografi, neni 8-9</i> <i>Evidenca 26: Formularët e pyetësorëve</i> <i>Evidenca 34: Raporti i pyetësorëve të studentëve</i>
Konkluzione	<i>Në takimin me drejtuesen e njësisë bazë, përgjegjëse për programin dhe me studentët, GVJ evidentoi përfshirjen e studentëve për vlerësimin e procesit akademik, ruajtja e anonimitetit të tyre për të pasur rezultate sa më afër realitetit. Gjithashtu u mundësohet transparenca dhe barazia në marrjen e procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve. Studentëve u</i>

	garantohet e drejta për të marrë informacion në lidhje me procedurën dhe kriteret e vlerësimit të dijeve në lëndë të ndryshme të programit Bachelor në "Gjeografi" Rekomandohet që rezultatet e GVJ të bëhen të ditura si për studentët ashtu edhe për pedagogët, pasi mungesa e transparencës në këtë proces e vështirëson identifikimin e nevojave për përmirësim dhe ndikon negativisht në cilësinë e procesit mësimor.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Njësia e posaçme që kryen informimin është zyra e informimit pranë FHF-së dhe sekretaria mësimore, të cilat ofrojnë shërbim ditor të nevojave për shërbime nga ana e studentëve. Krahas sekretarisë është edhe Zyra e Këshillimit dhe Karrierës, përgjegjësi i departamentit, koordinatori i programit, stafi akademik dhe jo akademik, të cilët ofrojnë informacion të vazhdueshëm për studentët. Sistemi online E-student dhe faqet online të FHF-së gjithashtu luajnë një rol të rëndësishëm për informimin e studentëve në çdo kohë dhe vend. Kjo strukturë ofron një mbështetje të vazhdueshme për studentët gjatë gjithë periudhës së studimeve të tyre. <i>Evidenca 7: Rregullore e Sekretarisë Mësimore, neni 6</i> <i>Evidenca 19: Koordinator i programit Bachelor në Gjeografi</i> <i>Evidenca 20: Koordinatorët e Programeve të Studimit</i>
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin,	Institucioni ka krijuar një sistem të kompletuar për mbështetje dhe ndjekjen e studentëve përgjatë studimeve të tyre. Ky sistem siguron që çdo student të ketë mundësi për të marrë informacion të plotë dhe këshilla mbi zhvillimin e tij akademik. Me ndihmën e Sekretarisë Mësimore dhe Koordinatorit të Programit,

ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	studentët janë të orientuar mbi programin e studimit, metodat mësimore, dhe mundësitë për të zhvilluar praktikën profesionale. Takimet informuese dhe orientuese të organizuara në fillim të çdo viti akademik, veçanërisht për studentët e vitit të parë, janë një mundësi e shkëlqyer për të njohur strukturën e programit dhe të gjitha mundësitë që ofrohen për zhvillim akademik dhe profesional. Ky sistem është thelbësor për përmirësimin e mundësive të përparimit të studentëve dhe është i mbështetur nga një koordinim i ngushtë mes pedagogëve dhe stafëve mbështetëse të departamentit. <i>Evidenca 5; Rregullore Bachelor Gjeografi, Neni 3 dhe 7</i> <i>Evidenca7: Rregullore e Sekretarisë Mësimore</i> <i>Evidenca19: Koordinator i programit Bachelor në Gjeografi</i> <i>Evidenca20: Koordinatorët e Programeve të Studimit</i>
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se institucioni ofron shërbime të strukturuar për këshillimin e karrierës, nëpërmjet Zyrës së Këshillimit të Karrierës, e cila ndihmon studentët në orientimin akademik dhe profesional për tregun e punës. Kjo zyrë organizon aktivitete të ndryshme si "Java e Karrierës", trajnime, praktika profesionale, dhe bashkëpunime me institucione publike e private. Nga takimi me përfaqësuesen e kësaj zyre kuptojmë se studentëve u ofrohet mbështetje për zhvillimin e aftësive të punësimit, informim mbi tregun e punës, si dhe mundësi për orientim të hershëm dhe të vazhdueshëm. Gjithashtu, zyrat përkatëse ndjekin të dhënat e punësimit të diplomantëve dhe ofrojnë raporte analitike për të përmirësuar programet e studimit dhe përshtatshmërinë me tregun e punës. <i>Evidenca21 – Marrëveshjet e bashkëpunimit</i> <i>Evidenca21.1 – Lista e Institucioneve bashkëpunuese</i>
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion	Gjatë takimit të GVJ me Zyrën Cilësisë së Brendshme dhe Këshillimit të Karrierës konstatohet se raportet e gjurmimit të studentëve tregojnë për një procedurë të rregullt dhe sistematike të mbajtjes së kontakteve me studentët Alumni. Raportet gjithashtu tregojnë se proesi i gjurmimit të studentëve kryhet nëpërmjet email-ve personale dhe rrjeteve sociale nga Këshillimi i Karrierës dhe Zyra e Alumnit në bashkëpunim me Departamentin e Gjeografisë. Gjithashtu zhvillohen Panairë pune dhe trajnime për studentët se si të përgatisin CV-në për

studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	punësim, si të përgjigjen në intervista etj. Të dhënat shërbejnë për përmirësimin e vazhdueshëm të programeve, për të siguruar që ato të përputhen me nevojat e tregut të punës. Gjithashtu, këto të dhëna ndihmojnë edhe për orientimin më të mirë të studentëve drejt fushave të kërkuara në treg <i>Evidenca 14: Raaportii Tregut të Punës</i> <i>Evidenca 19: Lista e Alumni</i> <i>Evidenca 34: Raporti i pyetësorit</i>			
Konkluzione	<i>Gjatë vizitës me përfaqësues të Zyrës së Cilësisë së Brendshme dhe Këshillimit të Karrierës, në takim me studentët e programit Bachelor në "Gjeografi" mësuam për orientimin që kjo njësi u jep studentëve për realizimin e praktikave profesionale në institucione e biznese. Përveç saj, për komunikimin dhe informimin online të studentëve, institucioni përdor disa platforma dhe aplikacione për të qënë më afër studentëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1 Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Nga shqyrtimi RVB dhe dokumentacioni shoqërues GVJ konstaton se UT, FHF dhe DGJ nuk kanë një dokument të formalizuar lidhur me zhvillimin dhe përdorimin e metodave të mësimdhënies, por në dokumentacion gjen të dhëna që tregojnë se personeli akademik trajnohet në mënyrë të vazhdueshme për rritjen profesionale në fushën e mësimdhënies, veçanërisht për personelin akademik me moshë të re. GVJ gjatë takimit në institucion me personelin akademik dhe studentët të programit të studimit Bachelor në

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

	“Gjeografi” konstaton se ata përdorin gjatë procesit mësimor, qasje didaktike të përditësuara bazuar në specifikat lëndore, si psh përdorimi i aplikacioneve dhe teknologjive mësimore (GIS, aplikacione për klimën, për lokacionin gjeografik të fenomeneve gjeografike, arkeologjike, të përpunimeve cilësore dhe sasiore brenda projekteve lëndore etj), çka tregojnë për një shkallë të lartë të profesionalizmit në fushën e mësimdhënies dhe përdorimit të teknologjisë në këtë proces. <i>Raporti Bachelor Gjeografi;</i> <i>Evidenca 18.1_Aktivitetet Shkencore, Departamenti i Gjeografisë;</i> <i>Evidenca 18_Veprimtaria shkencore 2021-2024;</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se strukturat përgjegjëse që zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësimit të aftësive mësimdhënëse në UT, të cilat janë: A. KPSSC (Komisioni Përherëshëm i Sigurimit të Standarteve dhe Cilësisë) i cili ka të përcaktuar qartë në Statutin e UT në Nenin 140, pika 1 dhe 2, gërma a-g se: kryen procesin e vazhdueshëm të monitorimit, vlerësimit dhe promovimit të cilësisë së veprimtarive mësimore dhe atyre kërkimore-shkencore, si dhe të aspekteve të tjera të lidhura me to; planifikon organizimin periodik të vlerësimit të brendshëm të cilësisë së programeve të studimit, si dhe të vlerësimit të brendshëm institucional; në fund të çdo semestri organizon pyetësorë studentorë për cilësinë e mësimdhënies në lëndët e çdo program studimi; realizon gjurmimin e punësimit të studentëve; raporton para senatit akademik për rezultatet dhe bën propozime për përmirësimin e standarteve të cilësisë. Evidenca 2_Statuti i Universitetit të Tiranës; Neni 140; Gjithashtu veprimtaria e këtij komisioni mbështetet në rregullore të posaçme që detajon detyrat, mënyrën e funksionimit dhe përgjegjësit. Evidenca 37_KPSSC Rregullorja e Sigurimit të Cilësisë; B. NJSBC (Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në njësitë kryesore); Mënyra e funksionimit të saj është e përcaktuar qartë në Statutin e UT, Neni 141, pikat 1-5. Në pikën pikën 3 përcaktohet se, NJSBC organizon pyetësorin studentor për cilësinë e

	mësimdhënies për çdo lëndë të programit të studimit, në fund të çdo semestri parapara sezonit të provimeve. Në fund të procesit ato hartojnë raporte vlerësimi, rezultatet e të cilave përdoren për vlerësimin e jashtëm dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor në FHF, DGJ. GVJ konstatoi se vlerësimi në bazë të pyetësorëve studentorë realizohet periodikisht dhe në mënyrë specifike për programin e studimit sipas përcaktimeve të statutit të UGJ dhe Rregullores së NJSBC të FHF. Në përfundim të procesit hartohen raporte të detajuara për rezultatet e tij. <i>Evidenca 2 _Statuti i Universitetit të Tiranës; Evidenca 37 _KPSSC Rregullorja e Sigurimit të Cilesise; Evidenca 2 _Statuti i Universitetit të Tiranës; Evidenca 38 _Vendim i Dekanatit për krinjimine NJSBC në FHF; Evidenca 36 _Paketa e Instrumentave të Cilesise; Evidenca 6 _Rregullore e NJSBC; Evidenca 26 _Pyetësoret e studenteve.pdf; Evidenca 34 _Raporti i pyetësorit të studenteve;</i>
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	Garantimi i përfshirjes së studentëve në vlerësimin periodik të formave të mësimdhënies e të dijeve është i sanksionuar në Statutin e UT, neni 141, rregulloren e NJSBC-së FHF, neni 5 e cila shprehet se, në përbërjen e njësive të sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të ketë një përfaqësues nga studentët. Në NJSBC e FHF me rregullore marrin pjesë 2 (dy) studentë. Gjatë takimit në institucion GVJ konkludoi se, studentët nëpërmjet përfshirjes së tyre në organet institucionale universitare përcjellin vlerësimet e tyre, nëpërmjet përfaqësuesve të tyre, mbi performancën e personelit akademik, syllabuseve dhe programit mësimor, përfshirë procesin mësimor. <i>Evidenca 2 _Statuti i Universitetit të Tiranës; Evidenca 38 _Vendim i Dekanatit për krinjimine NJSBC në FHF; Evidenca 36 _Paketa e Instrumentave të Cilesise; Evidenca 6 _Rregullore e NJSBC;</i>
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie	GVJ kontstos se rezultatet e vlerësimit mbi monitorimin dhe sigurimin e cilësisë paraqiten në raporte ku evidentohen gjetjet si psh raporti i pyetësorit të organizuar mbi cilësinë e mësimdhënies online për vitin akademik 2022-2023, për programin e studimit Bch në “Gjeografi”. Rezultatet i bëhen

bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	të qarta drejtuesit të njësisë bazë, DGJ gjetjet e të cilëve i diskutojnë në mbledhjet e departamentit duke vënë në dijeni personelin akademik. <i>GVJ në takimin që zhvilloi me drejtuesen e sektorit të NJSBC së FHF u njoh më nga nga afër dhe më hollësisht për procedurën e realizimit të pyetësorit. Nga ana drejtuese u theksua që hartimi i pyetësorit është haruar në bashkëpunim me drejtuesin e njësisë bazë të DGJ, në mënyrë që marrja e perceptimeve për cilësinë e mësimdhënies ti shërbejë nevojave dhe objektivave të programit të studimit në vazhdimësi. Gjithashtu GVJ, vlerësoi metodologjinë e realizimit dhe ruajtjes së transparencës në përgjigjet e studentëve duke i kontaktuar ata dhe duke iu shpjeguar mekanizmin inovativ që kjo njësi përdor në matjen e perceptimeve. Kjo strukturë bën përpjekje që të sigurojë pjesmarrje të studentëve në anketim në masën mbi 51 %.</i> <i>Evidenca 36_Paketa e Instrumentave të Cilesise; Evidenca 26_Pyetesoret e studenteve.pdf; Evidenca 34_Raporti i pyetesorit te studenteve; Minutat e takimit;</i>
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	UT, nëpërmjet të dhënave që disponon NJSBC e FHF dhe raporteve vjetore të këtij sektori ka synuar përmirësimin e veprimtarisë mësimore dhe të kërkimit shkencor të personelit akademik. Veprimtaria e NJSBC në bashkëpunim me DGJ është shumë aktive. Mbështetur në RVB dhe gjatë vizitës në institucion në takimin me përfaqësues të NJSBC u theksua organizimi i aktiviteteve si Ditët e Gjeografisë dhe GIS-Day për promovimin e shembujve të praktikave më të mira. Me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies çdo personel akademik që angazhohet në programin e studimit, në përfundim të lëndës që ka zhvilluar plotëson një formular “Raport i vetëvlerësimit të lëndës nga pedagogu”. Ky formular përmban vlerësime të punës së lektorit nga perspektiva e personelit akademik, koordinatorit të programit dhe drejtuesit të njësisë. Një tjetër instrument është matja e nivelit të kënaqësisë në punë nga ana e personelit akademik për të ndihmuar përmirësimin e tyre profesional që ndikon drejtpërdrejtë në cilësinë e mësimdhënies. <i>Raporti Bachelor Gjeografi; 5_Vleresimi i performances se personelit akademik.pdf; Dokumentacion shtesë</i>

Konkluzione	GVJ konstaton se UT, FHF dhe DGJ ka dokumenta rregullatorë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies; ka hartuar udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave të mësimdhënies me në qendër studentin si dhe manualin e cilësisë. Harton raporte periodike të vlerësimit dhe i bënë ato publike për të interesuarit. NJSBC e FHF dëshmon një bashkëpunim të ngushtë me drejtuesin e njësisë bazë të DGJ me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të punës për rritjen dhe forcimin e cilësisë së mësimdhënies.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Bazuar në Statutin dhe Rregulloren e UT janë të përcaktuara strukturat dhe procedurat për realizimin e sigurimit të brendshëm të cilësisë. Struktura që realizon këtë proces në nivel institucional është KPSSC, Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të Standardeve të Cilësisë dhe NJSBC njësi e sigurimit të brendshëm të cilësisë që vepron për çdo njësi kryesore. Standardet për sigurimin e cilësisë në UT janë në përputhje me Kodin e Cilësisë, hartuar nga ASCAL dhe Ministria e Arsimit dhe Sporteve. <i>Evidenca 2_Statuti i Universitetit të Tiranës;</i> <i>Evidenca 4_Rregullore e Universitetit të Tiranës.</i> <i>Evidenca 6_Rregullore e NJSBC;</i> <i>Evidenca 37_KPSSC Rregullorja e Sigurimit te Cilesise;</i>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	FHF ka njësinë e sigurimit të brendshëm të cilësisë (NJSBC) i cila ka për detyrë vlerësimin periodik të veprimtarisë mësimore e kërkimore. NJSBC ka akses në të gjitha të dhënat e FHF. Gjithashtu zyra e Standardeve dhe Cilësisë realizon politikat, strategjitë dhe proceset për të garantuar cilësinë në FHF. Institucioni angazhon studentë dhe ekspertë të jashtëm pranë NJSBC-së. <i>Raporti Bachelor Gjeografi;</i> <i>Evidenca 6_Rregullore e NJSBC;</i> <i>Evidenca 37_KPSSC Rregullorja e Sigurimit te Cilesise;</i>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




	<i>Evidenca 34_Raporti i pyetesorit te studenteve;</i> <i>Evidenca 38_Vendim i Dekanatit per krinjimine NJSBC ne FHF;</i>
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	UT, FHF përdor strukturat brenda tij për realizimin e sigurimit të cilësisë. Instrumenti që përdor UT, FHF për sigurimin e cilësisë është “Manuali i Cilësisë” i cili specifikon parimet dhe procedurat e sigurimit të cilësisë në institucion në përputhje me kodin e cilësisë. Institucioni i është nënshtruar akreditimit institucional dhe akreditimit të programeve të studimit në mënyrë të vazhdueshme. NJSBC administron, organizon dhe përgatit vizita të vlerësimit të jashtëm duke ftuar ekspertë të jashtëm për të trajnuar stafin që merret me vlerësimin e brendshëm. Në procesin e përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë janë të përfshirë si bashkëpunëtorë të jashtëm studentët e diplomuar dhe punëdhënësit. <i>Në takimin me përfaqësues të NJSBC në FHF dhe takimin me GVB, konkretisht, studentin që ishte pjesë e grupit të punës, u theksua realizimi dhe pjesëmarrja e aktotëve të jashtëm në funksion të përmirësimit të cilësisë. Vlerësohet pozitivisht ndërmarrja e formave të ndryshme të promovimit të personelit akademik dhe përvojave të mira.</i> <i>Raporti Bachelor Gjeografi;</i>
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	Institucioni UT, FHF ka dhe përdor tregues të qartë për sa i takon matjes së cilësisë në mësimdhënie dhe kërkim. Struktura përgjegjëse e NJSBC, programon punën në bazë të “Paketa e Instrumentave të Cilësisë”, dhe planit të veprimit të përvitshëm. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, treguesit që përdor për të siguruar cilësinë janë: A. Përmbajtja dhe organizimi i lëndës; B. Kontributi i studentit; C. Mjedisi i të nxënit dhe metodat e mësimdhënies; D. Burimet e të nxënit; E. Cilësia e mësimdhënies; F. Vlerësimi; G. Pedagogu; - GJ. Detyrat për lëndën; H. Vlerësimi përfundimtar;

	Rezultatet e marra nga monitorimi, analizat dhe raportet vihen në dispozicion të strukturave drejtuese të njësive bazë. <i>GVJ gjatë verifikimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion konfirmon realizimin e të gjitha proceduarve periodike për vlerësimin e cilësisë.</i> FHF dhe struktura përgjegjëse NJSBC përmes zbatimit të planit të veprimit të përvitshëm si dhe aktiviteteve me karakter monitorues nga Departamenti dhe njësia kryesore realizon vlerësimin në nivel institucional të të gjitha programeve të studimit. Ajo merr në shqyrtim: A. Kontrollin e vazhdueshëm të realizimit të ngarkesës lëndore dhe pasqyrimin të saj në regjistrin e pedagogut. B. Monitorojnë përditësimin në mënyrë të vazhdueshme të dosjeve mësimore të personelit akademik, e cila është objekt kontrolli nga NJSBC. Kontrollon zbatueshmërinë e formateve të miratuara të syllabuseve lëndore në përputhje me Udhëzimin Nr. 41, dt. 24. 01. 2018 të MASR <i>Evidenca 36_Paketa e Instrumentave të Cilesisë; Evidenca 34_Raporti i pyetësorit të studenteve; Raporti Bachelor Gjeografi;</i>			
Konkluzione	<i>UT, FHF harton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë. Vlerësohet pozitivisht ndërmarrja e formave të ndryshme të promovimit të personelit akademik dhe përvajtave të mira.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara	FHF përmes NJSBC-së realizon raporte vlerësimi periodike vjetore mbi elementë të ndryshëm të programeve të studimit në nivel Fakulteti. Përbajtja e këtyre raporteve trajtohet në disa nivele brenda institucionit. NJSBC nëpërmjet kontolleve

për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	të vazhdueshme të procesit mësimor, zbulon problematika të lidhura me përmbajtjen e kurrikulës dhe i referon ato departamentit për rishqyrtim. Në kuadër të objektivave të saj, NJSBC siguron bazën e të dhënave për cilësinë e mësimdhënies. Në bashkëpunim me përgjegjësin e departamentit, NJSBC mbikqyr efikasitetin e kurrikulave, pasqyrimin e tyre me korrektësi në programet lëndore, në formatin e vlerësimit të miratuar, dhe në literaturën e vënë në dispozicion të studentëve. <i>Raporti Bachelor Gjeografi;</i>
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	Bazuar në RVB-në, monitorimi i procesit të përmbushjes së masave në kuadër të mangësive të konstatuara realizohet nga NJSBC-ja nëpërmjet monitorimeve të vazhdueshme nga personat përgjegjës, autoritetet drejtuese, nga diskutimet me stafin akademik si dhe pyetësorëve. Në raportet e hartuara janë evidentuar dhe paraqiten këto mangësi: 1. Metodika e mësimdhënies, 2. Infrastruktura dhe Zhvillimi i teknologjisë, 3. Bashkëpunimi me studentët; 4. Konceptimi i transparencës në vlerësim, 5. Përputhja e materialit lëndor me format dhe mënyrat e vlerësimit, 6. Raporti teori/ praktikë në kurrikula, në favor të praktikave mësimore; 7. Mbështetja finaciare në zhvillimin e ekspeditave mësimore dhe etj. Mangësitë ju bëhen me dije personelit akademik të departamentit të Gjeografisë dhe në mbledhjet e organizuara në këtë njësi ato bëhen objekt i analizës vjetore. Nga takimi që GVJ pati me personelin akademik të njësisë konfirmoi jo vetëm realizimin e analizës rreth mangësive por edhe u njoh më konkretisht me disa prej masave që personeli akademik kishte marrë për përmirësimin e tyre siç ishte,

	shmangia e njohurive paralele në lëndë të përafërta, përmirësimin e formave të vlerësimit, ose shtimin e numrit të lëndëve me zgjedhje/ me karakter më praktik. <i>Evidenca 34_Raporti i pyetësorit te studenteve;</i>
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstytucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	Nga takimi me përgjegjësin e departamentit dhe shqyrtimi i dokumentacionit na rezulton se institucioni përdor forma të ndërthurura për realizimin e vlerësimit dhe ruajtjes së cilësisë së programit të studimit, si anketimi progresiv në fund të çdo semestri ashtu edhe nga vete personeli akademik në perfundim të zhvillimit të lëndës. Kete personeli akademik e kryen edhe në formën e një thik tank edhe nepermjet anketimeve të shkurtra. Për kategorinë lektor/asistent lektor realizohen monitorime nga ana e eprorëve dhe për këtë ka një format standard ku përfshihen komponentë si organizimi dhe qartësia e leksionit; komunikimi me studentët etj. Në përfundim të procesit hartohet një raport vlerësimi mbi rezultatet e monitorimit. Format i vlerësimit të performancës akademike nga studentët bëhet në përputhje me manualin e sigurimit të cilësisë. <i>Evidenca 6_Rregullore e NJSBC; Vizita në Institucion; Takimi me PD, Stafin Akademik; Takimi me GVB; Raporti Bachelor Gjeografi;</i>
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera	Institucioni kryen vlerësime periodike ku për çdo semestër realizon vlerësimin me studentët përmes anketimeve; fokus grupe; takime me stafin dhe studentë etj. NJSBC është struktura përgjegjëse për realizimin e procesit të vlerësimit. Krahas detyrës që kryen NJSBC departamenti i Gjeografisë përdor instrumente të tërthorta vlerësimi lidhur me cilësinë e programit si: A. Komente formale dhe joformale të studentëve, B. Takime me ish-studentë, C. Pyetësorë, D. Takime me Drejtorinë Rajonale Arsimore, Drejtues shkollash E. Sondazhe nga personeli akademik për lëndët që ata lektorojnë. <i>Raporti Bachelor Gjeografi;</i>

që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.	<i>Dokumentaioni shtesë: 2_Relacion per zhvillimin e praktikës ne terren; 5_Vlerësimi i performancës së personelit akademik;</i>			
Konkluzione	<i>UT, FHF monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit. UT, FHF përdor instrumenta të ndryshëm si të dhëna nga raporte të ndryshme, anketime, diskutime me ish-studentë, të dhëna nga gjurmimi i studentëve, etj.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitet akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Sipas Statutit dhe Rregullores së UT ka parashikuar përfshirjen e aktorëve të ndryshëm: a. Personel Akademik të brendshëm b. Personel Ndhmës Akademik c. Personel Administrativ d. Studentë UT, FHF realizon politika dhe procedura të brendshme të cilësisë duke përfshirë disa aktorë në proces si: bordet e tregut të punës; ekspert të jashtëm; përfshirja në projekte ndërkombëtare me fokus sigurimin e cilësisë së brendshme si Erasmus +. Përfshirja në këto projekte ka krijuar shkëmbime përvojash, trajnime, vizita studimore si dhe procese të tjera që lidhen me monitorimin dhe vlerësimin e funksionit e sigurimit të cilësisë së brendshme. <i>Raporti Bachelor Gjeografi; Evidenca 18_Veprimtaria shkencore 2021-2024.; Evidenca 58_Praktika CEEPUS.pdf; Evidenca 56_Praktika Erasmus+.</i>
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitet, individët, studentët	Përgjegjësitë dhe detyrat e njësive të angazhuara janë të përcaktuara në kuadrin ligjor si Statut, Rregullore e UT, Rregullore e BSC në “Gjeografi”, mbi të cilin funksionon UT dhe njësitet përbërse të tij.

dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Mbështetur në dokumentacionin mbështetës GJV i rezulton se ekzistojnë urdhëra të rektorit dhe vendime të drejtuesit të njësisë bazë për detyra konkrete që njësitë dhe individët angazhohen në organizimin dhe menaxhimin e veprimtarisë kërkimore shkencore dhe koordinimin e saj sektorin e projekteve, kërkimit shkencor dhe të botimeve në UT, FHF. GJV konstaon vetëm vendime në nivel rektorati dhe dekanati <i>Evidenca 2 _Statuti i Universitetit të Tiranës;</i> <i>Evidenca 4 _Rregullore e Universitetit të Tiranës. Raporti Bachelor Gjeografi;</i> <i>Evidenca 19 _Koordinatori i programit Bachelor ne Gjeografi.</i>
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.	NJSBC-ja nuk realizon raporte në nivel program studimi. Gjatë procesit të realizmit të pyetësorit ajo përfshin në sondazhet për vlerësim të gjithë personelin akademik, studentët e Departamentit të Gjeografisë të ciklit të parë dhe të dytë dhe personelin ndihmës akademik. Gjithashtu, sigurimi i cilësisë së programit bëhet objekt analize çdo fund viti akademik nga vetë njësia bazë që e ofron programin BSC në “Gjeografi”, nga departamenti. <i>Evidenca 34 _Raporti i pyetesorit te studenteve. Raporti Bachelor Gjeografi;</i>
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	UT, FHF ka disa standarde të cilat i respekton për përzgjedhjen e anëtarëve në procesin e vlerësimit-NJSBC-së (si: kompetenca profesionale, paanshmëria, përfaqësimi për çdo njësi, rotacioni ...etj). Bazuar në RVB anëtarët e NJSBC për njësinë kryesore nuk duhet të jenë pjesë e autoriteteve drejtuese të universitetit, etj. <i>Raporti Bachelor Gjeografi; Evidenca 6 _Rregullore e NJSBC.</i>
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe	Nga RVB nuk është shumë e qartë nëse ka bashkëpunëtorë apo ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit dhe që marrin pjesë në vlerësimin e brendshëm të cilësisë. <i>GJV rekomandon që në të ardhmen ti kushtohet më</i>

bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	<i>tepër vëmendje përfshirjes së ekspertizës së jashtëme në vlerësimin e cilësisë së programit BSC në "Gjeografi". Gjithashtu GVJ konstaton mungesë të dokumentacionit mbështetës lidhur me rolin që ekspertiza e jashtme duhet të japë në vlerësimin e cilësisë për programin e studimit "Gjeografi".</i> <i>Raporti Bachelor Gjeografi</i>			
Konkluzione	<i>UT, FHF përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre. GVJ rekomandon që në të ardhmen ti kushtohet më tepër vëmendje përfshirjes së ekspertizës së jashtëme në vlerësimin e cilësisë së programit BSC në "Gjeografi".</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë vepron në bazë të një plani veprimi vjetor të miratuar nga Dekani i FHF. Rregullorja e NJSBCS është dokumenti në të cilin përcaktohen rregullat e organizimit të veprimtarisë në kuadër të sistemit të brendshëm të cilësisë. Këto dokumenta sikundër pranohet në RVB dhe "...raportet e NJSBC-së përmbajnë të dhëna sensitive dhe personale, ato bëhen pjesë e diskutimeve në ato grupe për të cilat raporti ka ndikim të drejtpërdrejtë" <i>Evidenca 6_Rregullore e NJSBC.; Raporti Bachelor Gjeografi;</i>
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe	Vlerësimi kryhet në nivel institucional, dhe rezultatet e tij iu bëhen me dije strukturave drejtuese. Struktura drejtuese i përcjell rezultatet në njësinë bazë dhe ato elementë që lidhen me këtë njësi. Në departament trajtohen me stafet akademike ato elementë të vlerësimit që lidhen ngushtë me veprimtarinë e tyre. Në RVB nuk jepet e qartë nëse raportet e NJSBC-së

legjislacionin për të dhënat personale.	janë të aksesueshme për të gjithë stafin akademik apo për studentët. GVJ sygjeron që një përmbledhje e rezultateve të raportit dhe masave propozuese, të jenë publike dhe të aksesueshme si për stafin akademik ashtu edhe për studentët e më gjerë.			
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Institucioni realizon në vijueshmëri procesin e përpilimit të rezultateve dhe masave që duhet të ndërmerren si rezultat i raportit. Sipas RVB-së disa nga masat e marra lidhen me aktivitete për ngritjen e mëtejshme të kapaciteteve akademike përmes realizimit të seminareve të trajnimit me natyrë didaktike të mësimdhënies apo për kërkimin shkencor.			
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Përpjekjet për të reflektuar gjetjet e raportit sikundër dhe monitorimin janë në nivel institucional. Përmes kontrollit të kryqëzuar, strukturat dhe aktorë të brendshëm të FHF-së reflektojnë mbi rezultatet e raportit dhe realizojnë masa që lidhen me programet e studimit për ta përmirësuar më tej.			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Realizimi i vlerësimit të përvitshëm nga ana e NJSBC-së përmes planit të punës mundëson angazhimin e strukturave akademike dhe studentët në proces. Aksesin në dokumentat ku bazohet kjo veprimtari është e mundur si për stafin akademik, administrativ dhe studentët në nivel institucional.			
Konkluzione	GVJ konstaton se, politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit BSC në "Gjeografi", DGJ, FHF bëhen publike, transparente dhe efektive për personelin akademik dhe studentët. GVJ sygjeron që një përmbledhje e rezultateve të raportit dhe masave propozuese, të jenë publike dhe të aksesueshme si për stafin akademik ashtu edhe për studentët e më gjerë dhe të publikohen nga institucioni.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

				X
--	--	--	--	---

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Gjeografi” “Universiteti I Tiranës”

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Personelit akademik efektiv i angazhuar në programin e studimit Bachelor në “Gjeografi” jo vetëm që e plotëson statndartin e kërkuar të realizmit në masën 70% nga PAE, por e tejkalon ndjeshëm duke treguar qëndrueshmëri të madhe të programit të studimit për periudhën e akreditimit. **Standardi IV.1. Kriteri 2.**
2. NJSBC e FHF harton raporte periodike të vlerësimit dhe i bënë ato publike për të interesuarit. Gjithashtu, ajo dëshmon një bashkëpunim të ngushtë me drejtuesin e njësisë bazë të DGJ me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të punës për rritjen dhe forcimin e cilësisë së mësimdhënies. **Standardi VI.1. Kriteri 4.**
3. UT, FHF, DGJ ndërmerr forma të ndryshme të promovimit të personelit akademik dhe promovon përvojat më të mira. **Standardi VI.2. Kriteri 3.**
4. Për të siguruar dhe për të ruajtur standartet e të nxëniet e për t’i përmirësuar ato me sfidat e kohës institucioni ka ngitur struktura të posaçme si KPSSC dhe NJSBC të cilat demostrojnë nivel të lartë profesionalizmi në përfomimin e punës së tyre. **Standardi III.1. Kriteri 6.**
5. Për të siguruar dhe për të ruajtur standartet e të nxëniet e për t’i përmirësuar ato me sfidat e kohës institucioni ka ngitur struktura të posaçme si KPSSC dhe NJSBC të cilat demostrojnë nivel të lartë profesionalizmi në përfomimin e punës së tyre. **Standardi IV.1. Kriteri 5.**
6. Mbështetja institucionale dhe lidhja me tregun e punës: Funkcionimi i platformës E-student, politikat e bursave dhe mbështetjes financiare, si dhe marrëveshjet e bashkëpunimit kombëtar e ndërkombëtar, kanë forcuar pjesëmarrjen studentore, transparencën dhe orientimin profesional drejt tregut të punës. **Standardi I.2. Kriteri 2,3; Standardi III.3. Kriteri 6,7.**

Pika të dobta:

1. Edhe pse totali i përqindjes së krediteve të kategorisë A dhe B janë në plotësim të VKM-s që së bashku duhet të jenë në masën 70% nuk plotësohet detyrimi tjetër ligjor ai për

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al





zbatimin e kufijve të përqindjes për kategorit A dhe B mbështetur në po në VKM.
Standardi III.4. Kriteri 1

2. Kuadri rregullator në nivel departamenti paraqitet i kufizuar në disa aspekte, çka tregon nevojën për një pasurim dhe harmonizim më të plotë të tij, në mënyrë që organizimi i veprimtarive mësimore, shkencore dhe administrative të reflektojë më qartë objektivat dhe misionin e njësisë. **Standardi I.1. Kriteri 3.**

Rekomandime:

1. Në të ardhmen rekomandohet që UT, FHF, DGJ t'i kushtojnë më tepër vëmendje përfshirjes së ekspertizës së jashtme në vlerësimin e cilësisë së programit BSC në "Gjeografi". **Standardi VI.4. Kriteri 5.**
2. GVJ sugjeron që departamenti të shqyrtojë mundësinë e përmirësimit të kornizës së tij rregullatore të brendshme, në mënyrë që të përforcohet koherenca ndërmjet funksioneve akademike, kërkimore dhe administrative, si dhe të sigurohet një orientim më i qartë drejt objektivave afatgjata të njësisë dhe misionit institucional. **Standardi I.1. Kriteri 3**
3. Përmbledhjet e rezultateve të raportit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit BSC në "Gjeografi", DGJ, dhe masave propozuese, të jenë publike dhe të aksesueshme si për stafin akademik ashtu edhe për studentët e më gjërë dhe të publikohen nga institucioni. **Standardi VI.5. Kriteri 2.**
4. Mjetet e vlerësimit të vazhduar duhet të kenë një masë të mirëpërcaktuar vlerësimi, në formën e një shkalle dhe të shprehura konkretisht në rregulloret e Fakultetit të Histori-Filologji dhe Departamentit të Gjeografisë e për rrjedhojë edhe në rregulloren e Programit të studimit duke mos lënë hapsira për krijimin e premisave për keqinterpretime. **Standardi III.2. Kriteri 1**
5. Pa cënuar lirinë akademike dhe pa dëmtuar shumëllojshmërinë e formave të vlerësimit në shërbim të objektivave të programeve mësimore, vlerësimet të kenë masa të mirëpërcaktuara në përqindje, si kufirin maximal ashtu edhe minimal për çdo element të vlerësimit të vazhduar dhe të mirëpërcaktuara në rregulloret e FHF dhe DGJ, me qëllim rritjen e transparencës përkundrejt aktorëve të përfshirë në proces. **Standardi III.3. Kriteri 3**
6. Për të rritur performancën e personelit akademik dhe mbështetjen e mësimdhënies dhe të nxëniet, institucioni duhet të shtoj numrin e titujve të botimeve që lidhen me fushën e gjeografisë me autorë të huaj dhe të viteve të fundit. **Standardi IV.3. Kriteri 2.**
7. Institucioni rekomandohet të hartojë në të ardhmen raporte të detajuara lidhur me format, diversifikimin e finacimit edhe në nivel programi studimi. **Standardi IV.5. Kriteri 4.**

8. Të përmirësohet aksesin në informacion nëpërmjet faqes zyrtare të FHF-së për Departamentin e Gjeografisë (**Standardi V.1, Kriteri 3**)



- 9 Hartimi i një manuali për punimin e diplomës (Udhëzuesi i paraqitur si dokument shtesë nuk i përmbush standardet e një udhëzuesi) Të parashikohet një praktikë e ekuivalentimit të krediteve në departament. (Standardi V.2, Kriteri 4.

Evaluation's conclusions for the first cycle study program Bachelor "Geography" provided by "University of Tirana"

Strengths and affirmations


1. The effective academic staff engaged in the Bachelor study program in Geography not only meets the required implementation standard of 70% set by the External Evaluation Panel (EEA), but significantly exceeds it, demonstrating strong stability and sustainability of the study program throughout the accreditation period. **Standard IV.1. Criterion 2.**
2. The Internal Quality Assurance Unit (NJSBC) of the Faculty of History and Philology (FHF) prepares periodic evaluation reports and makes them publicly available to stakeholders. Moreover, it maintains close collaboration with the head of the Department of Geography (DGJ) with the aim of continuously improving work processes to enhance and strengthen the quality of teaching. **Standard VI.1. Criterion 4.**
3. The University of Tirana (UT), the Faculty of History and Philology (FHF), and the Department of Geography (DGJ) undertake various initiatives to promote academic staff and to highlight best practices. **Standard VI.2. Criterion 3.**
4. To ensure, maintain, and continuously improve learning standards in response to contemporary challenges, the institution has established dedicated structures such as the Curriculum and Quality Assurance Commission (KPSSC) and the Internal Quality Assurance Unit (NJSBC), which demonstrate a high level of professionalism in their performance. **Standard III.1. Criterion 6.**
5. In support of the development of the study program, the University of Tirana (UT), the Faculty of History and Philology (FHF), and the Department of Geography (DGJ) have provided state-of-the-art equipment and two modern laboratories that enable the implementation of modules such as *Introduction to Cartography*, *GIS*, etc., ensuring the achievement of the program's educational objectives in their entirety. **Standard IV.1. Criterion 5.**
6. The operation of the E-student platform, together with scholarship and financial support policies, as well as national and international cooperation agreements, has strengthened student participation, transparency, and professional orientation toward the labor market. **Standard I.2. Criterion 2,3**

Weaknesses

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al


E-mail: info@ascal.al




1. Although the total percentage of credits for categories A and B complies with the requirements of the Council of Ministers' Decision (VKM)—which stipulates that, together, they must constitute 70% of the total credits—the program does not fully meet the additional legal requirement regarding the implementation of the specific percentage limits for each category (A and B) as defined in the same decision. **Standard III.4. Criterion 1**
2. The regulatory framework at the departmental level appears partially developed in certain aspects, indicating the need for further enrichment and harmonization so that the organization of teaching, research, and administrative activities more clearly reflects the unit's objectives and mission. **Standard I.1. Criterion 3.**

Recommendation

1. It is recommended that, in the future, the University of Tirana (UT), the Faculty of History and Philology (FHF), and the Department of Geography (DGJ) place greater emphasis on involving external expertise in the quality evaluation process of the BSc program in Geography. **Standard VI.4. Criterion 5.**
2. It is recommended that the department consider enhancing its internal regulatory framework in order to strengthen coherence among its academic, research, and administrative functions, and to ensure a clearer alignment with the unit's long-term objectives and institutional mission. **Standard I.1. Criterion 3.**
3. The summaries of the results from the Internal Quality Assurance Report for the BSc program in Geography, along with the proposed measures, should be made public and accessible to both the academic staff and the wider student body, and should be published by the institution. **Standard VI.5. Criterion 2.**
4. The continuous assessment tools should have a clearly defined grading scale, explicitly specified in the regulations of the Faculty of History and Philology (FHF) and the Department of Geography (DGJ), and consequently reflected in the study program regulation, leaving no room for potential misinterpretations. **Standard III.2. Criterion 1.**
5. Without compromising academic freedom or the diversity of assessment methods used to achieve the objectives of study programs, evaluation components should have well-defined percentage weights, setting both maximum and minimum limits for each element of continuous assessment. These should be clearly stipulated in the regulations of FHF and DGJ to ensure greater transparency for all stakeholders involved in the process. **Standard III.3. Criterion 3.**
6. To enhance the performance of academic staff and to strengthen teaching and learning support, the institution should increase the number of recently published international titles related to the field of geography. **Standard IV.3. Criterion 2.**
7. It is recommended that the institution prepare, in the future, detailed reports regarding the forms and diversification of funding, including at the study program level. **Standard IV.5. Criterion 4.**




8 . Improve access to information through the official website of the FHF for the Department of Geography (**Standard V.1, Criterion 3**)

Drafting a manual for the diploma thesis (The guide presented as an additional document does not meet the standards of a guide) To provide for a practice of credit equivalency in the department. **Standard V.2. Criterion 4.**

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

